

Para pak ditësh në Itali u botua një monografi për piktorin Mario Ridola. Libri është shkruar nga historiani, studiuesi dhe shkrimtari i njohur Bruno Castagna. Siç paraqitet edhe në atë botim veprimtaria më e rëndësishme e artistit italian është drejtimi i Shkollës së Vizatimit në Tiranën e viteve '30. Monografia kushtuar drejtuesit të së parës Shkollës Arti në Shqipëri, shoqërohet me dy parathënie nga dy historianë të artit Antonio Falbo dhe Ferid Hudhri.

## RIKTHIM I PIKTORIT MARIO RIDOLA

Nga Ferid Hudhri



**LEON ÇIKA - ky  
mjeshtër i madh  
i peizazhit dhe i  
fotografisë artistike  
shqiptare**

Nga Ylli Drishti

(fq. 10)

### SHËNIME MBI LIBRAT

Rreth kolanës tre vëllimëshe të librave "Helena e epikës sonë tragjikomike", "Në mes të kauzës dhe mbijetesës" dhe "A kurohet mendësia?" të autorit Emin Azemi

**NJË LIBËR I CILI NA KA  
SHPËTUAR NGA HARRESA**

Nga Xhabir Ahmeti

(fq. 10)

Kristo Frashëri Gjergj Kastrioti Skënderbeu,  
Jeta dhe Vepra (1405-1468)

**NJË VEPËR  
MONUMENTALE PËR  
SKËNDERBEUN**

Nga Feride Papeleka

(fq. 12)

Disa libra kthehen në tekste të domosdoshme për të njohur epoka të rëndësishme të identitetit tënd historik dhe gjatë leximit të tërheqin gjithnjë e më shumë me forcën e tyre bindëse, me bukurinë e natyrshme të shprehjes dhe me frymën komunikuese.

Shënime dhe përftesa për librin "Përse iriqin nuk e përkëdhel askush?", të autorit Andrey Kurkov

**MAGJIA E LIBRIT "PËRSE  
IRIQIN NUK E PËRKËDHEL  
ASKUSH?"**

Nga Xhahid Bushati

(fq. 23)

**Qendra e Studimit të  
Arteve prezantoi "Vjetarin  
artistik shqiptar"**

(fq. 9)



Libri i fundmë i Fortlunturisë së Tij Anastasi, kryeepiskop i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, *Ringritja e Kishës Orthodoxe Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012)*

**Dy recensionet të hershme  
dhe pak fjalë kujtimi  
prej njohjes vetjake**

Nga Shaban Sinani

(fq. 6)

Për befasinë time, gjatë vizitës në ekspozitën e miniaturave, ai u ndal para njëres prej tyre dhe tha: *Ai që e ka krijuar këtë miniaturë (ishite një shembëlltyrë e ungjilltarit Mattheu), nga mënyra si i ka shkruar ato pak germa, duket se është jogrek.*

**Marlen Dietrich ulet në  
gjunjë para Konstantin  
Paustovskit për tregimin  
e tij "Telegrami"**

Përktheu nga rusishtja Kosta Nake



### BIBLIOTEKË

Rudolf Marku

(fq. 16)

*Tirana, një grua*

Poetë të ndryshëm

(fq. 15)

*Aroma e pendimit*

Përktheu Dashamir Malo

Orhan Pamuk

(fq. 20)

*Karsi dhe Frankfurti*

Përktheu Qerim Raqi

Pier Paolo Pasolini

(fq. 22)

*Kundër flokëve të gjatë*

Përktheu Zija Vukaj

Arben Meksi

(fq. 24)

*Karikatura e së shtunës*

**AS TRIUMFI NUK  
I JEP GJË LIBRIT**

Nga Xhevair Lleshi

(fq. 8)

**TE VARRI I POETIT**

Nga Agim Vinca

Me duart e mia i kam mbledhur copat e mermerit të varrit të poetit Lasgush Poradeci në Pogradec në maj të vitit 1991. (E kam mbajtur sekret këtë vaki plot 15 vjet, por, tani kur në shoqërinë shqiptare nuk ka mbetur më pothuajse asnjë fshetësi, kujtoj se ka ardhur koha ta bëj publike).

(fq. 14)

Gjatë epokës së artë të Rilindjes Italiane, pikërisht në periudhën kur jehona e veprave të Leonardos, Mikelanxhelos, Rafaelit dhe mendjeve të tjera të ndritura rrezatonin në të gjitha mjediset artistike të Europës, trojet shqiptare në anën tjetër të Adriatikut vazhdonin të ishin nën pushtetin e Perandorisë Osmane. Kur artistët në bregun përballë nesh vendosnin njeriun në qendër të krijimeve të tyre, feja e pushtuesve osmanë nuk lejonte asnjë lloj pikturimi apo vizatimi të figurave njerëzore, as motive të tjera nga jeta e gjallë. Kështu për disa shekuj, në të dy anët e Adriatikut jeta ecte në kahje të ndryshme. Nga brigjet e shqiptarëve banorët u mbajtën larg ideve iluministe të Rilindjes. Artistët vendas nuk mundën të përjetësonin si duhet jetën e bashkëkohësve, madje as të krijonin imazhin e mjedisve ku banonin. Vepra e parë e Rilindjes Shqiptare, tabloja *Motra Tone* e Idromenos, u realizua në janar të vitit 1883, thuhet se 5 shekuj më pas.

Gjithsesi, duke qenë përballë vendit nga ku u përhapën idetë iluministe, shqiptarët patën fatin të përjetësoheshin në disa veprat prej artistëve italianë. Afresku i Paolo Veronezes *Mbrojtja e Shkodrës* në Pallatin Dukal të Venecias dhe portreti i Skënderbeut pikturuar nga Cristofano dell'Altissimo në Galerinë Uffizi të Firences, janë dy nga tablotë e njohura në dy muze shumë të rëndësishëm, krahas shumë veprave të tjera që ndodhen nëpër galeri, muze dhe koleksione të ndryshme. Motive të tjera arbërore u pikturuan edhe nga autorë të shquar si Botticelli, Bellini, Pinturicchio, Carpaccio, Lipparini,

# RIKTHIM I PIKTORIT MARIO RIDOLA

nga Ferid Hudhri

## SHKOLLA e VIZATIMIT

Më 29 janar të vitit 1932 Ministria e Arsimit e Mbretërisë Shqiptare njoftoi themelimin e Shkollës së Vizatimit në Tiranë, e para Shkollë Arti në Shqipëri. Përmes një shkrese të posaçme Ministria e Arsimit porositi të inkurajohen nxënësit e gjimnazëve në të gjithë vendin që tregojnë aftësi për vizatim për me frekuentue shkollën e lartpërmendun. Në atë dokument shkruhet gjithashtu se me propozimin e Komitetit Artistik dhe vendim të Ministrisë së Arsimit, shkolla do të drejtohet nga z. Prof. Mario Ridola, i ndihmuar nga Andrea Thanasi, profesor i gjimnazit.

Gjatë viteve '30 të shekullit të kaluar Shkolla e Vizatimit u kthye në një qendër të rëndësishme të veprimtarive artistike në Shqipëri. Krahas përgatitjes së artistëve të ardhshëm, në mjediset e atij institucioni u organizuan disa ekspozita me krijime të nxënësve dhe të mësuesve të shkollës si dhe me punime të piktorëve dhe skulptorëve të tjerë nga i gjithë vendi. Aty ekspozuan edhe autorë të huaj. Piktori gjerman Carl Blohm, pasi jetoi dhe pikturoi për disa muaj nëpër disa krahina të ndryshme, në muajin nëntor të vitit 1934 përgatiti një ekspozitë vetjake me tema shqiptare në sallat e Shkollës së Vizatimit. Veprimtaria më e rëndësishme u organizua gjatë muajit nëntor të vitit 1937. Në mjediset e shkollës së artit u ekspozuan të gjitha bocetet e skulptorëve dhe arkitektëve që morën pjesë në Konkursi Ndërkombëtar për ngritjen e monumentit kushtuar Gjergj Kastriotit. Edhe skulptori italian Romano Romanelli, autori i monumentit ekuestër të Skënderbeut në Romë, erdhi pikërisht në sallat e Shkollës së vizatimit, ku skicoi vizatimet e para për variantin e monumentit që realizoi në Itali.

Shkolla e Vizatimit bashkë me të gjithë ish mësuesit dhe ish nxënësit e saj kanë një vend të rëndësishëm në Historinë e Artit Shqiptar. Në atë shkollë u hodhën hapat e para në rrugë profesionale për zhvillimin e arteve figurative. Aty e kanë pikënisjen disa nga tablotë më të mira të traditës, aty morën mësimet e para mësuesit e ardhshëm të brezit më të ri të artistëve shqiptarë.

Para pak ditësh në Itali u botua një monografi për piktorin Mario Ridola. Libri është shkruar nga historiani, studiuesi dhe shkrimtari i njohur Bruno Castagna. Siç paraqitet edhe në atë botim veprimtaria më e rëndësishme e artistit italian është drejtimi i Shkollës së Vizatimit në Tiranë e viteve '30. Monografia kushtuar drejtuesit të së parës Shkollës Arti në Shqipëri, shoqërohet me dy parathënie nga dy historianë të artit Antonio Falbo dhe Ferid Hudhri.

Hayez, Lotto etj. Pas periudhës së Rilindjes e deri në ditët e sotme ekzistojnë disa qindra vepra arti me motive shqiptare të realizuara nga

piktorët dhe skulptorët A. Deveria, F. Agricola, B. Pinelli, A. Preziosi, E. Baroni, L. Basiletti, A. Beltrame, A. Biagini, S. Bullo, M. Cavalla, P. Conti,

U. Giunti, R. Romanelli, L. Piffero e shumë të tjerë.

Një pjesë e madhe e krijimeve artistike u realizuan gjatë shekullit të XIX, në atë kohë kur u shtuan më shumë përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe pavarësi. Në vitet e mëpasshme, sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XX, artistët italianë udhëtuan dhe pikturuan më shpesh midis shqiptarëve. Piktori i njohur Aldo Carpi para se të bëhej profesor, dekan dhe drejtor i Akademisë së njohur Brera në Milano kishte vizatuar nëpër trojet shqiptare motive të ndryshme nga jeta e përditshme. Të kësaj periudhe, midis viteve 1916-1918, janë edhe disa peizazhe e tablo të pikturuara nga Arturo Bianchini, Gino Romiti, Tommaso Cascella etj. Pak vite më vonë në Romë u organizuan ekspozita të veçanta me piktura me temë shqiptare nga Vincenzo Ciardo, Giorgio Oprandi dhe artistë të tjerë italianë.

Në lakun kohor të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të kaluar, kur studiot e artistëve italianë ishin pasuruar me më shumë motive shqiptare, erdhi për të pikturuar në Tiranë edhe Mario Ridola. Që në muajt e parë të njohjes me botën e shqiptarëve, piktori Ridola u bë i pranishëm në dy veprimtaritë më të rëndësishme të asaj kohe; më 10 maj të vitit 1931, kur u krijua shoqëria Miqtë e Artit në Tiranë dhe, më 24 maj, kur u hap Ekspozita e Parë Kombëtare e Artit Shqiptar. Ridola e pa me sytë e tij suksesin e menjëhershëm të ekspozitës. Edhe në shtypin e kohës u shkrua se *Ekspozita e artit e mrekulloi publikun e Tiranës me bukurinë dhe shkëlqimin e saj!* Arritjet e Ekspozitës e afruan realizimin e idesë së hershme të artistëve shqiptarë se koha për të hapur një Shkollë Arti kishte ardhur. Vetëm pak muaj pasi piktori Andrea Kushi kishte çelur kursin e vizatimit, në Tiranë u hap Shkolla e Vizatimit, e para Shkollë Arti në Shqipëri.

Dokumenti që njofton themelimin e Shkollës së Vizatimit mban datën 29 janar 1932. Sipas shkresës së Ministrisë së Arsimit: *Komiteti Artistik ka themelue një shkollë vizatimi që ka për qëllim me stërvitë në arte të bukura gjithë djemtë që tregojnë aftësi të veçantë. Shkolla është e drejtuar prej z. Prof. Mario Ridola, organizator i Komitetit Artistik, i ndihmuar nga Andrea Thanasi, profesor i gjimnazit<sup>1</sup>.*

Angazhimi i drejtuesit të shkollës ishte i përnjëhershëm. Sipas kronikës së kohës, artisti italian bëri një konkurs në të gjithë shkollat e Shqipërisë dhe ay që do të japë shenja talenti do të merret si bursist. Konkursi bëhet në mënyrë që z. Ridola të sigurohet se vizatimet që erdhën janë autentike t'atyre që i



Mario Ridola, *Pazari i Tiranës*, tablo e vitit 1931, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë

kanë nënshkruar. Askush tjetër's'ka vënë dorë mbi to<sup>2</sup>. Në shtypin e kohës botoheshin lajme për datat e konkurseve nëpër qytetet kryesore, shkruhej edhe për interesimin e të rinjve. As intelektualët më optimistë të asaj kohe nuk mund të mendonin se kërkesat për shkollë arti do të ishin aq të mëdha. Për konkurrimin në Tiranë, në një nga gazetatat kryesore të viteve '30, shkruhej: *U paraqitën 150 kandidatë, djem e vajza dhe instruktorët vunë re një interesim të madh për artin ndër të rinjtë shqiptarë, shumë më të madh se ç'e pandehnim. Salla në të cilën zhvillohet konkursi është shumë e bukur, e plotësuar dhe e stolisur në mënyrë që t'i inspirojë kursistët e zellshëm dhe të lehtësojë në zbulimin e disa talenteve e pasioneve artistike të panjohura. Fatkeqësisht salla është e vogël për 150 vetë!*<sup>3</sup>

Në vitet '30 kur Shkolla e Vizatimit hidhte hapat e para, nëpër Europë ishin në lulëzim rrymat moderne në pikturë. Ato po depërtonin edhe në shkollat dhe akademitë e njohura të artit. Shkolla shqiptare, ende në djep, do të çorientohej nga futja e atyre korrenteve të reja artistike. Drejtuesi Ridola dhe artistët shqiptarë A. Buza, O. Paskali, A. Kushi, me mësimdhënien e përkushtuar, si dhe përpjekjet për t'u përshtatur me psikologjinë dhe traditën shqiptare, krijuan profilin e një shkolle të kohës, me nivel e kërkesa të qarta profesionale, mbështetur po ashtu në trashëgiminë kombëtare. Ridola solli nga Italia disa modele në gips, kopje të kryeveprave të artit antik,



Kopertina e librit

për t'u mësuar nxënësve mjeshtërinë e vizatimit, raportet e dritëhijes, format e volumit, vlerat e plastikës dhe kompozimit artistik, ndjenjën e ritmit dhe të frakturës. Por, për të perfeksionuar aftësitë artistike, Ridola i kushtoi më shumë rëndësi

punës së studentëve përballë modeleve të gjalla. Nëpër atelietë e vizatimit, pikturës dhe skulpturës, erdhën për të pozuar djem të rinj, gra dhe burra me veshje tradicionale. Me portretizimin e tyre, nxënësit jo vetëm përvetësonin dijen mbi

artin e të vizatuarit, por, çka ishte më e rëndësishme, përpiqeshin të kapnin psikologjinë e personazhit e përmes tyre psikologjinë e vetë kohës, botën shqiptare të viteve '30. Ndërsa gjatë pikturimit të veshjeve njiheshin me mjeshtërinë e artit popullor dhe frymëzoheshin nga elemente etnografike të trashëgimisë kombëtare. Nga fundi i vitit të parë u konstatua se, siç ishte shkruar në një nga revistat e Tiranës, *Shkolla e Vizatimit tani është diçka më tepër se ç'dëfton emri modest i saj... puna që ka kryer z. Ridola na bën të shohim perspektivën e Akademisë Shqiptare t'Arteve të Bukura*<sup>4</sup>.

Mësuesi Ridola pikturonte edhe vetë të njëjtat modele me nxënësit e Shkollës së Vizatimit. Ndërkohë krijoi edhe tablo të tjera direkt nga natyra. Në kronikën e shkollës shkruhej se z. Ridola *q'është një pikturor i mbaruar, ka punuar gjatë këtyre muajve dhe ka bërë shumë tablo, vendosi që viti shkollor të mbyllet me një ekspozitë. I bije tablotë e tija, i ve nëpër mure bashkë me vizatimet e nxënësve, i thërret edhe pikturorët e skulptorët shqiptarë të marrin pjesë në ekspozitë*<sup>5</sup>. Nga ajo periudhë ruhen edhe sot në Galerinë Kombëtare të Artit Shqiptar në Tiranë portreti *Plaku me shkop* i ish-nxënësit S. Kaceli, si dhe punime të tjera nga I. Kodra, F. Stamo, N. Zajmi, K. Kodheli, Q. Grezda, L. Nikolla, G. Strazimiri, F. Pëllumbi etj.

Nga Shkolla e Vizatimit pjesa më e madhe e nxënësve u nisën për studime në akademitë e arteve të Romës, Firences, Milanos dhe Parisit.



Mario Ridola, *Artistja Gjusepina Kosturi*, pikturë e vitit 1938, koleksion privat, Amerikë



Pikturor Mario Ridola në studio, foto e vitit 1964



Nxënës të Shkollës së Vizatimit, Tiranë 1933



Një nga salla ku mësonin nxënësit e Shkollës së Vizatimit, Tiranë 1932

Pas diplomimit u kthyen në atdhe. Disa prej tyre u bënë mësues të brezit më të ri, të tjerë kontribuan në fusha

të ndryshme të artit. Megjithëse i kishin aftësitë dhe mundësitë të qëndronin dhe të pikturonin nëpër

Krijime nga ish nxënësit e Shkollës së Vizatimit në Tiranë. Sadik Kaceli, *Fshatari*, vaj në pëlthurë, 1933, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë. Ibrahim Kodra, *Vajza në dritare*, akuarel, ilustrim libri, 1934

Europë, ata ja kushtuan zhvillimit të artit shqiptar gjithë krijimtarinë dhe veprimtarinë e tyre artistike. Nga ajo kohë Ibrahim Kodra, pasi kreu Akademinë Brera qëndroi deri në fund të jetës në Itali. Pikturoi dhe ekspozoi midis artistëve më të shquar të Europës. Sot vlerësohet si një nga piktorët më të shquar të diasporës shqiptare. Ndërsa me veprat e krijuara prej artistëve të tjerë që u kthyen në atdhe pas studimeve akademike, u pasurua fondi i krijimtarisë artistike në Shqipëri. Emrat e piktorëve Kaceli, Zajmi, Stamo, Kodheli, Sejдини, Nikolla, Grezda etj., që dolën nga Shkolla e Vizatimit bashkë me gjeneratën e mëparshme të artistëve Idromeno, Rrota, Paskali, Mio, Buza, Kolombi, Paço, Koljaka, motrat Zengo, Jani, Tuçi etj., të cilët gjithashtu pasi kryen studimet nëpër Europë, u kthyen në vendlindje, sot përbëjnë brezin e krijuesve më të rëndësishëm të trashëgimisë shqiptare në art.

Pas vitit 1944 në Tiranë u hap Shkolla e Mesme Artistike "Jordan Misja". U ngrit Instituti i Lartë i Arteve, më pas Akademia e Arteve dhe tani Universiteti i Arteve. Në secilën prej këtyre institucioneve të rëndësishme do të përmendet vazhdimisht Shkolla e Vizatimit, si e para shkollë arti në Shqipëri që u ngrit në Tiranën e vitit 1932.

\*



Bruno Castagna, autori i librit Mario Ridola

Por pas vitit 1944 u krijua edhe një shkëputje tjetër e shqiptarëve nga zhvillimet artistike të vendeve perëndimore. Nga kufizimet e Luftës së Ftohtë gjatë atyre viteve në Shqipëri nuk mund të përmendeshin artistët nga Perëndimi. Kështu për shumë kohë nuk u kujtua asnjëherë edhe piktori Mario Ridola, i cili krahas veprave të artit me temë shqiptare, kishte drejtuar shkollën e parë të artit në Tiranë.

Edhe në vitin 1983, kur në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë u përkujtua 50 vjetori i Shkollës së Vizatimit, Ridola nuk u përmend. Bashkë me ish nxënësit, në atë mbrëmje përkujtimore morën pjesë dy ish mësuesit kryesor të shkollës, skulptori Odhise Paskali dhe piktori Abdurrahim Buza. Ish mësuesi Mario Ridola kish ndërruar



jetë 13 vjet më parë, por edhe i gjallë të ishte nuk mund të ftohej në atë përvjetor. Krahas Luftës së Ftohtë shqiptarët në ato vite po ndjenin edhe peshën e vetizolimit nga shteti komunist. Ndonëse ish mësuesit dhe ish nxënësit e Shkollës së Vizatimit që diskutuan në atë pasditen e 5 janarit të vitit 1983, nuk mundën t'i përmendin as edhe emrin, në mendjet e tyre, midis kujtimeve të shumta, gjithë kohës vërtitej imazhi i mësuesit dhe drejtorit të tyre. Mario Ridola nuk u kujtua atë natë, por kontributi i tij mbetet i paharrueshëm për të gjithë ish nxënësit e Shkollës së Vizatimit. Emri i tij zë një vend të veçantë në Historinë e Artit Shqiptar.

\*

Gjatë kërkimeve shumëvjeçare për studimin *Shqiptarët në Artin Botëror*, pas zbulimit të çdo vepre të re më lindte dëshira për të biseduar me autorin rreth mbresave gjatë ditëve të pikturimeve, si dhe për ndjesitë që provonin nga ndarja që kishte ndodhur me tablotë e tyre. Por ishte një mision i pamundur. Në ato vite as nuk mund të mendohej kontakti me artistët nga vendet perëndimore. Megjithatë, edhe në atë kohë të vështirë, ndodhi një rast i vetëm. Në javën e parë të nëntorit të vitit 1985 marr një letër nga Japonia. Piktoria Kimiko Amabe më shkruante për ditët e pikturimeve nëpër Shqipëri gjatë pranverës së vitit 1965. Kishte qenë bashkë me piktorin e shquar Inosuke Hazama (1895-1977). Në atë letër shprehej shumë mall, nostalgji dhe adhurim. Dukej si një poezi dashurie për Shqipërinë dhe shqiptarët. Midis të tjerave shkruante: *pikënisja ku unë mbështetem tani dhe më vë akoma në lëvizje është Shqipëria. Të mendosh në kohën tonë se ka një vend të tillë në botë, të duket gati-gati si ëndërr. Njerëzit ishin të pastër në shpirt. Fëmijët ishin të ëmbël, pors i engjëj, dhe s'besoj të ketë vend tjetër në botë ku fëmijët edukohen aq mirë sa atje. Po të mos ishte udhëtimi im në Shqipëri, një përvojë e çmuar kjo për gjithë jetën time, nuk do ta kisha gjetur sensin për të thyer mosbesimin njerëzor dhe s'dihet në do të kisha arritur ku jam sot në rrugën e mundimshme të artit.*<sup>6</sup> Interesi që ngjalli edhe te lexuesit e shumtë të gazetës *Drita*, ku u botuan fragmente nga kjo letër në dhjetor të vitit 1985, ma ngacmoi më shumë mendimin e dikurshëm për të kontaktuar artistët, por situata vazhdonte të ishte e njëjtë; e pamundur për t'u lidhur me artistët e huaj.

Pas viteve '90, kur Shqipëria u hap me botën dhe mundësia e komunikimeve ishte e madhe, m'u rikthye më e fuqishme ajo ide. Midis artistëve që kishin ardhur në gjysmën e parë të shekullit të kaluar



Piktura *Plaku me shkop*, një nga tablotë më të njohura të Andrea Kushit, është pikturuar në sallën e Shkollës së Vizatimit, sipas të njëjtit model që e pikturonin nxënësit bashkë me mësuesin i shkollës. Tabloja ndodhet në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë.



Model i luftëtarit shqiptar me veshje tradicionale në Shkollën e Vizatimit. Botuar në kopertinën e revistës *Minerva*, Tiranë, 1933. Aquarel nga ish nxënësi Sadik Kaceli.

më shumë sillja ndërmend Mario Ridola-n, mësuesin e parë të brezit të piktorëve shqiptarë të viteve '30. Dhe, për koicidencë, përsëri në javën e parë të një nëntorit tjetër, atij të vitit 2023, më vjen një email nga Italia. Më kërkohej informacione rreth veprimtarisë artistike të piktorit Mario Ridola në Tiranën e viteve '30. Fjalja e fundit e email-it: *Ridola era mio nonno. La saluto cordialmente, Bruno Castagna*, më befasoi edhe më gëzoi më shumë. Email-i ishte shkruar nga nipi i artistit Mario Ridola, nga historiani, studiuesi dhe shkrimtari i njohur Bruno Castagna. Një ngjarje e bukur në punën time si studiues. Për një çast m'u duk sikur u lidha me vetë mjeshttrin që kishte pikturuar në Tiranë.

Në se nga letra e piktores Amabe ndjeva mbresat, dashurinë dhe mallin e artistes për muajt e pikturimeve nëpër Shqipërinë e vitit 1965, nga komunikimet me shkrimtarin Castagna kuptova më mirë ndjesinë e krenarisë së nipit për veprimtarinë artistike të gjyshit piktor në Tiranën e viteve '30. U binda gjithashtu se lidhjet që i kërkoja dikur me autorët e tablove me temë shqiptare, lidhje që nuk u arritën as me fëmijët, po realizohen me nipërit. Historia vazhdon.

Ndonëse për Ridola-n kisha shkruar në librat *Arti i Rilindjes Shqiptare* dhe *Shqiptarët në Artin Botëror*, përsëri mora kënaqësinë t'i rihap edhe një herë skedimet e mëparshme, për të bërë kërkime dhe hulumtime të reja. Nga bashkëpunimi me studiuesin Bruno Castagna dolën në dritë disa tablo të tjera, të pikturuara në Tiranë apo edhe në studion e tij në Itali.

Deri dje kishim më pak të dhëna për artistin Ridola. Tani, pas një pune të gjatë e të kujdesshme të autorit të këtij libri, pas kërkimeve intensive për zbulimin e veprave të panjohura më parë, si dhe me hulumtimet e reja rreth jetës dhe krijimtarisë së piktorit në Itali, në Shqipëri dhe vende të tjera, e kemi të plotë të gjithë veprimtarinë artistike të mjeshtrit Mario Ridola. Me këtë libër rikujtojmë edhe njëherë fillimet e të parës Shkollë Arti në Shqipëri.

#### Bibliografi:

1. Sipas dokumentit që ruhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Tiranë, Fondi Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Dosja nr. 13, Viti 1932.
2. *Një djep i jetës artistike në Shqipëri*, revista *Minerva*, nr. 10, Tiranë, 13 maj 1932.
3. *Paraqiten 150 kandidatë në Konkursin Artistik*, *Gazeta e Korçës*, Korçë, 14 maj 1931.
4. Çika, N., *Një djep i jetës artistike në Shqipëri*, revista *Minerva*, nr. 10, Tiranë, 13 maj 1932.
5. Çika, N. (artikulli i cituar).
6. *Shqipëria vendlindja ime e dytë*, (përktheu nga japonishtja, Ilir Konomi), gazeta *Drita*, f. 16, Tiranë, 1 dhjetor 1985.

## I. Një libër për ringjalljen lazariane të orthodoksisë ndër shqiptarë

- *Ringritja e Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012)*, botim nga Fortlunturia e Tij Anastasi, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Tiranë 2014<sup>1</sup> -

Libri i fundmë i Fortlunturisë së Tij Anastasi, kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, me titull *Ringritja e Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012)*, i është kushtuar *historisë së ringjalljes së besimit të krishterë në Shqipërinë post-totalitare, në radhë të parë historisë së ringjalljes së kishës orthodokse autoqefale*, me institucionet, klerin dhe bashkësinë e besimtarëve të saj.

Për këtë histori është shkruar e diskutuar gjatë, janë harxhuar shumë energji intelektuale dhe energji të tjera. Na vjen mirë a na vjen keq - në fakt është për të ardhur keq - këto diskutime janë zhvilluar më së shumti jashtë kishës dhe kryesisht në dëm të saj. Pas një gjysmë shekulli ateizëm, *orthodoksia u gjend para një forme tjetër demonizimi*, shprehur deri në *përdallimin e saj tinzar me zgjedhjet e tjera të mundshme të besimit në Shqipëri*. Ndërsa qendrimi i kishës vetë, siç shprehet autori i librit, ka qenë i mjaftuar me pohimin lakonik: *Të të mjaftojtë Perëndia!*

Ekspansioni propagandistik nga njëra anë, shpesh i shoqëruar edhe me mbështetje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë politike, deri tek përpjekja për ta faktorizuar besimin për ndikim e pushtet; si dhe qendrimi disi larg këtij rrafshi të debatit nga ana e Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë nga ana tjetër, kanë krijuar një pasqyrë të shtrembër për procesin e vështirë të ringritjes së kësaj kishë në periudhën më të fundme. Libri *Ringritja e Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012)* vjen për ta historizuar këtë proces, për ta certifikuar dhe vërtetuar me interpretime dhe dokumente që kanë munguar, duke ndihmuar për një *ndërrim regjistri* në debatet e deritashme: *nga ai agjitativ në regjistrin certifikues-dëshmuar*.

Kryepiskopi Anastasi, profesor e akademik gjithashtu, është autor i disa dhjetëra veprave të botuara me karakter shkencor, teologjik, filozofik, antropologjik e kulturor. Por kjo është një vepër krejt e veçantë, është një vepër që mund të quhet *misionare*, sepse hedh dritë në mënyrë prapavajtëse në të vërteta që nuk dihen ose dihen keq, duke provuar të vërtetat. Dhe në mënyrë të veçantë shërben për të rikonfirmuar autoqefalinë e kishës orthodokse shqiptare, e cila nuk mbaroi në vitin 1967, siç thuhet ndonjëherë, duke iu referuar shpërthimit të furisë ateiste, të sanksionuar më pas në kushtetutën e vitit 1976, sepse ligjet shtetërore nuk mund të anulohet vendimin e shpallur me tomosin patrikal të vitit 1937.

Ky është një libër nga i cili mund të mësojë çdo lexues. Besimtar apo mosbesues, i krishterë apo i papagëzuar, shekullar apo doktrinor, nga ky libër mund të mësohet se krishterimi apostolik është predikuar jo vetëm *rrath e përçark në Illyricum*, siç thuhet në *Epistullën e Shën Palit romakëve* (15:19), por edhe në *anësoret e Via Egnatia-s*, një prej arterieve orientuese të rëndësishme parësore krishtërore në Mesdhe.

Mund të mësohet se periodizimi i historisë së kishës orthodokse të Shqipërisë *nuk e ndjek në mënyrë simetrike dhe analogjike periodizimin e historisë së Shqipërisë vetë, ashtu sikurse nuk ka simetri*

<sup>1</sup> Paraqitur si recension në ditën e përrimit të kësaj vepre në kishën metropolitane të kryeqytetit.

# DY RECENSIONE TË HERSHME DHE PAK FJALË KUJTIMI PREJ NJOHJES VETJAKE

Nga Shaban Sinani

*dhe analogji të plota midis ndarjes së saj etnografike e administrative me organizimin kishtar të vendit në njësi kishtare.*

E rëndësishme është theksuar prej një kryepriosti, siç e quante veten Noli, që autoqefalia nuk është një dukuri historike e shekullit të 20-të, sepse deri në vitin 1767 kryepiskopata e Ohrit jo vetëm e kishte pasur këtë status, por *kishte funksionuar si patrikanë, shkalla më e lartë e hierarkisë kishtare*, dhe mbase prej këtij statusi mund të shpjegohen dhe shumë zhvillime të rajonit, si lulëzimi i Voskopojës.

Rruga që ka përshkuar Kisha Orthodokse Autoqefale e Shqipërisë drejt statusit që ka sot ka qenë mjaft e ndërlikuar dhe se kanonizimi i këtij statusi nga kryeqendra e kishës-mëmë në Konstandinopojë është *shenjuar vetëm në vitin 1937*, një fakt që nuk thuhej me të shkruar gjëkund. Ky vendim më së fundi pajton autorin e librit me themeluesin e autoqefalisë Fan S. Noli, për të cilin ai qe shprehur se *po të ishte gjallë do të ishte miku i tij më i mirë*.

Theksohet me të drejtë në libër se *autoqefalia e një kishë mund të rrezikohet jo vetëm nga jashtëvarësia, por dhe nga varësia e brendshme prej pushtetit politik*, siç dëshmohet me Statutet e dy periudhave, të asaj mbretërore dhe të asaj totalitare, gjegjësisht në vitet 1929 dhe 1950.

*I vështirë ka qenë drejtqendrimi kanonik për kishën orthodokse*, përdërisa edhe gjatë shekullit të 20-të ka pasur klerikë të shuguruar dhe të tillë që *nuk e kanë marrë ndonjëherë shugurimin kanonik*, pavarësisht se kanë ushtruar detyra meshtarë dhe priftërie.

Lexuesit i bëhet vërtetësisht e ditur se çfarë pengese e jashtëzakonshme ishte për bashkësinë orthodokse boshllëku ligjor në të cilën u gjend kisha e saj në fillimet e shoqërisë së hapur, kur i vetmi akt juridikisht në fuqi ishte *Tomosi mbi bekimin e Autoqefalisë së Kishës Orthodokse në Shqipëri* i muajit prill 1937, që botohet për herë të parë shqip në këtë libër.

Përkundër historisë së saj mijëvjeçare, si një prej kishave më të hershme të Krishtit në Europë, viti 1990 e gjeti kishën e

krishterë lindore të Shqipërisë me gjithsej 12 meshtarë e 3 dhjakonj të gjallë, pa asnjë episkop, pa asnjë mitropolit. Mjafton ky fakt për të kuptuar se *sa e vështirë ka qenë ta mbash kryqin*, po të perifrasonim titullin e meshës celebruese të Fan Nolit - *Mbaje Kryqin!* - për vetë Kryepiskopin Anastasi, në kushte të fyerjeve, denigrimeve, mosbesimit e paragjytimeve.

Institucionalizimi i hierarkisë kishtare brenda Kishës Orthodokse Autoqefale; rindërtimi administrativ i saj; krijimi i sinodit të shenjtë kishtar dhe formimi i klerit të të gjitha niveleve; kanë qenë sfida të jashtëzakonshme, jo më pak të vështira se ringritja e kishave, manastireve, enorive, shkollave, akademive dhe universiteteve.

Në mënyrë të pabujshme kisha orthodokse e Shqipërisë përballoi me dinjitet nënçmimin hierarkik edhe përmes ligjit, siç qe *rasti i projektit aventuresk dhe të dështuar të kushtetutës së vitit 1994*, duke arritur shkallën më të lartë të legjitimitetit të saj me Statutin e ri të vitit 2006, i vetmi statut në historinë e Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë që është në harmoni me *Tomosin mbi autoqefalinë* dhe njëherësh me *Kushtetutën e Shqipërisë* të vitit 1998. Nënshkrimi i marrëveshjeve me qeverinë në formën e konkordateve për respekt të ndërsjellë në kushtet e një shteti shekullar është gjithashtu një rregullim *à la France*.

Po të zgjidhnim të shpreheshim me një sintagmë të botuesit frëng Claude Durand, pas viteve 1990 Shqipërisë i është dashur një *ringjallje lazariane*, dhe libri i Kryepiskopit Anastasi është pasqyrë e kësaj ringjalljeje, e cila ka si pikënisje predikimin e ungjillit të Krishtit në rrënojat e kishave të vjetra, në sheshe publike, deri shugurimin e një meshtari në Korçë në ballkonin e një familjeje besimtare. Nisur prej kësaj pike reference, ajo që ka ndodhur me Kishën Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë gjatë 22 vjetëve të fundme është me rëndësi epokale. Dalja prej profanisë dhe besimit të fshehtë dhe bashkimi me krishterimin kanonik e sakramentet e shenjta; themelimi i shkollës së parë priftërore dhe i shërbimit murgjërë; ngritja e Akademisë në Shën Vlash; akreditimi i universitetit *Logos*, ndërtimi i kishës katedrale në qendër të kryeqytetit ngjashmërisht me Shën Sofinë; shkollimi e dorëzimi kanonik i mbi 150 priftërinjve shqiptarë; hierotonisja e episkopëve të parë vendës; rithemelimi i mitropolive të Beratit, Gjirokastrës dhe Korçës; funksionimi i një rrjeti shkollash të profilizuara si lice, gjimnaze dhe të tjera profesionale, ndër të tjera dhe i një shkollë për muzikën bizantine; shumë nisma filantropie dhe solidariteti, duke përfshirë një kontribut shenjues në krizën e madhe të shpërnguljes së shqiptarëve të Kosovës; restaurimi i monumenteve historike të kishës, i ikonave dhe ikonostasëve; vëmendja për kodikët e shenjtë dhe dorëshkrimet e arkivat kishtare në përgjithësi; manifestimi shembullor i bashkëjetesës si një model europian



pikërisht në ditët e lëndimit më të rëndë të saj, në ditën kur terrori shtiu në shënjestër pikërisht Parisin; janë vetëm disa prej atyre nismave që do të mbeten në historinë e kishës së krishterë në përgjithësi, madje dhe të historisë së besimeve në Shqipëri.

Nuk ishte shkruar më parë (përveçse në studimin e shkëlqyer të dy viteve më parë, me titull *Pluralismo confessionale e comunità religiose in Albania*, të përgjegjësit të katedrës së së drejtës së krahasuar kanonike kishtare në Universitetin e Bolonjës Giovanni Cimbalo), *për rishfaqjen e ndikimit të kishës shqiptare ndër arbëreshë për një kishë administrativisht të njësuar* edhe në fillimin e viteve 1990 (siç patën shpresuar misionet baziliane nga fillimi i shekullit të 18-të dhe Fan S. Noli në vitin 1924, me idenë e tij për një kishë kombëtare), prirje që autori e ka cilësuar si *rrezik parësor për orthodoksinë*, ndonëse dihej për takimin e imzot Kissi-it më 1942 me ipeshkvinj arbëreshë për një qendrim të përbashkët përgjatë luftës antifashiste, fakt që *përbën një ndalesë intriguese* në librin e Kryepiskopit.

Veprës ia shtojnë rëndësinë një varg dokumentesh të rendit parësor për kishën, besimtarët e saj dhe popullin shqiptar.

Një vepër të ngjashme pati shkruar në gjuhën angleze në vitin 1958 Theofan S. Noli, kryepiskop i parë i kishës orthodokse të shqiptarëve në Amerikë (*Fiftieth Anniversary of the Albanian Orthodox Church in America: 1908-1958*, Boston 1960), për fat të keq dhe kjo e njohur shumë pak në botën shqiptare deri në kohën e botimit të kësaj vepre të Kryepiskopit Anastas, për shkak se u shkrua në anglisht.


Me këtë vepër Fortlunturia e Tij na sjell ndërmend një varg klerikësh dijetarë të ndritur, prej Joasafit të Voskopojës, Anthim Aleksudhit - mikut të dijes, siç njihej nga të gjithë; Joakim Martinianit e Evllogj Kurillës, deri tek studiuesit e kohëve më të reja, si Theofan Popa, Dhimitër e Kristofor Beduli, Hirësi Joan Pelushi e mjaft të tjerë. Vepra të tilla të përforcuara bindjen se kult e kulturë nuk mund të ndahen.

## II. Për botimin shqip të *Mujorit*, vëllimi I-IV, përgatitur nga *Àt Justin*?

Përkthimi dhe botimi shqip i *Mujorit*, vëllimi I-IV, jashtë çdo dyshimi, ka qenë një punë shumë e vështirë dhe e mundimshme.

Àt Justin Athimiadhi, autor i përkthimit, përshtatësit dhe botimit, që ka ndërmarrë këtë nismë të jashtëzakonshme, meriton nderimin e teologëve, meshtarëve, klerikëve dhe të çdo lexuesi, besimtar apo laik qoftë. *Mujori* shqip pasuron bibliotekat dhe në mënyrë të veçantë është një provë se *si mund të funksionojë gjuha shqipe me virtyt të plotë edhe në regjistrin e ligjërimit kishtar*, pavarësisht ngrirjes

<sup>2</sup> Ky vlerësim m'u kërkua disa vjet më parë nga Kryepiskopi Anastas. Tashmë *Mujori* ka një botim të numerizuar në faqen e KOASH dhe botimi me këtë rast është shprehje nderimi për të dhe për autorin e përkthimit.



së përkohshme për shkak të ateizmit shtetëror.

Ndryshe prej traditës së përkthimit të teksteve biblike dhe ungjillore, të mesharëve dhe katekizmave, të doktrinave të krishtera, të librave didaskalikë, tradita e përkthimit të *minejve* dhe *troparëve*, të librave kalendarikë dhe të të kremteve e festave (*Pesëdhjetorja*, p. sh.), është shumë më e vonët, disa shekuj më e vonët. Nevoja e përkthimit të këtyre librave lindi ku nisi meshimi shqip. Me përjashtim të Fan S. Nolit dhe të Visarion Xhuvanit, pak emra mund të përmenden si kontribuues të kësaj tradite. Kjo ka qenë vështirësia e parë për autorin.

Mund të pohohet me bindje se shqipja e ka kaluar me shumë sukses *provën e vetëmjaftueshmërisë* së saj me përkthimin e *Shkrimeve* (që nga Buzuku tek Kristoforidhi), por jo dhe aq me përkthimin e librave që janë krijuar për një përdorim elitare, kryesisht si libra të njerëzve të sakramentit të priftërisë. Dhe kjo është një vështirësi e dytë.

Përkthimi i *Mujorit* i nënshtrohet një hermeneutike që është krejt ndryshe prej hermeneutikës laike. Në hermeneutikën kanonike përllogaritja e fjalës, rrokjes, tonit, theksave, gjatësisë së zanoreve etj. nuk është çështje formale. Kjo është një vështirësi e tretë që duhet marrë në vlerësim në këtë rast.

Së katërti, duke njohur karakterin konservativ të gjuhës së kishës, që është një dukuri botërore, mund të supozojmë se përkthimi është bërë jo nga greqishtja popullore (*δημοτική γλώσσα / νεοελληνική κοινή*), por nga greqishtja e pastër e njohur si *katharevusa* (*καθαρεύουσα*), që ka kodin e vet specifik ligjërimit dhe shpesh kuptimet nga ligjërimi kishtar në ligjërimit popullor kanë mërguar prej njëri-tjetrit.

Mbi të gjitha nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes faktin e përmendur nga vetë përkthyesi në shenjimin hyrës, që gjatë shqipërimit ka qenë e domosdoshme të merrej në konsideratë karakteri himnodik i lëndës, pajtimi i rregullave të prozodisë letrare-gjuhësore me kanonin muzikologjik, ndonjëherë duke ia nënshtuar të parën të dytës.

Theksosjmë me këtë rast dy paralajmërime që i bëhen lexuesit në hyrje: që ky është një përkthim i përkohshëm, për përdorim të brendshëm, dhe së dyti, që disa gabime gjuhësore janë pranuar qëllimisht.

Përkthyesi ka bërë mirë që ka integruar në tekstin e *Mujorit* edhe fragmente përkthimesh të mëhershme, që na lejojnë të kuptojmë se *ikja prej gramatikës formale*, që vërehet në tekst jo rrallë, ka ndodhur edhe më parë dhe nuk është çështje e kompetencës gjuhësore, por e kanonit specifik të përkthimit. Po përmendim, sa për shembull, *rrokjen formale të munguar*, sidomos në rastin e zanores *ë* formale, por edhe në rastin e *elizionit ndërvokalik* (kur takohen dy zanore bashkë), që rregullisht e gjejmë të shprehur me apostrof edhe në fragmentet e përkthyer më herët, njësoj siç ndodh në transkriptimin e teksteve të këngëve popullore, të cilat *disiplina muzikologjike i ndëshkon vokalisht dhe gramatikalisht*, duke i kthyer në 8-rrokësh apo 10-rrokësh edhe nëse lexuar ndaras prej fletës muzikore nuk janë ashtu.

Duke i vlerësuar të gjithë këta faktorë së bashku mund të thuhet se:

*Mujori* i përkthyer nga At Justin Anthimiadhi është një vepër që i shërben forcimit të stilit ligjërimit ekleziastik të shqipes së sotme, ligjërimit që është ende në provë e sipër. Le të mos nxjerrim nga mendja se në kohën kur konsolidoheshin stilet e tjera të ligjërimit të shqipes, duke përfshirë edhe filozofinë, dituritë elitare, ligjërimit fetar ishte i ndaluar dhe kjo



doemos do të shkaktonte një vonesë relative;

Lexuesi-model, nëse me këtë term kuptojmë lexuesin e shkolluar dhe me kulturë fetare e gjuhësore mbi mesataren, jo atë përdorues që italishtja e njeh me termin *dislessico*, me siguri nuk vëren mungesë kompetence gjuhësore të përkthyesit (ndonjë përjashtim i rrallë në rendin sintaksor duhet të ketë lidhje me *diktatin e toneve muzikore*). Përgjigjen për këtë pyetje na e ka njoftuar autori vetë: *gabimi i qëllimshëm, gabimi i vetëdijshëm*. Në rast të një ribotimi kjo kategori gabimesh mund të shenjohet formalisht për t'ia bërë të ditur lexuesit, njësoj siç është përdorur asteriksi i kuq për të njoftuar se ka përkthim të mëparshëm.

Në lidhje me komunikueshmërinë, jemi të detyruar të dallojmë një hierarki dyshkallëshe. Besojmë se njeriu që ka zgjedhur sakramentin e shërbimit të meshtarisë, murgjërës, oshënarisë, nuk ka probleme komunikimi. Sa i takon lexuesit të gjerë, *Mujori* shqip nuk është aq bujar sa të ofrohet lehtësisht për vetëlexim. Pra, nuk i drejtohet një lexuesi popullor. Në këtë shkallë të dytë të hierarkisë së leximit *Minej* është në një shkallë jo të vogël hermetizmi. Por kjo duhet të jetë njësoj edhe në gjuhën e burimit. Vështirë është për t'u përfytyruar se besimtari apo lexuesi laik i zakonshëm grek, me formim të zakonshëm në orthodoksi, nuk ka probleme receptimi të teksteve të tilla.

A mund të ishte më i afërt ky tekst me gjuhën popullore? Mund të thuhet se po. Këtë pohim e mbështesim në krahasimin e përkthimeve të mëparshme me tekstin integral të At Justinit. që janë me një gjuhë më të thjeshtë, më të çliruar prej termave të gjuhës së urdhrit. Ndërsa në tekstin integral të *Mujorit* ka forma dhe fjalë, qoftë neologjizma, qoftë kalke, qoftë huazime, që e ndërlikojnë kuptimin. Me sa duket At Justin ka preferuar më mirë besnikërinë si primat se tejudkshmërinë e leximit popullor. Sigurisht ai ka marrë në vlerësim edhe karakterin e këndueshmërisë të tekstit, që duhet të jetë fund e krye *cantabile*, dhe këto përlligjin këtë shkallë ndërlikimi.

Në botime të tilla shpjegimet jashtëtektore nuk janë të pëlqyera,

prandaj autori me të drejtë është rezervuar në përdorimin e tyre, por një fjalorth terminologjik, i fjalëve të rralla, i neologjizmave dhe kalkeve, që përfaqësojnë një rezervat të vërtetë për gjuhëtarin, do ta ndihmonte mjaft lexuesin tjetër, të pamësuarin, ose atë që dëshiron të vetëmsohet.

Në përfundim, vlerësojmë si një kontribut të rëndësishëm botimin e këtij korpusi të tipologjisë minej (mujor), që ka traditë në dorëshkrimet kishtarë të ruajtura në AQSH, në fundin e kodikëve, shkruar kryesisht në gjuhën greke. Duke qenë të paralajmëruar nga përkuqjesësi, njëherësh përkthyes e përgatitës, që përkthimi është për përdorim të brendshëm, që do të thotë jo për lexim popullor; duke qenë të paralajmëruar po ashtu prej tij për *gabimin e vetëdijshëm* (që ka të bëjë me pajtimin e tekstit gjuhësor me formulën muzikore, dy rende shpesh herë me prirje për t'iu larguar njëri-tjetrit - kënga në fund të fundit nuk është gjuhë), gjejmë shpjegim të plotë edhe për *prishjen e gramatikës* rast pas rasti. *Stabilizimin e ligjërimit ekleziastik në shqip* është një prej kushteve të konfirmimit të plotësisht të funksioneve të shqipes letrare.

### III.

Në jubileun e madh të 2000-vjetorit të Krishterimit u gjenda në krye të rrjetit kombëtar të arkivave dhe pata privilegjin e përgatitjes së kuadrit juridik për lejimin e pranisë së një vëllimi të kodikut më të hershëm të ruajtur në Shqipëri, *Codex Purpureus Beratinus* në ekspozitën jubilarë që u organizua në Romë nga Selia e Shenjtë. Kjo kërkonte jo vetëm miratim me vendim qeverie, vlerësim në inventar nga një komision i posaçëm të kryesuar nga zëvendëskryeministri; hartim e nënshkrim kontrate me kushte sigurie në udhëtim e në ekspozim, përgatitje pasaporte e kartelesh shkencore për dorëshkrimin dhe botim artikulli në katalogun e *Ungjijve të Popujve (I Vangeli dei Popoli)*, por edhe një mirëkuptim të konfirmuar ndërkishtar dhe garanci për trajtimin protokollar në shkallën më të lartë si në nisje ashtu dhe në mbërritje e kthim të kodikut.

Pyetjet që i drejtoheshin shërbimit

arkivor për të dhënë shpjegime pse një kodik i shkruar greqisht, i ruajtur shekull pas shekulli në kisha e manastire orthodokse, duhej të paraqitej në ekspozitën botërore të dorëshkrimeve kishtarë në Romë do të merrnin përgjigje bindëse pas bisedave me Kryeepiskopin Anastas, paralel me organizimin e konferencës së përbashkët 2000 vjet krishterim në Shqipëri: *dorëshkrimet kishtarë duhej të konsideroheshin trashëgimi ekumenike*, për më tepër, *çdo shkrim i periudhës së paleokrishterimit dhe i periudhës deri në ndarjen ndërkishtarë të vitit 1054*, që, në fund të fundit, ndau kalendarët, gjuhët e liturgjisë dhe rregullimin administrativ, por jo doktrinën teologjike. Këtë qëndrim Kryeepiskopi e shfaqti edhe më pas, me nismën për krijimin e një strukture ndërfaqetare në Shqipëri.

Ndër rastet e pakëta që kam pasur mundësi të vërej e çmojjo vetëm përbërësen akademike, por edhe atë njerëzore të Kryeepiskopit, është *hapja e ekspozitës së miniaturave të kodikëve të Shqipërisë*, riprodhime cilësore të mundësuar nga KOASH; si dhe *hapja e një ekspozite të kodikëve më të hershëm në Pallatin e Brigadave*, në të dyja rastet me kujdesin e tij të drejtpërdrejtë. Për befasinë time, gjatë vizitës në ekspozitën e miniaturave, ai u ndal para njëres prej tyre dhe tha: *Ai që e ka krijuar këtë miniaturë* (ishte një shembëllturyrë e ungjilltarit Mattheu), *nga mënyra si i ka shkruar ato pak germa, duket se është jogrek*. Këtë pohim të tij e pata evokuar në një shkrim modest për kodet dhe simbolet në miniaturat e kodikëve të Shqipërisë dhe praninë e një varianti vendës të shkruarësve (*scribes*), kaligrafëve dhe *miniaturistëve*.

\*\*\*

Nëpërmjet këtij triptiku, mbase krijohet një pasqyrë e një pjese krejt të vogël të atij kontributi që Fortlumturia e Tij, Kryeepiskopi Anastas la në gjithë lamiet e përmendura, çka na siguron se përjetësia e figurës së Tij mes besimtarëve dhe laikëve, akademikëve e filantropëve është një destinë e sigurtë tash që Ai vetë prehet në amëshim.

Një heshtje solemne, paraja e shtetit derdhet lumë, me gjithë kurthet e tij, u prit me brohoritje dhe duartrokite klakerësh, të forta gjithandej, rreth e rrotull. Si mund të mendonin edhe kundërshtarët se *buxheti* do të ishte tipi që i lë miqtë e vjetër të librit në baltë? Ja, a nuk erdhi në momentin e duhur? Por, kujdes!

Por secili nga dashamirësit e librit e të kulturës në tërësi mbetën të çuditur kur gjeti në projekt një asgjë të madhe. PËR LIBRIN - ASGJË! Vërtet? Po, more! *Asgjë!* Shteti dhe buxheti e kish mbledhur mendjen të afrohej me ca fjalë aty - këtu, mirëpo kur vuri re se ai nuk po i tregonte shenja lëvizjeje, nuk protestonte por rrinte urtë e butë, si gjithmonë, i përqafuar në agoninë e tij, atëherë mendoj të mos e konsideronte fare. Po s'qau fëmija as e ëma s'i jep sisë! Si duket libri e adhuronte prehjen, ndonëse kishte një fytyrë të mbytur në lot.

E vërteta është se Buxheti gjigant, trupmadh e i rëndë, iu afrua, ia fërkoj kokën, madje edhe ia përkëdheli ca në nënkresë, librit. - I dashur, edhe unë jam sëmure pikërisht prej asaj që je edhe ti, or mik, por i kam duart të lidhura. S'kam ç'bëj! - tha gjiganti i Rablesë me hidhërim. - Ja, dje, ditën e shqyrtimit në Kuvend, zura shtratin, aq shumë kam qarë, kurse sot nuk ma mori mendja se do të isha në gjendje të vija as deri këtu. Ti e di, ma merr mendja, opinionion tim. Unë nuk dua, në heshtje bashkë kemi bërë një marrëveshje xhentëlmenësh, që po të shtrohej në Kuvend, për të arritur te një përshtypje e mirë, atëherë unë do të bëja të pamundurën. Por edhe ca këshilla të ashpra dhe mbikëqyrje të vazhdueshme do t'i jepja... Por s'e kam unë në dorë. Unë jam kot. Jam thjesht një thes i madh apo i vogël dhe për tyti më ka kapur një tjetër gjigant i rrethuar nga ca grykës të allasojtë, që aman o Zot! Janë ata që për ty thonë ca fjalë të pakëndshme dhe puna arrin deri aty sa të japin edhe ca flakërima të tmerrshme. Por kushedi tepron ndonjë thërrime, ndaj mos u leqendis aq shumë, se unë të kam zemër dhe se dua të bëj gjithçka për ty... Dua me shpirt që ta kem në mendje ëndjen tënde, dëshirat e mëdha, të dilja aty ku të dhemb ty, që të mos ikja me mendjen prapa...

Pastaj, kur libri (ah, i gjori libër!) zuri të thoshte: "Mbi të gjitha, nuk je ti ai që e ke tërësisht në dorë, madje as edhe të drejtën për të ndaluar dikë, sidomos ata që rrethojnë komandantin tënd që janë grykës të mahnitshëm, e bëjnë çdo gjë me një mjeshtëri të paparë, duke na poshtëruar keq e më keq. Dhe kështu ndodhi, pranova që ta zgjidh këtë me grevë urie, kushedi mos u vete mendja... Por ja që shpresa ime e fundit kaq e pat, ah, sa gjëra të bukura kisha ëndërruar..."

- Po çfarë? M'i thuaj, mos ndoshta hapet ndonjë dritare e vockël, kush e di.

Zhurma e asaj "grindjeje" sa vinte dhe dëgjohej gjithmonë e më pastër. Fjalët e paqarta që thuheshin lart e poshtë në korridore e salla, apo edhe jashtë, nga grupe të ndryshme njerëzish, po e mbytnin atmosferën. Gjiganti ndërkohë, i kërkoi t'i thoshte diçka, të paktën sa për ta ditur, se edhe kështu me mendje bosh nuk shkohej dot askund. Dhe libri i shkretë, ashtu papritur e pa kujtuar u ngrit tërë energji, ndonëse ishte në hekë, filloi:

- Dreqi e mori! E ç'na hyjnë në punë ca si këto! - shpërtheu duke tundur krahët.

Një drithërimë e gjatë lëkundte korridoret e sallat. Ndërkohë tingulli i një kambane tjetër lajmëronte mbërritjen e deputetëve në parlament. S'kishte shumë kohë...

Atëherë, për të parë më mirë, u ngrit në këmbë përmbi një ndenjësë të vjetër, si shtrojë halli, duke shkelur me këmbë buqetat me lule e trëndafilja. Duke hedhur vështrimin rreth e qark, libri përfshiu të gjithë horizontin e paanë. Në këtë orë të fundit të etheve, buxheti ishte ende i

Reportazh kontravers

## AS TRIUMFI NUK I JEP GJË LIBRIT

Nga Xhevair Lleshi



zbrazët, i mbyllur nga barrierat ngjyrë gri, ku ishin rreshtuar gardistët dy e nga dy, kush e di si vinin punët dhe bëhej ndonjë e paparë; kurse tryezat s'dihet pse ashtu të përbaltura përpara tij, prisnin që ai të shprehte dëshirat. Më tej, edhe larg edhe afër, duke ulur sytë, Buxheti dhe sojlinjtë që e rrethonin, shihnin lëndinën aty jashtë që gumëzhinte, ca të ngritur në majë të këmbëve, ca të tjerë të mbështetur tek bërrylat, mbërthyer nga pasioni gjithashtu, ndërsa fjalët e librit të gjorë përvëltonin nga ethet, madje dhe pëlhurat e perdeve e të tendave fërgëllonin, deputetët nxisnin përbrenda gjithë entuziazmin e nevojshëm në kësi rastesh të rëndësishme, midis këmbësorëve që rendnin për t'u mbështetur tek hallet e ditës. Ndërkohë, nga ana tjetër, kur LIBRI u kthye nga tribunat, figurat zvogëloheshin, masa e madhe e kokave s'ishte gjë tjetër veçse një larmi ngjyrash që mbushte rruginat, shkallët, tarracat, ku një rrasje profilesh të zeza shquhej nën qiellin e hapur të Tiranës. Më tej akoma, përreth podiumit ku qe vendosur LIBRI, atë çast duke se zotëronte gjendjen. Prapa korridorit të mbuluar më dredhëza, në të djathtë, ishte një skutë livadhi mbuluar me hije të mëdha; përkundrejt, kryqëzoheshin të gjitha dëshirat e fshehura, ku prisnin rreshtat e palëvizshëm të bibliotekave; në të majtë, i zgjeruar përsëri, peizazhi hapej drejt hapësirave kaltëroshe si gjithmonë boshe.

Njerëzit vazhdonin të vinin, si një vijë milingonash, nga një shirit i hollë rruge, në atë hapësirë toke; ndërkaq, shumë larg, pranë pallatit ku gatuhet Buxheti, publiku që nuk paguante, si të thuash një kope fushore, ishte në një vijë të lëvizshme pikash të errëta, rrafsh zbrazëtinë, poshtë pemëve, duke parë lart andej nga ku futbollistët kur bëjnë gol drejtojnë gishtat për plotësim dëshire...

Mirëpo një gëzim i papritur ngrohte mijëra frymë që mbulonin atë pjesë të bulevardit, lulishtes dhe sheshit pranë të dalldisur, pleq pensionesh, lypës modernë, hallexhinj të tjerë, shumë, shumë pensionistë, të tjerë me krevate spitalore etj., etj. Të dukej si një lëvizje insektesh, të hutuara nën qiellin e pamasë. Por vetëm kaq. LIBRI nisi të flasë:

- Inderuar Buxhet gjigant. Meqë m'u dha rasti dhe m'u kërkua prej zotërisë sate, po të shprehem hapur. Por, fare shkurt do të them se ç'kini bërë për mua! ASGJË! TURP E FAQE E ZEZE! Asnjë Bibliotekë publike!

Kanë mbetur vetëm ca të trashëguara! Mendo pastaj ku jemi! Mirëpo do t'i them. E kush janë gjërat e mia, pa e fshehur diellin, pa vajtur te derdhja si një det me dritë, duke ngrohur gjithçka përsëri, si një oksigjen, pa krela të arta, të panumërta, pa qenë as poshtë dhe as sipër turmës. A janë 61 bashki (njëra e stërmadhe me 11 bashki të tjera brenda), domethënë bëhen 72. Ja, të nderuar, në kërkim 72 biblioteka të bukura, të mira, të mbushura me libra, me revista e gazeta. Por janë edhe e pakta fare edhe nja 300 biblioteka institucionesh publike (shkolla, universitete, etj.) që na çojnë tek numri 400. Ja e sheh sa pak janë? Kurse në Norvegji janë tremijë biblioteka të mëdha që u merr autorëve dhe shtëpive botuese nga dhjetë ekzemplarë librash të rinj e të sapo botuar! Ja, pra, kush qenka Shteti korrekt!...

Salla duartrokite, të qeshurat e përsëritjes, krahët ngriheshin, tendoseshin si për të larguar retë. Gjithsesi, një gardist i vetëm ecte në mes të sallës kuvendore të zbrazët. Më lart, në të majtë, ishte një person me një flamur të kuq me shkabën e zezë në dorë. Buxheti hodhi sytë e dalë jashtë përreth, vuri re pa dashje midis atyre që shtyeshin deri tek kolltuku i vjetër ku qe vendosur LIBRI, i cili hiqte thellë, mes klithmave që rriteshin, si një bisedë që vazhdonte.

Fjalët që tha libri kërkonin që me një dorë të merreshin rreth katërmijë libra! Ata që rrethonin LIBRIN, vunë re se i mjeri u rrotullua nëpër shtroja ku e kishin vënë si në ekspozitë dhe i çuan tek hunda pak alkool, për të mos i rënë të fiktit. E vunë re edhe deputetët se fjala e pakët e librit korri një sukses në hyrje, ngjalli gjallëri, përqafoi shumë prej njerëzve me atë vështrim të butë. Priteshin kërkesa të tjera. Në 8,2 miliardë euro buxheti e kishte një qime atë kërkesë fare të thjeshtë që iu bë. Më në fund, edhe ngjyrat blu e të bardha u shfaqën. Mirëpo, Buxheti me ngjyrë tepër të mbyllur, me një formë që s'kishte të sharë, pothuajse e harroi kërkesën surprizë të librit. Askush nuk e kishte parë kështu, ku drita e diellit e praronte me një ngjyrë të verdhë, e cila shkëlqente në dritën e qiellit të nëntorit, ndonëse e ndjente se gjithçka i rëndonte në gjoks e thellë, në qafën të hollë e të zhdërvjelltë, në një nerv regtues dhe fin i shtyllës kurrizore.

- Ju e dini, - diktoi Buxheti, - që unë jam krenar për librin! Kam një frymëzim të çuditshëm... - përsëriste ai. - Hë? Çfarë

lëvizje! Shikoje sa urtë që rri! A nuk të vjen keq?...

- Kam frikë se do të trishtohem më keq, - belbëzoi libri në shtratin e tij.

Jo, s'ishte momenti. Të gjithë prisnin me ankth.

Kjo shkaktoi klithma nga publiku i tendosur.

- Shumë bukur!... Jo, kjo është rastësi!... E ç'rëndësi ka... u bë tani!

Gumëzhima u mbyt në ankthin që shtrëngonte gjokset e njerëzve. Tanimë, do të luhej në sallën e madhe. Heshtja mbretëronte, sikur fryma njerëzore qe ndalur krejt. Disa çoheshin dhe fytyrat dukeshin të zbardhura, tërë fërgëllimë.

Të gjithë në sallën e madhe e gjenin nga një fjalë për ta nxjerrë, nga një klithmë për ta shprehur. Të gjitha fjalët, klithmat, thirrjet, brohorimat sa vinin e zmadhoheshin, sytë e turmës ndiqnin ato pikat e ndritshme të... librit që nuk e prekte asnjë rreze dielli.

Tani fillonte e përpjeta, diskutimi në parlament, ku libri me siguri do të humbte terren, si gjithmonë i rrethuar me një vrull dhimbjeje patriotike.

Ishte një si ndjesi angështie e cila shtrëngonte në fyt të gjithë të pranishmit e grumbulluar aty. Edhe një disfatë tjetër! Dhe një lutje e zjarrtë, e çuditshme që ishte zjarr, gati fetare, ndërkohë që shahej e mallkohej, së bashku me ç'mbetej sja. Deputetët e bërë befas të rëndësishëm, e përshkonin hapësirën me një shpejtësi të frikshme.

Ndërsa, që rrotullohej lehtë e lehtë rreth vetes, vështronte te këmbët e librit atë dallgëzim njerëzish dhe idesh, atë det kokash si të shtyra përreth kësaj sale të njohur, nga vorbulla e diskutimeve, që çante horizontin me vijën e ndritshme, pastaj i shihte në profil, fare të vegjël, nëpër largësitë blu të sallës. Më pas, krejt papritmas, në një grumbull të madh pemësh të mbjella nga bashkia e Tiranës, ndonëse i mbushur me mospërfilljen e vet kombetare, u bë skandaloz, duke brohoritur për... librin! Duke qarë. Ky qenka për së mbari!, tha dikush.

Kjo do ta mërzieste atdheun tonë!

Askush për be nuk e zuri ngoje librin. As ministri i kulturës, që ishte tepër i acaruar dhe që kërcënonte seriozisht se do ta hidhte librin në gjyq për shpifje.

Dëgjoheshin klithma, thirrje, gjithandej.

Se kush po belbëzonte se libri dallohet qartë fare nga ngjyra e artë e tij... E shikoni tani! Ai flakëron së largu... Ja, pra një gjë që s'ta pret mendja!... Bah! Po kjo do të thotë vetëm asgjë. Për disa çaste me radhë, ky ishte opinioni i të gjithëve. Mirëpo, dalëngadalë, Buxheti i stërmadh, 8,2 miliardësh, po fitonte gjithmonë e më shumë terren, duke bërë përpjekje të pandalshme, për të përfunduar që tani në xhepat e llogaritit. Ky ishte momenti kur shpërtheu një emocion i paparë. Askujt tashmë nuk po i interesonte fundi i librit, i prurë me krevat spitalor në Kuvend. Një luftë e vërtetë po zhvillohej midis parlamentit dhe Buxhetit. Turma u thërriste me emër, i nxiste, edhe kur të preferuarit bënin përpara, edhe kur negcni ca prapa, me ca fraza të pandërprera, me belbëzime, me klithma. I ziu libër! Ç'e gjeti të mjerin! Ndonëse mbetej përgjithmonë ashtu i lartësuar, ndenjtur krejt i bardhë, edhe pse mbërthyer nga ca të dridhura, i prekur e i mallëngjyer siç ishte, saqë nuk qte në gjendje të nxirrte një fjalë nga goja. Pranë tij disave u kishte ardhur buzëqeshja në vend.

Sikur s'e paska mirë punën.

Çfarë ritmi! Çfarë shpejtësie, për besë!

Kësaj vetëtime i thonë mbledhje parlamentari. Dyndje fjalësh. Gërricje. Ofendime. Brohorima. Shpërthime shashkash.

Një buçimë e thellë doli nga gjoksi i librit. E tmerrshme. Askush s'ia vari. 8,2 miliardshi bufon mbeti si rreckë. Tashmë ishte grabitur i tëri dhe as një kacidhe për be s'mbeti për



librin e gjorë. I ruat gjigantëria! Pa libri punë e madhe, le të vdiste! Atë udhë ka marrë prej kohe. Pranë tij rrinte **Interneti** duke i vënë librit ca kompresë me utull, të paktën ta mbanin gjallë. Buçima-rënkim e librit, që hap pas hapi i ngjante buçimës së detit të dallgëzuar, u bë brutaliteti i fundit i një grumbullimi të madh qeniesh shpirtërore, i mijëra njerëzve të kthyer në ide fikse, që digjeshin nga e njëjta nevojë e rastit, e fatit.

Gjithandaj shtyeshin, ngjisheshin, shtyeshin, grushtet shtrënguar, goja e hapur, secili për veten e tij, secili duke fshikulluar vetëdijën e tij me zë e me gjeste. Por klithma e gjithë asaj mizërie fjalësh, si një ulërimë egërsire, rrokullisej e ngrihej gjithnjë e më lart:

Ja, ja... Ja ku është! Shtrirë! Aty le të rrijë! *Rroftë mbretëria e librit*. Ta kemi të paktën në Muzeun Kombëtar, por qenë të sigurt se as atje nuk do të gjente as një cep bosh...!

Deputetët po largoheshin dhe një furtunë sharjesh i priste jashtë.

Atëherë u pa diçka vërtet shumë e bukur. Doli dikush me një dorë të hekurt. **Libri** një plak i tharë, me fytyrë të gjatë, të ashpër e pa gjallëri, nxirrte flakë. Por, në atë vrull guximi të furishëm dhe vullneti triumfues, që i jepte zemrën e tij, forcë, e drejtonte, e nxiste, librin e trimëruar mes grahamave prej shkumës së bardhë dhe me sytë e përgjakur. Gjithçka kaloi si një gjëzim, duke prerë në mes frymëmarrjen, duke lëkundur ajrin; ndërkaq gjyqtari i paqit, tepër i ftohtë, me syrin në shenjë, priste. Dhe oshtiu, pas pak, një brohoritje e madhe. Me një përpjekje të jashtëzakonshme, duke mposhtur kështu frikën e fundit, gjë që shkaktoi atë si gjëzim deti kur trazohet prej dallgëve... Klithma gjëmonte, rrokullisej, zmadhohej, me një vrull prej furtune, duke mbushur pak e nga pak horizontin, thellësitë e pyllit në malin e perëndisë, lëndinave dhe rrafshinave të zbërdhulura të kryeqtetit.

Kori i kishës ku do të vendosej LIBRI rrethohej nga një entuziazëm i çmendur që kishte marrë udhët. Burrat hidheshin përpjetë, rrotulloheshin duke ulërirë; të tjerët, me ca të qeshura nervoze, hidhnin lart kapelat. Kurse nga ana tjetër e sallës, hapësira e rrethuar e diskutimeve përgjigje, madje një si trazirë lëvizte tribunat, ku s'dallohej gjë tjetër veç dridhjes së ajrit, si flakë e padukshme e një zjarri të madh, përsipër kësaj morie figurash të vogla, të çoroditura, me pikat e zeza të syve dhe gojën e hapur. Ishte diçka që nuk përmbahej dot, që fryhej, që rifillonte nga fundi i shtigjeve të largëta, midis turmës kompakte poshtë, për t'u hapur e zgjeruar në emocionin e tribunës gjiganteske që mbanin thesarin 8,2 miliardësh në shpinë, ku edhe ajri duartrokiste.

**Libri** mbeti një çast pa lëvizur, i shtangur nga triumfi i parasë dhe i grushtit të oligarkëve, duke vështruar sallën e pushtuar nga një lumë aq i madh njerëzish, saqë as ai nuk e shihte më tjetrin, që si e tërë koha jonë ishte e mbuluar nga një det kapelash të zeza. Pastaj, kur turma u hoq mënjane, duke u bërë në dy rreshta deri në dalje, duke përshëndetur përsëri dhe thirri:

-Ah! O Zot i madh! Çfarë fati! Kanë kaluar 34 vjet nga Nëntëdhjeta dhe sikur nga një bibliotekë të qe ndërtaur çdo vit, do të kishim tani të paktën 34 biblioteka, përveç 11 vatrave të kulturës të Tiranës moderne, që rënkojnë prej mungesës pse janë: librave.

Dhe, duke mos ditur si ta shprehte këtë gëzim që po e trondiste, rrëmbeu mendimin dhe heshti, ndoshta përjetësisht.

**Libri** dëgjonte gjithmonë emrin e tij, të cilin, e gjithë ç'linte pas historia, e kthente në jehonë. Ishin njerëzit e tij të rrallë që e duartrokisnin, ndërkohë që, duke qëndruar nën dritën e diellit, dominonte mbi të gjithë me shkëlqimin e shkronjave, dhe veshjen bardhë e blu, në ngjyrën e qiellit...

Tiranë, më 18 nëntor 2024

## Qendra e Studimit të Arteve prezantoi "Vjetarin artistik shqiptar"

Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prezanton "Vjetarin artistik shqiptar", VASH. Veprimtaria u zhvillua në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me praninë e kryetarit të këtij institucioni, akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetarit, akad. Vasil Tole, drejtorit të Qendrës së Studimit të Arteve pranë ASHSH-së, akad. Stefan Çapaliku, studiuesve e artistëve të njohur, si dhe specialistëve të arkivave nga institucionet e artit.

VASH-i është një projekt i Qendrës së Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila konsiderohet si vepra e parë në llojin e saj në ndihmë të kërkuesve shkencorë, pedagogëve, studentëve dhe publikut më të gjerë.

Akad. Stefan Çapaliku, drejtor i QSA-së, çeli veprimtarinë dhe pas fjalës përshëndetëse u ndal së pari në përcaktimin e objektit të punës, mbështetur në pesë aksione bazë, prej nga do të nisë një kontribut sistematik: krijimi i VASH-it; krijimi i Qendrës së Dokumentacionit Artistik; i bibliografisë retrospektive e studimeve mbi artin shqiptar, i enciklopedisë së artit shqiptar, historitë e fushave specifike të artit.

"Të gjitha këto detyra promovojnë idenë e restaurimit të memories dhe rifunksionalizimin e arkivave kulturore."

theksoi akad. Çapaliku.

Ai përmendi rëndësinë e arkivave në ruajtjen e historisë, kulturës dhe identitetit kombëtar, duke përfshirë në mënyrë të veçantë ato të institucioneve artistike, të cilat shërbejnë si një burim i pazëvendësueshëm për studime, dokumentim dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet të shkuarës, së tashmes dhe të ardhmes.

Akad. Çapaliku theksoi se dokumentet arkivore ndihmojnë në ruajtjen e një kulture të llogaridhënies, duke siguruar që institucionet dhe individët të jenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre.

Së fundi, akad. Çapaliku e vlerësoi krijimin e arkivave si një proces jetik. Ai theksoi se "Arkivat ndihmojnë që historia e artit dhe kulturës të përcillet në mënyrë të saktë dhe autentike, duke shmangur deformimet ose harrimin e kontributit të figurave dhe periudhave të caktuara. Pra, arkivat e institucioneve artistike janë jo vetëm një kujtesë historike dhe një burim edukativ, por edhe një urë që lidh gjeneratat përmes një trashëgimie të pasur dhe frymëzuese artistike."

Studiuesja e artit dr. Anxhela Çikopano tha se vjelja e arkivave të artit me një paraqitje kronologjike është një punë që duhet të kishte ekzistuar shumë më herët. Ajo vërejtje se ndaj fondit arkivor është treguar pakujdesi dhe

duhet të ringrihet dhe t'i rifitojmë arkivat. Dr. Çikopano prezantoi më pas rrugët që u ndoqën për realizimin e këtij projekti dhe kategoritë dhe burimet e zërave të vjetarit, kategoritë ndërdisiplinore dhe përfshirjen e personaliteteve. Faza e parë e realizimit ka përfshirë grumbullimin e materialeve faktike mbi ngjarjet artistike, kryesisht nga burime arkivore pranë institucioneve qendrore të artit, si dhe të atyre vendore, nga kërkuesit shkencorë të QSA-së në fushat e tyre të studimit: art pamor, kinema, muzikë, teatër, përmes hulumtimeve të drejtpërdrejta, ekspeditave në terren dhe verifikimit të të dhënave me metodën e krahasimit të kryqëzuar të burimeve të ndryshme. Veç paraqitjes kronologjike të ngjarjeve artistike në format e mësipërme të artit, është menduar të shtohen edhe nënrubrika si në artet pamore: fotografi, pikturë, skulpturë, mix media, etj., apo kategori si studime, ndërdisiplinore, personalitete, që ndihmojnë edhe më shumë cilindo që ka interes për këto fusha. Pasi foli për vlerat e VASH-it, dr. Çikopano tha se nëpërmjet dhe në funksion të këtij projekti do të ndihmojmë komunitetin e artistëve për të ringritur arkivat dhe njëkohësisht u është bërë një ftesë artistëve dhe drejtuesve të institucioneve dhe ministrive për të nisur një projekt të madh.

Studiuesja dr. Jonida Gashi vuri në dukje se ka ekzistuar mungesa e disiplinës në mbledhjen e arkivave të artit, dhe kjo e bën VASH-in një projekt më potencial, i cili në kuadër të rrjetëzimit të arkivave, në rastin më të mirë ofron një pasqyrë më të plotë të jetës artistike dhe kulturore.

Akad. Tole, duke vlerësuar punën e Qendrës, theksoi faktin që kjo vjen edhe si rezultat i reformës që është ndërmarrë vitet e fundit në Akademinë e Shkencave. Ai vuri në dukje vizionin programor afatshkurtër e afatgjatë të Qendrës së Studimit të Arteve, duke përfshirë projekte në të gjitha disipinat e artit. Ai theksoi hapjen dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ato drejtuese. Gjithashtu akad. Tole premtoi mbështetjen e Akademisë së Shkencave dhe bashkëpunim më të ngushtë me Komisionin e Arteve që ai drejton. Në fund akad. Tole shprehu vlerësimin për Vjetarin dhe shpresën që në vijim të marrë karakter enciklopedik.

Drejtesja e arkivave të teatros kombëtarë në Shkodër, Elbasan, Vlorë, diskutuan për problematikat e institucioneve.

Pas diskutimeve, Durim Taçi foli për perspektivën e një botimi më të plotë të Vjetarit Artistik Shqiptar (VASH) në një fazë të dytë, duke e pasuruar me informacion drejt krijimit të fizionomisë së një veprë të natyrës enciklopedike në fushën e artit, por pa harruar edhe përmasën divulgative të saj, përmes ndërkalljes së teksteve të shkurtra analitike, të cilat ndërpresin kronologjinë për hir të thellësisë dhe bëjnë që vepra veç studiuesve t'i shërbejë edhe një publiku më të gjerë.

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e përgëzoi grupin e punës së këtij projekti për iniciativën dhe arritjet e deritanishme dhe u shpreh për perspektivën e lidhjes së marrëveshjeve institucionale me qendrat arkivore. Ai theksoi se Qendra e Studimit të Arteve duhet të lidhet edhe me Qendrën e Botimeve Enciklopedike, sepse në realizimin e plotë të këtij projekti Vjetari artistik shqiptar do të marrë karakterin e një veprë të drejtimit enciklopedik. Në mbyllje të fjalës së tij, akad. Gjinushi premtoi se bashkëpunimi me arkivat do të institucionalizohet dhe do t'i jepet qendrës një drejtim bashkëpunues në perspektivën e finalizimit të një projekti më madhor.

VASH-i ka statusin e një udhëzuesi dinamik, që do të pasurohet në mënyrë sistematike nga kontributi i të gjithëve, duke i përfshirë të gjitha institucionet kulturore dhe artistike, kudo që të ndodhen: brenda kufijve të territorit të Shqipërisë, në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, por edhe në diasporë, me synimin për ta pasuruar me të dhëna të reja.

### Akademia e Shkencave e Shqipërisë Qendra e Studimit të Arteve

# VJETARI ARTISTIK SHQIPTAR

Publicisti dhe shkrimtari Emin Azemi gjatë kohë është i pranishëm në hapësirën tonë publike dhe kësaj radhe, përmes kësaj veprë voluminoze (në 3 vëllime) ai shpërfaq gjithë gamën e vrojtimit, përmes një “kamere” lëvizëse që ai e mban aktive në eksplorimin e temave, fenomeneve e ngjarjeve të cilat vijnë të zbërthyer nga një këndvështrim shumë specifik.

Tekstet e këtij libri 3 vëllimesh mbajnë vulën e kohës kur edhe janë shkruar, dhe si të tilla tejkalojnë përmasat e një kronike të thjeshtë, për faktin se këtu autori jo vetëm që evidenton në detaje jehonën e proceseve, por ai jep edhe mendime e vizione mbi rrugëzgjdhjen e shumë çështjeve, të cilat për kohën kur janë shfaqur kanë qenë ose tabu tema, ose tepër komplekse.

Të shkruara me një stil origjinal dhe me një pasuri gjuhësore, shkrimet e këtij cikli tre vëllimesh kanë bërë që Emin Azemi tash më të jetë një shkollë më vete e kultivimit të mendimit publik dhe e guximit profesional.

Ai është tepër analitik në qasje dhe gjithëpërfshirës në detektimin e problematikave, andaj shkrimet e tij mund të meren lirisht edhe si referencë e zhvillimit të rezonit intelektual në këto hapësira.

Të gjithë ata që nuk kanë pasur mundësi t'i lexojnë shkrimet e autorit, tani do të kenë rastin, në një variant të përpunuar dhe rishikuar të vendosin një komunikim të plotë me këtë korpus të madh tematik e përmbajtësor.

Paraqitja në këtë formë botimi, në tre vëllime, e ridimensionin autorin Emin Azemi në një dioptri të re receptimi, duke i dhënë atij rolin dhe rëndësinë e nevojshme në kontekstin tonë social-kulturor por që e arsyeton atë thënien “poeti nuk bëhet, por poeti lindet dhe ai e ka atë shkathhtësi e veçori t'i vërejtë ato gjëra që të tjerëve s'u bien dot në sy”. Në këtë kolanë librash voluminoz, me të lexuar faqet e para shihet se Emin Azemi i takon sojtit të krijuesve që lindin. Syrit të tij nuk i ka shpëtuar asgjë pa vërejtur dhe penës së tij s'i ka shpëtuar asnjë detaj i rëndësishëm pa u shkruar për një ecuri njëzetvjeçare të jetës së këtushme, në radhë të parë të shqiptarëve, por nuk mbeten anash as marrëdhëniet ndërmjet vendeve e popujve të Ballkanit e veçmas të politikave të fqinjëve tanë.

Para lexuesit del një cikël trevëllimesh i cili e ka shpëtuar nga harresa gjithë atë që ka ndodhur në Maqedoni, por jo vetëm në të. Aty në të vërtetë përshkruhet në mënyrë mastrale jeta jonë me batica e zbatica, me lëvizje anakronike dhe me paradokse të përcjella me hijet dhe pehlivanllëqet ballkanike, me zhurmat e një pale dhe heshtjen e palës tjetër, me krekosjen e disave dhe përuljen e të tjerëve. Krahas mugëtirës që e mbulon këtë kohë të përshkruar, librin e mbulon edhe një rreze e theksuar drite. Dhe, kjo dritë është puna me përkushtim e autorit, rrëfimi i qartë, doemos edhe mesazhet humane që përcjell ai.

Autori i largohet traditës ballkanike që patjetër të marrë anë, të bëhet “përfaqësues” i popullit “të përvujtur”, siç ndodh nëpër debate politike, në media dhe ndër politikanë të këtyre anëve ku secili e ngre zërin për “sinorin” e vet e për njerëzit të cilëve “u del zot” dhe shpesh shkelësi i të drejtave të tjetrit e shpall veten viktimë. Autori nuk është i tillë, ai nuk vepron sipas këtyre modeleve. Ai i përmbahet me vendosmëri qëndrimit të tij të shenjtë intelektual: vetëm flet për situata, rrëfen,

Rreth kolanës tre vëllimesh të librave “Helena e epikës sonë tragjikomike”, “Në mes të kauzës dhe mbijetesës” dhe “A kurohet mendësia?” të autorit Emin AZEMI, botuar nga Shtëpia botuese AGORAPRINT e Shkupit)

## NJË LIBËRI I CILI NA KA SHPËTUAR NGA HARRESA

Nga Xhabir Ahmeti

Emin Azemi është një autor që nuk i lejon harresës dhe heshtjes të shkelin në pragun e ngrehinës së tij krijuese. Si bleta që mbledh nektar lule më lule, edhe ai në shumësinë e problemeve i zgjedh temat për të cilat shkruan. Nuk lejon të përsëritet në asnjë trajtesë. Nuk lejon që të preket fjala – gur që fuqimisht e ndërton çdo fjali, ndërsa fjalitë, pastaj të renditura e të paluara mirë e bëjnë edhe kështjellën e tij gjuhësore të paluhatshme, që është një nga karakteristikat e këtij cikli tre vëllimesh.

dëshmon për ngjarje dhe të vetmin aleat në këtë punë e ka të vërtetën. Dhe, vetëm të vërtetën. E gjithë kjo kontribuon për vendosjen e një shtrati ku do të kalojë ai lumë i madh dëshmishë për një botë ku sundojnë shkelja e të drejtave njerëzore, mosmarrëveshjet, frika, jostabiliteti, pasiguria, por edhe përpjekjet që të ruhet pak dinjiteti njerëzor. Pikërisht këtu, te dinjiteti, Emin Azemi, ka pasur gjithmonë një vërejtje shumë interesante se ky dinjitet ndonjëherë nëpërkëmbet nga vetë të nëpërkëmburit. Kështu këndvështrimi i tij depërton si vizion i qartë nëpër kohë dhe arrin në çastin kur jetojmë, ku del në shesh se autori ka pasur të drejtë, sepse ecuritë kanë ngecur, gjërat nuk kanë lëvizur në kahe të mbarë. Në një prej shkrimeve të para disa vjetëve, këtë do ta formulojë bukur me këto fjalë: “Nëse dje ankohehim se të tjerët po na pengojnë të bashkëpunojmë, sot pa hezitim mund të themi se ne vet

po nxjerrim shumë cunga për ta bërë sa më të vështirë bashkëpunimin dhe komunikimin brendashqiptar”... Kjo është një vërejtje e cila është dashur të bëhet zile alarmi për politikanët shqiptarë, se koha është t'i largohen punës me duar në xhepa, t'u largohen veprimeve stihike, ta zbusin krenarinë e sertë e cila u pëshpërit atyre se gjithçka dinë vet dhe ta respektojnë mendimin e këtij autori, sepse vërejtja nuk vjen nga rruga, por vjen nga një personalitet i rëndësishëm, nga një personalitet me peshë për mendimin bashkëkohor politik, por që njëherësh është edhe personalitet i rëndësishëm i letrave të bashkëkohësisë sonë, fjalën e të cilit duhet ta respektojnë jo vetëm politikbërësit vendorë, por edhe ata që kanë ardhur në këto anë si misionet të OKB-së dhe të BE-së.

Në një shkrim të vitit 2002 autori përshkruan një situatë ku KFOR-i ka ndaluar një fshatar nga malësia, i

dënuar me 14 vjet heqje lirie, me të vetmin pretekst se para disa viteve paska shkrepur në ajër disa fishekë në shenjë kërcënimi ndaj forcave policore të cilët kishin ardhur t'ia rrënojnë shtëpinë për shkaqe konfuze të asaj kohe që prisheshin shtëpitë e varfanjakëve në emër të një urbanistike. Rënia me aq lehtësi e KFOR-it dhe UNMIKU-t në grackën mashtruese të propagandës së fqinjëve mbi shqiptarët nuk mund të prodhojë ndonjë efekt pozitiv, për vetë bazën kredibile të këtyre arrestimeve. Para se KFOR-i dhe UNMIK-u të arrestojë qytetarë shqiptarë, janë organet policore e gjyqësore të vendit ato të cilat kanë detyrim të dorëzojnë kriminelë serbë të luftës të cilët strehohen në rajon.

Viti 2002 ka mbetur shumë prapa nesh, por çështja e zbulimit të kriminelëve të shumtë serbë të luftës ka mbetur pezull dhe këtë çështje ia kanë lënë në dorë heshtjes dhe harresës. Kjo është një metodë serbe e mbulimit të gjurmëve të krimeve që kanë bërë ushtritë, palamilitarët dhe policët serbë mbi popullsinë shqiptare e maqedonase që nga vitet e okupimit 1912/1913. Kjo metodë ka qenë efektive dhe me të janë pajtuar edhe fuqitë vendimmarrëse të kohës. Si pasojë drama e papërshkrueshme e asaj kohe është mbuluar me harresë, sepse nuk ka pasur shkrime të mjaftueshme nga autorë të popujve të shkelur. Ky shkrim është dëshmi se si të dy palët, ato vendore dhe ato ndërkombëtare nuk i përfillin të drejtat e njeriut. Mirëpo, ja që kësaj radhe autori e ka shkruar bukur e qartë dhe ka lënë dëshmi të fuqishme për padrejtësitë që na janë bërë e të cilat do të mbeten si gjurmë të pashlyeshme të një kohe, të kohës së një brezi të intelektualëve humanistë, siç është Emin Azemi me shokë, që tërë jetën ia kushtoi me sukses penës, pa marrë parasysh pasojat që në këto vise ballkanike mund t'i ketë njeriu kur e thotë të vërtetën publikisht.

Jo rastësisht Kombet e Bashkuara e kanë miratuar Deklaratën për të drejtat e njeriut në vitin 1948 në mënyrë që ta pengojnë përsëritjen e Luftës së Dytë Botërore dhe njëherë e përgjithmonë ta përcaktojnë qartazi se të gjithë njerëzit nga dita e lindjes i kanë të drejtat e caktuara e të patjetërsueshme. Në këtë frymë autori shkruan, kësajori i zbërthen paradokset, absurdet dhe anakronitë e kohës. Dhe, kësajori shtrohet edhe kërkesa që kjo deklaratë të kthehet në fokus, duke pasur parasysh faktin se të drejtat e njeriut shkelen me të madhe kudo dhe nga të gjithë faktorët institucionalë vendorë, rajonalë e planetarë “kështu që parimi demokratik i vendosjes së shumicës bie në ujë për t'u zëvendësuar nga logjika minoritare e grupeve që imponojnë bllokadë, shantazh, konflikt”...

Po, ja që nuk respektohet kjo deklaratë as në vendet me tradita demokratike. Nëse është kështu, e them se kështu është, atëherë mund të merret me mend se çfarë ndodh në hapësirat tona ku demokracia mezi bëhet.

Emin Azemi është një autor që nuk i lejon harresës dhe heshtjes të shkelin në pragun e ngrehinës së tij krijuese. Si bleta që mbledh nektar lule më lule edhe ai në shumësinë e problemeve i zgjedh temat për të cilat shkruan. Nuk lejon të përsëritet në asnjë trajtesë. Nuk lejon që të preket fjala – gur që fuqimisht e ndërton çdo fjali, ndërsa fjalitë, pastaj të renditura e të paluara mirë e bëjnë edhe kështjellën e tij gjuhësore të paluhatshme, që është një nga karakteristikat e këtij cikli tre vëllimesh.



Në historinë e artit shqiptar emri i artistit Leon Çika (Tiranë, 12.07.1954 – 09.01.2025) do të vlerësohet si një artist i përmasave kombëtare: peizazhist “delikat” i natyrës shqiptare, por edhe si fotografi brilant që me pasionin, këndvështrimin dhe vizionin modern hodhi “hapa” të veçanta në rrugëtimin bashkëkohor të fotografisë artistike shqiptare të shek. XX-XXI.

Artisti Leon Çika pasi kreu shkollën e përgjithëshme “Petro Nini Luarasi”, në kryeqytet, u diplomua në ILA, Tiranë, në degën e grafikës-dizainit (1977). Diplomën e mbrojti me një seri kopertina librash ku për herë të parë u përdor kombinimi i shkrimit me fotografinë. Pas studimeve të larta Leoni u emërua piktori-skenograf në Pallatin e Kulturës në qytetin e vogël të Gramshit (Shqipëria qëndrore), ku përveç skenografisë hodhi hapat e para edhe si fotograf në dokumentimin e veprimtarive artistike. Më tej si piktor, artisti morri pjesë në grupin e 5 piktorëve për projektimin e interiereve të Muzeut Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Krujë (1979-1982), ku realizoi (në teknikën e afreskut dhe ikonave), disa nga shkrimet artistike në skenat (veprat) historike të sallave të tij. Nga viti 1981-1985, Leon Çika ishte shef i Laboratorit Fotografik të ATSH (Tiranë) ku me eksperiencën dhe pasionin e tij ndikoi në evolucionin artistik edhe të fotografisë së reportazhit. Ai ishte shef i departamentit të Fotografisë në Muzeun “Enver Hoxha” (1985-1989), ku arriti të printoi për herë të parë në Shqipëri fotografi në dimensionet e mëdha (16x4 m). Fotografi Leon Çika në vitet 1981-1982 sëbashku me Kostandin Lekën (në UT) vendosën kontaktet e para me Kompaninë amerikane “KODAK”, duke e futur së pari Agjensinë Telegrafike Shqiptare (ATSH), pra Shqipërinë në listën e klientëve të saj serioz. Një kontribut të veçantë, artisti Çika, ka dhënë edhe në mësim dhënie si pedagog në fakultetin e gazetarisë në UT (1998-2000) por edhe në Institutin shqiptaro-zvicerian të fotografisë “Project 5.6” (2007-2008). Leon Çika për 26 vite me radhë ishte reporter, producent dhe kamaraman i “Reuters Television” në Shqipëri (1993-2019), ku ka dokumentuar të gjitha ngjarjet social – politike në Shqipëri, si dhe ngjarjet e luftës në Kosovë. Në pazicionin e kameramanit të Agjensisë “REUTERS” për motive të punës udhëtoi shpesh në të gjithë shqipërinë. Veç kameras ai është sigurisht fotografi profesionist i nivelit elitari, duke qenë dhe pjesmarrës në konkurse ndërkombëtare të fotografisë artistike. Si një mjeshtër i momenteve të bukurisë së peizazhit shqiptar, nga objektivi i aparatit të tij fotografik fiksohen momente të magjisë së peizazhit dhe zgjidhjeve kompozicionale që të magjepsin. Këto kontakte që ai vendos me natyrën me anë të objektivit dhe pikturimit në Pain-air, i japin artistit Leon Çika në vazhdimësi një pasuri emocionale, që ai i pasqyron jo vetëm në fotografitë e mrekullueshme, por edhe në realizimin e cikleve të tablove të tij si piktor.

Artisti gjatë mëse 40 vjetëve si fotograf plot pasion dhe kërkimesh veprake të natyrës profesionale ka realizuar vepra fotografike në dy drejtime: fotografinë dokumentare – zyrtare të ngjarjeve të ditës – “New” dhe fotografinë artistike që ishte deri në fund të jetës pasioni i tij i lindur. Leon Çika mund të vlerësohet edhe si fotografi i bukurive të natyrës shqiptare. Veprat e tij fotografike ai i realizoi në formë ciklesh magjike fotografike ku mund të kujtojmë ciklet: “Gjirokastra” (1990); “Berati” (2000); “abstrakt macro” (2002), “Pogradeci” & “Art nudo” (2003); “Korça” (2004); “Parga – Greqi” (2015); “Firence – Itali” & “Santorini – Greqi” (2016) dhe “Venecia – Itali” & “Korfuzi – Greqi” (2019). Në fotografinë artistike Leoni, si mjeshtër i saj, shfaqti vazhdimisht kërkesën për gjetjen e çastit të bukur, brenda situatash grafike dhe

IN MEMORIAM

## LEON ÇIKA - ky mjeshtër i madh i peizazhit dhe i fotografisë artistike shqiptare

Nga Ylli Drishti



Foto: Alqi Golloshi

kompozicionale mjaft interesante. Ciklet e fotografive e tij të magjepsin e të lenë “me gojë hapur” pasi ai trasmeton me mjaft thjeshtësi dhe bukur përvijën, pasionin dhe vizionin artistik të një kryemjeshtri të fotografisë shqiptare. Çika kërkon dhe trasmeton bukur emocionin, magjinë, të papriturat e ndryshimeve të dritës, që imazhi pëson edhe brenda pak çasteve. I paisur me një kulturë të gjerë, të kontakteve me literaturën profesionale të fushës, kryemjeshtri i fotografisë artistike Leon Çika në veprat e tij fotografike “rrethon” imazhin me magjinë emocionale shpirtërore, me një shpirt kërkues e i “pangopur” ndaj bukurive natyrore dhe njerzore të Shqipërisë. Fotografi Leon Çika është aktualisht një nga figurat kryesore bashkëkohore të fotografisë shqiptare dhe një fotograf lirik i jashtëzakonshëm. Ai ka marrë pjesë në ekspozitat fotografike ndërkombëtare të organizuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e RSH (1986,1987,1988). Kryemjeshtri i fotografisë Leon Çika është vlerësuar me dy çmime për fotografinë artistike nga Ministria e Kulturës (2005, 2006 ekspoz. e çelur në GKA, Tiranë me temën e turizmit në Shqipëri).

### Leon Çika – artisti i “Peizazhit shpirtëror”.

Leon ÇIKA – piktor - ka qenë pjesmarrës në të gjitha ekspozitat Kombëtare të organizuara nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës deri në vitet ’90. Gjinia, që ai ka lëvruar në vazhdimësi, ka qenë kryesisht peizazhi i Shqipërisë qëndrore dhe jugore. Në krijimtarinë piktorike të artistit Çika të tërheq vëmendjen interesi që ai tregon për bukurinë dhe “magjinë” e rrugëve dhe rrugicave të qyteteve historike (Kruja, Gjirokastra, Korça dhe Berati) dhe dritë – hijet që ato krijojnë. Vëmendja e tij, si piktor, ndalet veçanërisht tek ritmi i dyerve të mëdha prej druri e me harqe guri që në tablotë plot dritë krijojnë një atmosferë piktorike impresionuese Me ciklet e këtyre peizazheve të qyteteve muze, ai do të jetë pjesëmarrës në shumë ekspozita arti të kohës. Çika si artist në këtë periudhë e në vazhdimësi është një piktor i Plain-air. Që në vitet studentore ai ishte ndikuar nga impresionistët francezë si Renuar, Monet, Manet. Loja e dritës së diellit dhe në përgjithësi dashuria që ai kishte për natyrën, ndikuan që penelata e tij të jetë me ngjyrë “diellore”. Ai ishte sigurisht i prirur të pasqyronte

me mjaft frymëzim dritën mesdhetare të atdheut të tij dhe bukuritë e natyrës, gjë që u vlerësua nga kritika e kohës. Një nga ciklet piktorike që artisti Leon Çika u morr disa vite me radhë pas viteve 2000, janë dhe tablotë e tij me prirje dekorative, pothuajse abstrakte ku sidoqoftë ndjehet lehtë një “erë e padukëshme” romantizmi. Artisti Çika në këtë cikël të gjerë tablosh “zbulon” disa nga elementët kryesorë të mesazhit që ai i ofron publikut: “magjinë emocionale”. Janë tablo të një karakteri të veçantë; vepra të pikturuara thjesht por me mjaft dashuri dhe emocion. Në vështrimin e parë ato transmetojnë qetësi shpirtërore, shprehin nota të fuqishme poetike dhe kryesisht e marrin motivin nga liqeni i Pogradecit. Në këto vepra vihet re që tashmë ai i largohet karakterit impresionist. Ndikimi i magjisë së liqenit dhe poezive të Lasgush Poradecit të madh, janë për Çikën – piktor, pika referimi. Ky komunikim i një lloji tjetër me natyrën ka ndikuar tek artisti Leon Çika në krijimin e një cikli të madh e të veçantë mbi këtë subjekt (shumë pak i ekspozuar), që sigurisht prirret në pasqyrimin emocional të një peizazhi që mund të konsiderohet “Peizazhi shpirtëror”. Në peizazhet e mjeshtrit Vangjush Mio të realizuara nga liqeni i Pogradecit, ndjehet qartë mjaft poezia, drita e qetësia; që publiku e merr me një gjuhë realiste shprehëse; ndërsa tek mjeshtri Çika këta elementë jepen me anë të një “gjuhe shprehëse” të thjeshtë, shpesh fluide e që kalon gati – gati në një simbolizëm - abstrakt. Ai ndikohet nga kontaktet me natyrën duke realizuar tablo që janë figurative – simbolike - emocionale.

Në vitin 2014 Leoni botoi dhe albumin e tij të parë fotografik me titull: “Berati” Studjuesi i fotografisë Qerim Vrioni shkruan se “...Fotografi Çika ka përdorur për përgatitjen e fotove të albumit si teknikën analoge, ashtu edhe atë dixhitale. Janë në të rreth 300 foto, por për t’i përzgjedhur këto duhet të shteshin, ndoshta shumë më tepër. Kjo kohëndarje, që gjithashtu është pjesë e procesit krijues artistik, tregon se fotografi ynë edhe këtu shpallot zotësi dhe siguri. Përmbledhjet fotografike të këtij lloji, përgjithësisht duhet të plotësojnë dy vektorë, atë njohës, informativ (në rastin tonë qyteti i Beratit) dhe atë estetik. Leon Çika i ka mësuar më tepër të dytit, duke bërë që “shkrepjet” e tij të kenë nivel të atillë që të hyjnë në artin e fotografisë...”

**Thoma K Jance** më analizën e tij mbi këtë botim ndër të tjera shprehet: “...Albumi fotografik “Berati” e përfaqëson Leon Çikën si fotograf i cili e njeh mirë dhe e dashuron dritën me lodrimet e stërholluara të saj, duke shpërfaqur kësajsojë finesë të rrallë. Ai e gjen dritën si në planet e afërtë, ashtu edhe në sfone për të dhënë shpesh asaj njolle të ndriçuar statusin e pikës së rëndësës së fotos, çka nuk është e përhapur shumë në fotografinë shqiptare. Njëkohësisht, ai trajton me aftësi të admirueshme e të rrallë kontrastet tonale (por jo të forta), ndonëse operon në fotografinë me ngjyra, ku të “shtëpisë” janë ato koloristike. Kështu, mjaft fotografi të albumit të krijojnë përshtypjen se po sheh një pikturë me ngjyra të mbajtura, gjë që shton kohën e kundrimin me vëmendje e, njëherazi dhe kënaqësi të tyre. Madje, nga kujdesi i Çikës në zgjedhjen dhe gërshtimin e ngjyrave të pamjeve që do kap me objektivin e tij, herë-herë, në shikimin e parë, të duket se po sheh një foto monokromatike e po ashtu, sikur po vështron fotografinë e një peizazhi të arritur me vaj...”

Çika është autori i fotografive të disa botimeve mbi Trashëgiminë Kulturore Kombëtare, ku mund të kujtojmë albumin me titull: “The icons of Berat” (2003); “Artistë Shqiptarë në Akademitë Italiane” (2005), “Muzeu Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë (2012) në bashkpunim me studjuesin e artit Ylli Drishti.

Tiranë, më 10.01.2025

« [...] me kalimin e shekujve, figura e Heroit mbetet edhe për brezat e sotëm gjithnjë e pacenuar në olimpin e lavdisë së përjetshme ».  
Kristo Frashëri

Disa libra kthehen në tekste të domosdoshme të për të njohur epoka të rëndësishme të identitetit tënd historik dhe gjatë leximit të tërheqin gjithnjë e më shumë me forcën e tyre bindëse, me bukurinë e natyrshme të shprehjes dhe me frymën komunikuese. Kjo lidhet me statusin e tyre formues dhe edukues me të vërteta shkencore. Kështu ndodh pasi ke lexuar librin *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Jeta dhe Vepra*, të historianit të shquar Kristo Frashëri.

Kristo Frashëri nuk e ka shkruar librin e tij vetëm për historianët, por edhe për të gjithë ata që duan ta zgjerojnë njohjen e tyre për figura që janë pishtarë të kombit e thërresin me veprën e tyre, ngjallin krenari dhe frymëzojnë për një jetë të ndershme e të përkushtuar ndaj atdheut e lirisë. Prandaj edhe unë po hedh në letër mbresat e pashlyera që më ka lënë ky tekst madhor, të cilin, pasi e mbarova, kisha dëshirë t'i kthehesha përsëri.

« Dalja në dritë e monografisë bashkë me serinë prej nëntë vëllimesh me dokumentacionin më të pasurin e mundshëm deri sot dhe të vlerësuar mbi figurën e Heroit shqiptar, ishte një dëshirë shumëvjeçare e Prof. Dr. Kristo Frashërit, madje një nga amanetet e tij të përsëritura deri në orët e fundit të tij » (f.15), shkruan në fjalën hyrëse, Gjergj Frashëri, i biri i historianit, inxhinier, Doktor në arkeologji, që është marrë edhe me gërmime që lidhen me figurën e Skënderbeut, njëkohësisht edhe redaktor shkencor i tekstit.

Autori e ka konceptuar librin mbi jetën dhe veprën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, i mbështetur mbi burimet dokumentare të shekullit XV. Ky është edhe origjinaliteti nistor i tekstit, i shkruar nga një njohës i rrallë i Mesjetës shqiptare dhe europiane. « Shqipërisë dhe shqiptarëve [...] u duhet Skënderbeu përmes dokumentesh [...] », - theksonte autori sa herë që binte fjala për figurën e Gjergj Kastriotit. Dokumente historike, kronika dhe letra të zbuluara dhe të përkthyer në shqip nga ai dhe nga historianët të tjerë shqiptarë, e që janë me mijëra në tërësinë e tyre, përbëjnë një thesar të vërtetë për historiografinë shqiptare. Mes dokumenteve, fragmente nga *Memoranda* e fisnikut shqiptar Gjon Muzaka, ku flitet për Skënderbeun dhe familjen e tij, janë sjellë të plota. Ndërmjet të tjerash Hahn-i e ka quajtur « Perla e dokumentacionit historik shqiptar ». Edhe *Komentari ose Tregimi* i Dhimitër Frangu-t, i cili ka qenë disa vjet arkëtar i Skënderbeut, është sjellë i përkthyer.

Ideja konkrete e punës që lidhej me figurën e Skënderbeut, e ushqeu historianin me energji për ta kryer dhe përkryer veprën e tij të jetës, krahas veprave të shumta historike për figura dhe ngjarje historike shqiptare. Me punën e tij të palodhur e të përkushtuar, ai u shndërrua në një nga historianët më të mëdhenj të Shqipërisë, në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe fillimet e shekullit XXI.

Sot është e mundur që dokumentet të njihen të botuara në një serial bibliografik së bashku me vëllimin I, që do të thotë një punë titanike e autorit dhe pastaj e Fondacionit « Frashëri » që i përgatiti për botim sipas udhëzimeve të tij të fundme, sepse Kristo Frashërin e pengoi pakësimi i ndjeshëm i shikimit në fund të jetës.

Fillimisht *Historia e Skënderbeut* e Kristo Frashërit u botua në vitin 2002. Mbetën pa u botuar nëntë vëllime me dokumente për arsye fondesh. Më 2005, me rastin e 600 vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit u botua vetëm një vëllim me dokumente. Botimi i vitit 2019 është një botim i plotë i veprës, me të gjitha prurjet e reja, por që autori nuk arriti ta shihte. Në të vërtetë ai ka nisur një monografi simbolike për Skënderbeun, qysh kur ishte nxënës në gjimnazin e Tiranës, në vitet 1935-1936 me dëshirën për t'i treguar mësuesit të historisë se dëshironte « të bëhej historian i Shqipërisë në të ardhmen ». Faksimile të saj, faqja e parë dhe pasqyra e lëndës janë sjellë edhe në këtë libër madhor (f.19, 20, 21, 22).

Kristo Frashëri u paraqit shumë shpejt para lexuesit shqiptar, në vitet '50, me analiza, si : *Gjergj Kastrioti Skënderbeu* (1958), në revistën *Shqipëria sot*, që dilte edhe frëngjisht, anglisht dhe rusisht ; *Lufta e madhe shqiptare-turke në shek. XV dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, në

Kristo Frashëri *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Jeta dhe Vepra (1405-1468)*, Shtëpia Botuese DITURIA, 2019

# NJË VEPËR MONUMENTALE PËR SKËNDERBEUN

Nga Feride Papeleka

*Historia e Shqipërisë*, vëll. I, botim i Universitetit të Tiranës (1959) ; *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Heroi Kombëtar i Shqiptarëve*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, që dilte edhe frëngjisht, anglisht, rusisht dhe esperanto (1962); si dhe shumë artikuj e studime për figurën e Skënderbeut, botuar në organe të ndryshme dhe që janë përfshirë në tre vëllime me titull *Studime për epokën e Skënderbeut*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (një shënim më i hollësishëm gjendet në f. 42 dhe në f. 746, 747 të këtij libri, ku jepet Bibliografia).

Në parathënie, përveç idesë për të dhënë një Gjergj Kastrioti më të besueshëm, autori ndalet në disa vepra monografike kushtuar Skënderbeut, analizon anët e mira dhe ndonjë dobësi që lidhet edhe me fazën e deriatëhershme të studimeve. « [...] për ta shpëtuar Heroin dhe luftën epike të shek.15 nga kritikë që u bëheshin Barletit si panegjrik dhe Biemi-t si falsifikator, më lindi pyetja, nëse mund të trajtohej një histori e Skënderbeut dhe e epopesë së shek. 15 duke u mbështetur vetëm në burimet dokumentare bashkëkohore [...] » (f.42).

Një risi konceptuale është edhe pohimi : « Burimet dokumentare sollën edhe një rezultat tjetër. Ato e nxitën autorin e kësaj monografie të dalë nga korniza e derisotme e historiografisë skënderbegiane, e cila e ka trajtuar Heroin kryesisht si udhëheqës i luftës çlirimtare. Ato i dhanë mundësi atij ta zgjerojë gamën e tematikës studimore : ta trajtojë atë edhe si nismëtarin e shtetit kombëtar shqiptar, pikërisht në kohën kur në kontinentin europian fillonte procesi i formimit të shteteve kombëtare » (f.45).

Autori i kushton gjithashtu një vëmendje të domosdoshme disa qëndrimeve kritike të skajshme për figurën e Skënderbeut. Ai zhvillon edhe një polemikë të fortë me O. J. Schmitt, autor zviceran i një punimi monografik për Skënderbeun, botuar së pari i përkthyer shqip më 2008. Punimi i O. J. Schmitt-it, thotë autori « është në vazhden e atyre veprave që nuk merren me analiza të vërteta shkencore, por ecin në rrugë që janë kundër të vërtetës historike ». Autori i hedh poshtë me argumente të dokumentuara disa ide dhe karakteristika për Skënderbeun në punimin e Schmitt-it, të bëra me qëllim njollosjen e figurës së Heroit, siç edhe ka ndodhur te ne me njollosjen e shumë figurave të tjera, vetëm e vetëm se janë vlerësuar në kohën e monizmit

Një histori e bazuar në dokumente, është një trajtim që i shmang klishtë dhe hamendësimet. Burimet dokumentare përbëhen nga akte shqiptare dhe të huaja, përëndimore dhe lindore, të zbuluara në arkivat e « Venedikut, Raguzës, Romës, Napolit, Milanos, Barcelonës, Parisit, Ankarasë dhe Stambollit ». Aktet « zyrtare » plotësohen me « kronika osmane, bizantine dhe italiane të shekullit XV si dhe me shkrime e letërkëmbime të disa personaliteteve », që janë përgjithësisht « bashkëkohëtarë » të Heroit.

Vepra nis me përpjekjet e para mbrojtëse të Shqiptarëve nën udhëheqjen e disa princëve të shquar në shekullin XV, me përshkrimin e kontekstit « parahistorik » të veprës së Skënderbeut « Zot i shqiptarëve », siç edhe do të cilësohet edhe në shumë letra të kancelarive të Europës. Kronistët osmanë i jepnin aktet çnjerëzore të djegieve e vrasjeve me bindjen se ato ndëshkonin armiqtë e fesë islame e u dhuronin ushtarëve të sulltanit « hyrjen » në parajsë. Autori sjell një fragment të zgjeruar nga kronika e Bitlisit për fushatën osmane kundër viseve shqiptare më 1432 : « Me të shkelur në vendin e lartpërmendur, luftëtarëve iu dha leja për të grabitur e plaçkitur. Këdo që gjetën nga të pafetë kryengritës, ata e vranë pa mëshirë, ndërsa

fëmijët dhe gratë i morën robër. » Pastaj ai shton : « Komandantët e luftëtarëve u ndalën aty në viset e Gjergj Arianitit (K.F.), aq sa të mëdhenjtë dhe të vegjëlit e ushtrisë islame u pasuruan me një plaçkë të pallogaritshme dhe u gostitën me pasurira, të cilat ata i kishin hallall. Ata zunë aq djem dhe vajza saqë çdo djale me shtat të argjenditë dhe çdo vajzë me fytyrë si hëna, u shit deri katër ose pesëqind akçe » (f. 166, 167).

Teksti duke hedhur dritë mbi historinë shqiptare në Ballkan, bën analizën dhe sintezën e disa ngjarjeve që i paraprin ardhjes së Skënderbeut. Aktorë të kësaj periudhe janë disa princër shqiptarë midis të cilëve shquhet Gjergj Arianiti, vjehri i ardhshëm i Skënderbeut dhe Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut.

## Gjergj Kastrioti, princ dhe zot i Shqiptarëve

Më 28 nëntor 1443, në qytetin mesjetar të Krujës, Gjergj Kastrioti ngrii flamurn e kuq me shkabën dykrenore. Skënderbeu i Kristo Frashërit është njerëzor, strateg dhe prijës, i vetëdijshëm për detyrën që ka marrë përsipër si çlirimtar. Nuk është e rastësishme që në fjalimin e tij të parë sipas dëshmitë që pati mbledhur Marin Barleti, ai ka theksur fjalën *liri*, sepse ishte ajo që u mungonte më shumë Shqiptarëve. Dokumente të ndryshme e quajnë « kampion i lirisë ». Autori citon Barletin kur Skënderbeu thotë : « Lirinë mund ta kishit fituar me trimërinë tuaj dhe me një çlirimtar tjetër, se Shqipërisë nuk i mungojnë burrat ... Lirinë nuk ua solla unë, po e gjeta këtu në mes tuaj ... armët nuk ua ngjesha unë, po ju gjeta të armatosur, lirinë e kishit kudo, në kraharor, në ballë, në shpatë dhe në ushtar ... » (f. 206). Ky moment nuk haset në burimet dokumentare të deritashme, sqaron autori, por ai vërtetohet relativisht nga ngjarjet që pasuan më tej. Një dokument arkivor shumë i rëndësishëm dëshmon se në pragun e kryengritjes çlirimtare, Skënderbeu ishte qeveritar në Dibër : « Konkluzioni i përgjithshëm që del nga rreshtimi, nga ballafaqimi dhe nga komentimi këtyre njoftimeve arkivore e kronikale është me pak fjalë ky : kthesa e madhe që ndodhi në Shqipëri në vitin 1443 nuk e nxori në mënyrë të befasishme Skënderbeun në skenën historike (f.195). Skënderbeu u interesua për gjithçka që kishte të bënte me luftën mbrojtëse, në mënyrë që të maste forcat edhe ai si udhëheqës, por edhe bashkëvendasit si ushtarë « para se t'i përvisheshin epopesë legjendare njëçerekshkullore » (f. 195).

Gjergji Kastrioti u bë flamurtar. Autoriteti i tij si udhëheqës u rrit. Kruja tashmë e mbrapa do të simbolizonte fillimin e një epoke të re në

tokat shqiptare. Mënyra e Shqiptarëve për ta konceptuar lirinë tashmë kishte ndryshuar.

## Përpjekjet për themelimin e një shteti

Ngritja e flamurit në Krujë bëri dallimin e qartë midis Skënderbeut dhe pushtuesit. Pas tij erdhi akti i dytë i mirëmenduar : Kuvendi, i cili u mbledh në Lezhë më 2 mars 1444 me idenë e madhe : bashkimi në luftë kundër pushtuesve. Ky ishte një model i ri i luftës çlirimtare me Shqiptarë të bashkuar për të përbashkuar pushtimin osman. « Në Lissosin antik, sipas medievistit K. Jireček ku « në shtratin e kulturës ilire takohet Lindja helenistike me Perëndimin romak [...] erdhën delegatë nga të katër anët e Atdheut » (f. 209). Midin princëve : Gjergj Arianiti, Pal Dukagjini, Andrea Topia, Lekë Dushmani, Teodor Korona dhe Pjetër Spani, Lekë Zaharia dhe Stres Balsha, ku duket edhe ideja unifikuese, « shkëlqente personaliteti i Skënderbeut, 'zot i Dibrës dhe i Matit (*dominus Dibra et Mati*) » (f. 210). Skënderbeu u zgjodh kryekomandant.

Dy vendime ishin nga më të rëndësishmet në Kuvend : « heqja dorë nga partikularizmat » dhe Besa për të luftuar në një ushtri të përbashkët. Autori ka ditur ta theksojë këtë nëpërmjet analizës së tij duke lexuar gjithnjë të padukshmen mes rreshtave të dokumenteve historike. « Lidhja Shqiptare kishte karakterin e një aleance politike e ushtarake të krijuar për nevojat e luftës kundër pushtuesve osmanë, por secili pjesëmarrës e ruante autonominë e vet. Skënderbeu, si kryetar, ishte në këtë kohë një « i parë midis të barabartëve » (*primus inter pares*) (f. 211).

Gjergj Kastrioti është prijës dhe luftëtar që u përpoq t'i bashkonte shqiptarët në luftë çlirimtare e të hidhte themelet e një shteti shqiptar. Edhe më parë ka pasur përpjekje të tilla. Autori e ka trajtuar te libri *Principata e Arbërisë : 1190-1215, por koha e Skënderbeut po përballet me një perandori të madhe*. Betejat fitimtare të Gjergj Kastriotit në krye të Shqiptarëve si dhe ato të Janosh Huniadit në krye të Hungarezëve treguan se mund t'i bëhej ballë rrezikut. Miqësia hungarezo-shqiptare është farkëtuar që « në nëntor 1443 dhe vazhdoi deri në vdekjen e kapitenit të lavdishëm hungarez më 1456 ».


## Një organizim i ri, në një kohë të re

Skënderbeu i dha përparësi luftës mbrojtëse dhe prandaj titulli që i jepnin atij nëpër dokumente si mbret i Shqiptarëve apo zot i Shqiptarëve shpreh edhe mbështetjen morale për luftën e tij. Autori e quan Skënderbeun *Shqiptari i Madh, Komandant i lavdishëm, Kapiten i Shqiptarëve, Kryekapedan, Kryekomandant* etj. Kujtesa kolektive në shekullin XV u farkëtua me fitoret e mëdha të luftës çlirimtare kundër pushtuesve osmanë. Ideja e fitores ngrihej mbi dëshimitet e përkohshme dhe humbjet që sjell lufta, pohon autori.

Betejën e parë të Skënderbeut për të cilën nuk është zbuluar ende ndonjë dokument, autori e analizon sipas të dhënave që japin dy biografët kryesorë të Skënderbeut, ashtu si deklaroi në parathënie se në mungesë të dokumenteve për ngjarje të caktuara, do t'u drejtohet atyre. Ai korrigjon pasaktësitë e përshkrimit, sepse asnjëri prej tyre nuk e njeh vendin e betejës, por mendon se edhe fjala Torvioll që ka hyrë kështu në histori, është e deformuar dhe se ka mundësi që të ketë qenë *Tevioll*, vend pa zot, sipas kuptimit të moçëm dibran. Ai shkruan : « Beteja e Torviollit çeli vargun e gjatë të betejave shqiptaro-osmane, të cilat i udhëhoqi Skënderbeu për gati një çerek shekulli me radhë (1444 -1467), (f.215).

Autori i analizon situatat nga këndvështrimi historik : « Fitoret ushtarake që u korrën kundër osmanëve, forcan pozitën politike jo vetëm të Skënderbeut, por edhe të bujarëve shqiptarë, tashmë të pavarur në zotërimet e tyre feudale. Por gjendja e përgjithshme politike nuk u përgjigjej fitoreve dhe sakrificave që kishin bërë shqiptarët » (f.218).

Në dokumente të ndryshme, sidomos në letrat që i dërgohen, Skënderbeu vishet me epitete të larta si : sinjoria e « shkëlqyeshme » u lidh me të « madhërishtin » Skënderbe, etj. Lexuesi që përballet me përshkrimin e betejave nëpër kronika, stepet, ngazëlleshet, mahnitet, apo trishtohet. Bie fjala, për betejën e Sfetigradit Kalkokondili shkruan « Sulltani lëshoi ushtrinë, e cila kudo që shkoi digjte fshatrat dhe arat (f. 234). Autori sjell në tekst një dëshmi dokumentare të rrallë të një kronistit osman, i cili shkruan se « sulltani grabiti vilajetin e



Shqiptarëve, kishat u shembën dhe atyre i vu zjarri ». Në *Kronikat Anonime Osmane* jepet një hollësi tjetër : « se ato u shkatërruan si kisha dhe u bënë mesxhide (xhami pa minare) ».

Arsyeja kryesore strategjike e sulmeve osmane ishte : të mposhtej qëndresa shqiptare për të kaluar pastaj lehtësisht në Europë. Me një vështrim të distancuar, autori zbulon figurën e Skënderbeut që printe ndër beteja, por që përballonte edhe dëmet që sillte lufta dhe përçarja mes princëve. « Përparimi osman në Ballkan, si një rrezik për të gjitha vendet e Gadishullit, nuk ndikoi aspak në zbutjen e përçarjes feudale » (f. 87).

Për fitoren në Rrethimin e Parë të Krujës, përveç dokumenteve të ndryshme, autori përdor një relacion të humanistit shqiptar, Gjon Gazulli, por edhe një letër të vetë Skënderbeut që u ka dërguar fisnikëve të Sienës, por ka mundësi - pohon ai më poshtë - që kjo letër t'u jetë dërguar edhe kancelarive të tjera, sepse pasi flitet për mbrojtjen e Krujës që ka kërkuar mjaft sakrificë, shtrihet edhe kërkesa për ndihma financiare. Letra është shkruar në italishten mesjetare më 8 gusht 1451. Autori jep faksimilen e letrës dhe përkthimin.

**Karakter i Shqiptarëve dhe i Skënderbeut**

Një kronist osman me origjinë kurde (shek.15) shkruan : « [...] meqenëse shqiptarët në pjesën më të madhe banojnë në vise malore, janë mbrojtur me një karakter të ashpër dhe të fortë, kështu që nuk i përkulen askujt, në çfarëdo rrethane qofshin » (f.242). Ndërsa Kritobuli, « osmanofil » e cilëson autori, duke folur për Rrethimin e Dytë të Krujës, shkruan : « Ilirët (siç i quan ai shqiptarët - K. F.) banojnë që prej kohëve të lashta në male shumë të larta dhe kanë kështjella shumë të fuqishme, të cilat mund të pushtohen me vështirësi, në brendësi të vendit dhe në bregdet, si dhe në vende me gremina që kalohen me shumë zor » (f. 242). Dihet që sulltani fillimisht provoi ta merrte kështjellën pa luftë ; ai i propozoi kont Uranit një shumë të madhe dukatësh ari, por ky nuk pranoi. Pastaj filloi sulmi me furi. Në një fragment kronike lexojmë : « Nga zjarri i kalorësisë së shpejtë si përroi malor dhe nga gjaku i armiqve që u derdh prej shpatave të mprehta ... gurët morën ngjyrën e rubinëve » (f.247).

Sipas dokumenteve Heroit del si diplomat, mbrojtës i qytetërimit europian dhe qytetar i vërtetë. Autori tregon sesi donte ta shpëtonte ai Krujën : me akte diplomatike për ta pushuar luftën, por edhe me ndihma për të vijuar luftën, kur nuk kishte rrugë tjetër. Skënderbeu vigjilonte gjithnjë me disa qindra luftëtarë, jashtë Krujës, në malin që mori emrin e tij për ta goditur armikun në befasi. Kruja ndenji disa muaj e rrethuar, por nuk u dorëzua.

Një letër nga Ragusa i vë në dukje Skënderbeut shumë cilësi si « madhështinë e pabesueshme të shpirtit tuaj dhe burrërinë e shkëlqyer ». Autori veçon edhe fragmentin e fundit : « Qofshi pasqyrë e shembull për të gjithë princat e të krishterëve dhe për mbarë kombet dhe emri juaj do të kurorëzohet prej famës së amëshuar » (*speculum et exemplum sitis cunctis christianorum...*), (f.255, 256).

Miqësia me Alfonsin V u forca gjatë kohës së armëpushimit me sulltanin. Më 26 mars 1451 u lidh traktati midis Gjergj Kastriotit dhe mbretit të Napolit. Dy ambasadorë të Skënderbeut, ishin një peshkop i ritit lindor dhe një misionar perëndimor. Traktati i Gaetës, gjithashtu është dëshmi e politikës së hapur dhe të mençur të Skënderbeut. Ekspeditat turke më 1452 në prill dhe korrik u thyen. Po ashtu, u thye beteja e papritur e 22 prillit 1453, kur Skënderbeu donte të rimerte Sfetigradin. Beteja që e përgjakshme në fushën e Pollogut mdis Gostivarit dhe Tetovës.

Papa Nikolla V i dha rëndësi marrëdhënieve me Shqipërinë. Porosia e tij ishte që « t'i jepni birit të dashur, burrit fisnik Gjergj Kastriotit, zot në Shqipëri, përkrahje dhe ndihmë kundër turqve ».

Por ndihmat qenë të pakta dhe Besëlidhja e Lezhës, nuk i qëndroi kohës. Çarja e parë ishte largimi i disa feudalëve. Gjon Gazulli, i cili kishte hyrë në shërbim të Skënderbeut qysh herët, « nuk ngurroi » ta nojftonte atin e shenjtë se « disa aleatë të Skënderbeut, shkuan aq larg, sa u bashkuan me sulltanin » (f.258, 259). Por Skënderbeu mobilizon ushtarë me nismën e vet, të cilët bëhen « shumë shpejt forca ushtarake më e rëndësishme e vendit » (f. 260, 261).

Autori thekson rëndësinë e fitores diplomatike të Pal Engjëllit, prift humanist dhe diplomat, i cili shmangu armiqësimin e



mëtejshëm të Venedikut me Skënderbeun ; ai i shërbeu denjësisht « kryekapedanit shqiptar », si ambasador dhe këshilltar. « Politika e jashtme që ndoqi Skënderbeu, që në fillim e deri në fund të sundimit të tij njëçerëshekullor, iu nënshtua kryekëput nevojave të mbrojtjes së lirisë së vendit dhe çlirimit të plotë të Shqipërisë nga pushtuesit osmanë » (f. 403).

Duke sjellë dokumente për fushatat ushtarake osmane, autori komenton betejat e ndryshme të Skënderbeut. Njëra prej tyre është edhe ajo kur Hamza Kastrioti, nipi i tij, pasi e ka tradhtuar Skënderbeun, vjen si pushtues. Gjergji përdori një taktikë të re që nuk e njihje Hamzai, e cili kishte luftuar në krah të Skënderbeut. Ai, i la turqit të afroheshin, sikur kishte hequr dorë dhe pastaj i rrethoi. Luftëtarët shqiptarë që ranë për liri, u varrosën në Katedralen e fshatit Shumri. Varret u zbuluan nga Gjergj Frashëri gjatë ekspeditës që ndërmori Instituti i monumenteve të kulturës më 1986, njofton autori. Barleti e quan beteja e Albulenës (e Ujëbardhës). « [...] në Krujë Shqiptarët rezistuan në sajë të mureve, në Ujëbardhë Shqiptarët fituan në sajë të krahut dhe të mençurisë së Skënderbeut » si dhe të trimërisë së ushtarëve shqiptarë, shkruan autori. Hamza Kastrioti u kap i gjallë dhe u dërgua në Itali, madje ambasadori dorëzoi edhe 12 ushtarë turq së bashku me kuajt e tyre të zënë rob në Ujëbardhë. Fitorja e Ujëbardhës « hapi kapitullin e tretë, jo të tragjedisë, siç e quan Fallmerayer, por të epopesë skënderbegiane » (f. 470). Dy muaj më pas, Kalisti III e emëroi Skënderbeun « Kapiten të Përgjithshëm të Selisë së Shenjtë » në luftën kundër osmanëve.

**Portreti fizik dhe shpirtëror i Skënderbeut**

Skënderbeu sipas përshkrimeve nëpër dokumente shfaqet shtatlartë, i hijshëm, i fuqishëm. Njihen tashmë përshkrimet e Marin Barletit, sipas kujtimeve edhe të ndonjë ish-luftëtari të tij. Historiani dhe shkrimtari italian i shek XVI, Pal Jovi (Paolo Giovio), bisedoi me disa nga pasardhësit e Heroit dhe u takua me një nga nipërit e tij. Ndër të tjera në librin e tij kushtuar Skënderbeut, ai shkruan : « Skënderbeu kur dilte jashtë i armatosur me atë gjallëri të syve (*tamquam oculorum alacritate*) dhe me atë gojëtarë të rrjedhshme (*hilari facundia*), ai i ndizte aq tepër luftëtarët e vet, sa i bënte ata të mos stepeshin përballë asnjë ndërmarrjeje të rrezikshme, por të luftonin më me egërsi dhe më me përbuzje kundër armiqve mizorë » (f. 347).

Sigurisht ajo që ia shtonte madhështinë Skënderbeut ishte edhe qëndrimi i matur ndaj atyre që e tradhtuan si : Hamza Kastrioti, Moisi Golemi, Gjon dhe Gjergj Balsha.

Një tregues i fuqishëm i personalitetit të tij duket edhe te një letërkëmbim me mbretin Ferdinand : « [...] Zoti e ruajtë Madhërinë Tuaj nga e keqja, nga dëmet, nga rreziqet, por çfarëdo që të ndodhë, unë do të jem mik i virtytit dhe jo i fatit » (ma segua qual caso voglia, che io saro amico de la virtut et non dela fortuna), (f.492,493). Edhe në letrën dërguar papës nëpërmjet mikut të tij të « ngushtë » Pal Engjëllit, dalin në pah disa cilësi të çmuara të personalitetit të tij : dinjiteti, ndershmëria dhe qëndrimi i përgjegjshëm para

ngjarjeve historike :

« Shumë i nderuar At dhe Zot në Krishtin.

*Po i drejtohem zotërisë suaj shumë të nderuar që të ketë dijeni për ngjarjet që po ndodhin në këto anë. Turku (sulltani - K.F.) ka bërë përgatitje të mëdha. Thuhet se 14.000 vetë (turq) po marshojnë drejt Danubit ose po përparojnë kundër Shqipërisë [...].*

*Nga Lezha, më 8 të prillit 1456.*

*Me besim te ju Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbej, Zot në Shqipëri.*

Fitoret e Skënderbeut krijuan optimizëm edhe te vetë papa për projektin e një kryqëzate antiosmane, madje ai e lajmëroi vetë Skënderbeun se kryqëzata do të fillonte pranverën e ardhshme, por ajo nuk u realizua. Më 1456 vdiq Janosh Huniadi dhe projekti tjetër, për një bashkim ushtarak ballkanik kundër osmanëve, mbeti në letër.

Pas analizash dhe sintezash historike libri shndërrohet në himn për heroin Gjergj Kastrioti Skënderbeu, luftëtar dhe shtetar, prijës betejash dhe diplomat, themelues i pavarësisë së një populli të vogël përballë një ushtrie të madhe. Figura e tij ka frymëzuar prej kohësh vepra të pikturës, skulpturës e gravurës në vende të ndryshme të botës dhe në Shqipëri. Shumica e veprave e paraqesin me një profil të veçantë me sy të gjallë dhe hundë shqiponjë. Këto vihen re edhe në portretin e tij më të hershëm që njihet, i galerisë Ufici (Uffizi) të Firences e që mendohet se është mbështetur në vizatimin e drejtpërdrejtë të piktorit venecian Gentile Belini. Aty heroit është disi i moshuar, me flokë të thinjur, kur ndërmori udhëtimin e tij të fundit në Itali (1466).

Ndër veprat më të shquara të artit tonë për Skënderbeun janë statujat në kalë : në Krujë, punë e skulptorit Odhise Paskali dhe në Tiranë, punë e skulptorëve Andrea Mano dhe Janaq Paço në bashkëpunim me Odhise Pascalin. Në veprat e Muzeut Historik Kombëtar dhe në Muzeun Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Krujë, afresket, shtatoret, grupi skulpturor e pasqyrojnë Skënderbeun ashtu si e farkëtoi koha : luftëtar, udhëheqës popullor dhe burrë shteti.

Statuja ekuestre për Skënderbeun ka në disa qytete të Europës dhe autori i ka sjellë fotot e tyre edhe në këtë tekst. Ka fotokopje edhe të ndonjë dokumenti të rrallë me shkrimin e Skënderbeut, foto të hartave, të vulave, etj.

Figura e Skënderbeut tërhoqi vëmendjen e historianëve, por edhe atë të shkrimtarëve në Europë. Fama e tij u përhap në sajë të veprës së Marin Barletit. Me dhjetëra janë veprat e tjera historike për Skënderbeun. Edhe francezi Jacques de Lavardin, vepra e të cilit (1576), u ribotua disa herë ndikoi shumë. Madje poeti i Plejadës franceze, Pierre de Ronsard i kushtoi atij një sonet. Kurse poetesha italiane Margerita Sarroki i kushtoi në poemë me titull «Skënderbeida» (Romë 1623).

Janë të panumërta krijimet e çdo shekulli për Skënderbeun, deri edhe një opera për Skënderbeun nga A. Vivaldi apo poema e gjatë nga Henry W. Longfellow. Edhe Volteri shkruajti : « Nëse perandorët bizantinë do të kishin qenë Skënderbenj, Perandoria e Lindjes do të kishte shpëtuar » (f.630,631).

Rilindja jonë Kombëtare e ringjalli

Skënderbeun. Pastaj erdhi gjysma e dytë e shekulli XX që e ngriti atë në pedestal. « Një ditë tona, emri Gjergj Kastrioti Skënderbeu, si luftëtar i madh i lirisë, si strateg i shquar ushtarak dhe si mbrojtës i qytetërimit europian, vazhdon të gëzojë si në kohën e vet, stimën e opinionit ndërkombëtar. [...] me kalimin e shekujve, figura e Heroit mbetet edhe për brezat e sotëm gjithnjë e pacenuar në olimpin e lavdisë së përvetshme » (f. 631).

Libri i Kristo Frashërit është një arritje e madhe në historiografinë e një populli që e kanë ndjekur herë pas here mynxyrat e pushtimeve qysh në Antikitet. Si historian ai ka pasur një projekt të madh, që falë edhe mundësi që i dha natyra për të jetuar gjatë, arriti ta kurorëzote. Ka botuar me dhjetëra artikuj studimorë, referate historike, vëllime dokumentare, monografi dhe libra shkencorë, që trajtojnë pa përjashtim ngjarje, personalitete dhe procese të historisë së Shqipërisë e të Shqiptarëve në Ballkan. Ai ka mbrojtur me argumente të dokumentuara të vërtetat historike rreth disa çështjeve të mprehta shkencore e kombëtare që u shfaqën pas vitit '90. Në çdo studim Kristo Frashëri është shquar për qëndrim parimor ndaj çdo problemi, për trajtimin e shumanshëm të dukurive historike si dhe për objektivitet shkencor. Kristo Frashëri nuk iu nda punës studimore deri në çastet e fundit të jetës. Librat e tij dallohen për qartësinë e shtjellimit si historian që mbron të vërtetën, nga cilado anë qoftë, për frymën komunikuese me brezat shqiptarë dhe për gjuhën e rrjedhshme e të pastër shqipe.

Duke pasur sot në duar veprën madhore të Kristo Frashërit kushtuar Heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Jeta dhe Vepra që duhet të jetë edhe libri i parë në bibliotekën e çdo shqiptari, të emocionon fakti që autori i ka jetuar vitet e jetës së tij me figurën e Skënderbeut në mendje dhe në zemër. Ai ka rikrijuar, sipas dokumenteve të zgjedhura gjithë jetën historike të Gjergj Kastriotit, rrethanat, kushtet, dialogun historik mes tij dhe Europës, veprën e tij çlirimtare dhe jehonën e saj, lavdinë e tij të përvetshme.

Populli ynë duhet të krenohet me historianë të tillë si Kristo Frashëri.

Statuja e tij duhet të zbukurojë kopshtin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

**Jeta e Kristo Frashërit në disa data**

**Kristo Frashëri (Stamboll, 4 dhjetor 1920 - Tiranë, 31 janar 2016)**

*Në vitin 1927 familja e tij u riatdhesua dhe u vendos në Tiranë. Më 1940 ai mbaroi shkollën e mesme. Më 1942 u internua dhe më 1943 kaloi në rreshtat e Ushtrisë Antifashiste. Pas çlirimit mbaroi Insitutin e Lartë Pedagogjik dhe pastaj Universitetin e Tiranës. Shumë vjet punoi në Institutin e Historisë si punonjës shkencor dhe petagog në Universitetin e Tiranës. Me studimet për Skënderbeun dhe për Mesjetën shqiptare mori me radhë titujt Doktor, Profesor dhe u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në vitin 1997 u emërua zv. kryetar i Akademisë.*

Lista e botimeve të tij është tepër e gjatë, por po citojmë disa prej tyre, si: *Lidhja e Prizrendit* : 1878-1881, (1956) ; *Rilindja kombëtare shqiptare* (1962) ; *Tre vëllezë pishtarë* : *Abdyl Frashëri, Naim Frashëri, Sami Frashëri* (1978) ; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* : 1878-1881, (botim i plotësuar, 1979), *Abdyl Frashëri*, (1984), *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe vepra*” (2002) ; *Historia e Tiranës* (2004) ; *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri* (2006) ; *Skënderbeu në burimet dokumentare shqiptare në shek. XV* (2005) ; *Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke në shek. XV* (2005) ; *Himara dhe përkatësia etnike e Himarjotëve* (2005) ; *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera* (2006); *Historiografia shqiptare në tranzicion* (2006); *Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë*, 28 nëntor 1912 (2008); *Historia e Kosovës. Dardania* (Kosova Antike), (2009) ; *Historia e qytetërimit shqiptar* (2008); *Skënderbeu i shpërfytyruar nga një historian zviceran dhe disa analistë shqiptarë* (2009); *E vërteta mbi Shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit* (2010) ; *Frashëri : shkëlqimi dhe rrënimi i tij* : (vështrim i shkurtër), (2010) ; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, ribotim (2012), *Historia e Dibrës* (2012); *Etmogjeneza e shqiptarëve - Vështrim historik* (2013) ; *Abdyl Frashëri : jeta, veprimtaria dhe shkrimet* (botim i plotësuar, 2013) ; *Ahmet Zogu* : vështrim historik (2014) ; *Jeta e një historiani*, (2014) ; *Principata e Arbërisë* : 1190-1215, (2014) ; *Historia e Çamërisë* : (vështrim historik), (2015).

Me duart e mia i kam mbledhur copat Me mermerit te varri i poetit Lasgush Poradeci në Pogradec në maj të vitit 1991. (E kam mbajtur sekret këtë vaki plot 15 vjet, por, tani kur në shoqërinë shqiptare nuk ka mbetur më pothuajse asnjë fshehtësi, kujtoj se ka ardhur koha ta bëj publike).

Pata shkuar me familje nga Struga në Pogradec për piknik ditën e Një majit, kur u lejua, për herë të parë pas gati gjysmë shekulli, kalimi i kufirit me leje të njoftimit dhe puna e parë që bëra, pas vizitës në familjen e mikut tim të vjetër, doktor Mistos (Mirosh Markajt, nip i Kutelit dhe mik i Lasgushit, edhe vetë shkrimtar), që një homazh te varri i poetit, i cili, para se të vdiste, e la me gojë që ta varrosnin në vendlindje.

Edhe me aktin e fundit të jetës së tij, poeti poradecar dëshmoi se ishte shumë i lidhur me qytetin e tij të lindjes, Pogradecin, ku kishte ardhur në jetë në vitin e fundit të shekullit XIX dhe, madje, veç dy ditë para se të agonte shekulli i ri, i njëzetë.

Pas një jete të gjatë e plot peripeci (sidomos në periudhën e pasluftës), Lasgushi mbylli sytë përgjithmonë në Tiranë, më 12 nëntor 1987, në moshën 88 vjeçare. U varros me nderime në Pogradec, sipas porosisë së tij lënë të bijave, Kostandinës dhe Maries, aty ku vite më parë që kallur në dhe edhe shoqja e tij e jetës, Nafja, ajo grua e urtë dhe e përvuajtur, humbja e së cilës e goditi rëndë.

Kisha dëshirë, e edhe një çikë mburrje, që ime shoqe dhe fëmijët e mi ta shihnin me sy varrin e njërit prej poetëve më të mëdhenj të kombit, kurse ime bijë, Doruntina, e cila atëbotë ishte në klasë të tretë të shkollës fillore, të vinte një tufë lule mbi të. Për ta bërë këtë akt edhe më simbolik kishim marrë me vete një degëz molle nga kopshtet e Strugës. E kishim mbajtur me vete nga Struga në Pogradec, në veturë, për t'ia blatur "poetit të luleve", kur ç'të shohësh: pllaka e mermertë mbi varrin e poetit që bërë copë e grimë!

Mbetëm pa fjalë, unë me të mitë dhe shoqëruesi ynë, doktor Mistoja. Çile gur gojën! Shumë gjëra të pahijshme ndodhnin ato ditë në Shqipëri, por se mund të pësonte edhe varri i poetit, as që na kishte vajtur mendja! Befasia dhe zhgënjimi ynë s'kishte skaj!

Dhe për të qenë çudia më e madhe, askush nuk dinte, askush nuk kishte asnjë njoftim, për këtë dëmtim të varrit të poetit, për këtë akt barbar, për të cilin diku tjetër do të ishte alarmuar edhe qeveria e jo më një qytet i vogël si Pogradeci. As miku im dhe njëri nga miqtë e afërt të poetit, pogradecari i vjetër, Misto Marko, nuk dinte gjë. Madje, as rojtari i varrezave (një burrë i zeshkët, me gjasë jevg) nuk ishte në gjendje të tregonte tamam se kur dhe si kishte ndodhur ky turp. Na tha se kishte të ngjarë që kjo thyerje të ishte bërë natën pa qëllim nga njerëz që kishin dashur ta vidhnin rrethojën e hekurt të varrezave që ndodhej sipër varrit të poetit, i cili, bashkë me dy të tjerë, varrin e dëshmorit të LNÇ-së, Reshit Çollaku, heroin e poezisë *Balladë poradecare* dhe të një personi tjetër, që s'ia mbajta mend emrin, është në hyrje të tyre.

Vandalizmi një emër ka, edhe kur bëhet me çekiç e vare, edhe kur vjen nga padija, smira e zilia ose, siç do të thoshte vetë Lasgushi, me gjuhën e trevës nga vinte, nga nakari.

"Ha! se në kaq ndryshmësi mi duk vetë Shqipëtar!

Ndaj shëmtton fjal' e të folur nga padija, nga nakari".

I mblodhëm copat e thyera të mermerit (mermer i kuq i vendit, me damarë), duke i bërë bashkë gerrat që sajojnë emrin e poetit: LAS-GU-SH PO-RA-DE-CI. I vumë edhe lulet - atë degëzën e mollës të sjellë nga Struga përtej liqerit - sipër copëzave

## TE VARRI I POETIT

Nga Agim Vinca

të ribashkuara si një mozaik që duhet të ribëhet dhe ikëm të heshtur e të thyer si copëza mermeri.

Kur u ktheva në Strugë e paskëta në Prishtinë, pata bërë një shënim në fletoret e mia të shumta, ku herë pas here derdhi helmin me të cilin më gostit jeta - për këtë përjetim jo të zakonshëm. U fola për këtë thagmë edhe disa miqve të mi shkrimtarë, por sa "prej vetvetiu", siç do të thoshte Lasgushi, e sa me sugjerimin e tyre, hoqa dorë nga ideja për ta bërë publike atë që kisha parë. Atëherë ende kishim iluzione për ruajtjen e prestigjit të "Shqipërisë-mëmë"; kujtonim se duke i fshehur gjërat, që një ditë edhe ashtu do të dilnin në shesh, do t'i bënim shërbim të mirë Shqipërisë dhe kombit shqiptar në përgjithësi.

Ndonëse të dëshpëruar nga ajo që pamë, pas vizitës te varri i poetit të pavdekshëm, dolëm në qytet, tek të gjallët. Pimë kafe, takuam miq pogradecarë e korçarë, por edhe të ardhur nga Tirana. Shëtitëm buzë liqenit. Shkuam edhe në Drilon e Tushemisht. Pamë Shëndaumin hijerëndë tutje dhe larg, larg, në sfond, Malin e Thatë, ku veç sa s'kishte fluturuar shqiponja e arratisur e poetit. Pasdite vonë morëm rrugën për Qafëthanë dhe pasi pritëm rreth një orë në kufi, aty ku ndahet "zemra prej zemrës", vazhduam rrugën për në Strugë. Dielli tashmë kishte perënduar, kurse horizonti ende i kuq flakë pasqyrohej në syprinën e qetë të liqenit. Muzgu po binte ngadalë si një napë e bardhë. Dhe ndërsa gruaja e fëmijët humbën në turmën e korzos së famshme të Strugës, unë preferova t'i prisja te parmakët e urës, aty ku "Drini plak e i përrallshëm nis udhëtimin mengadalë mes-për-mes në Shqipëri"... Përsërisja me mend vargjet e Lasgushit dhe sodisja kalimtarët që shkonin në punë të vet me barrën e halleve mbi shpinë atë ditë maji të vitit 1991, kur po merrte fund një epokë dhe pritej fillimi i tjetërës.



Një vit më parë, në verë të vitit 1990, nga Tirana më kishte ardhur një fotografi (bardhë e zi), ku miqtë e mi nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Tiranë, gjuhëtari Remzi Përnaska dhe studiuesi i letërsisë Jorgo Bulo, tok me kolegët e tyre Seit Mansaku e Enver Hysa, kishin vënë, në emër tim, si thoshin ata, një tufë me lule mbi varrin e Lasgushit. Remziu, me shkrimin e tij të bukur, gotik, më kishte shkruar në shpinë të fotografisë: "Një tufë zambakë mbi varrin e poetit poradecar nga poeti veleshtar". Kjo fotografi, e cila arriti tek unë nëpërmjet sime motre, Vaes, që kishte pasur rastin t'i takonte miqtë e mi në plazhin e Durrësit, u bë shkas për lindjen e poezisë sime *Të shkosh në Pogradec*, të cilën kritik i ri poradecar, Neli Naço, do ta krahasonte me poezinë *Poradeci* të Lasgushit. ("Poezia *Të shkosh në Pogradec* është një poezi antologjike, me vlera të rralla, e denjë të qëndrojnë pranë poezisë *Poradeci* të krijuar nga Lasgushi").

Do të kalojnë plot pesë vjet nga ajo ditë maji e vitit 1991; do të rrjedhë shumë ujë Drinit tatëpjetë e do të rrokullisen shumë ngjarje, të gëzuara e të trishtuara, kur Pogradeci, vendlindja e poetit, do të bëhet djep i një manifestimi të madh letrar me emrin "Ditët e Lasgushit", i cili, fatkeqësisht, u mbajt vetëm një vit dhe nuk bëri traditë.

Ishte maj ose prill i vitit 1996 kur në Pogradec do të takohen poetë nga mbarë hapësira shqiptare, për të nderuar kujtimin e poetit dhe për të nxitur e kultivuar fjalën poetike në frymën e traditës lasgushiane. Aktiviteti zhvillohej kryesisht në sallën e shtëpisë së kulturës "Mitrush Kuteli", kurse poetët mysafirë ishin të vendosur që të gjithë në hotelin e bukur të qytetit buzë liqenit "Enkelana" (dikur: Guri i kuq).

Këtë manifestim, që zgjati dy ditë, e organizonte Lidhja e Shkrimtarëve dhe Ministria e Kulturës. Në program, pos leximeve letrare dhe takimeve me



publikun, ishte paraparë edhe një diskutim për poezinë e Lasgushit dhe, si zakonisht, në fund, ndarja e çmimeve dhe një darkë lamtumirëse. Por organizatori nuk ishte kujtuar për një detaj "të vogël": vizitën te varri i poetit. Prita mos po kujtohej kush, qoftë edhe ndonjëri nga ata që e mbajnë veten "lasgushologë", por më kot. Të dehur nga takimet me njëri-tjetrin, askujt nga poetët tanë nuk i binte në mend "takimi" me poetin e vdekur. Kur e mora fjalën, pasi fola për sistemin poetik të Lasgushit, për *Vallen e Yjve* e *Yllin e Zembrës*, për bukurinë e vargut të tij, për dashurinë e tij për Naimin dhe gjuhën shqipe, për kontaktet e Lasgushit me simbolizmin frëng etj., propozova në fund që, ashtu siç ishim, të gjithë së bashku, të bënim një vizitë te varri i poetit. Propozimi, natyrisht, u mirëprit, edhe pse nuk mungonin me siguri në sallë as ata që mund të rruhdnin turinj të të thoshin me vete: eh, ç'po na mërzi!

Ne ngrinim teori pas teorie për artin poetik dhe citonim emra pa fund poetësh e kritikësh anembanë botës, e nuk kujtoheshim për atë që na kishte ofruar këtë shans. Sikur kishim harruar kush na kishte sjellë aty dhe në emër të kujt bëhej ajo dafrungë. Cinik siç ishte për së gjalli, Lasgushi tallej me ne mbase edhe në varr. Në mesin e atyre që rrihnin gjoks për poezinë, kishte edhe të tillë që po t'i dëgjonte do të thoshte me siguri se nuk dinin as sa Cuci i tij, qeni legjendar i poetit, i cili i qëndron tek këmbët në monumentin e ngritur për nder të tij në Pogradec, në qendër të qytetit, pranë liqenit.

Pa humbur kohë, po atë ditë, karvani i poetëve mori rrugën për tek varrezat në periferi të qytetit. Ishin aty, sa mbaj mend, asët e poezisë së sotme shqipe: Fatos Arapi, Azem Shkreli, Ali Podrimja e Din Mehmeti (mungonin Kadareja e Agolli); ishin veteranët Pano Taçi, Muzafer Xhaxhiu e Murat Isaku; ishte aktori i madh i teatrit dhe i filmit, por edhe i deklamimit të vargut, Kadri Roshi; ishte poeti fjalëxhevahir, Xhevahir Spahi - Xhevoja i pashmangshëm me këngët, recitimet dhe dollitë e tij; ishin poetët "lasgushianë" Jorgo Bllaci e Koçi Petriti; ishte "motra" ime korçare, poetesha e njohur Natasha Lako; ishin studiuesit e veprës së Lasgushit: Sabri Hamiti e Aurel Plasari (i pari edhe poet, i cili, në rini, ishte munduar ta imitonte Lasgushin jo vetëm me vargje, por edhe me pamje; mjafton të kujtojmë portretin e hershëm të Lasgushit me flokë të gjatë, që kishte nxitur shumë poetë tanë të rrisnin flokët për t'i ngjarë); ishte, sigurisht, edhe kryetari i atëhershëm i Lidhjes, poeti Bardhyl Londo; edhe autorja e librit *Me Lasgushin në Pogradec*, Meri Lalaj, e cila, në faqen e parë të librit *Dialog me Alain Bosquet*-në, që asokohe sapo pat dalë nga shtypi në botim të "Onufrit", shkroi "përgjigjen" e vjershës sime *Të shkosh në Pogradec*;<sup>1</sup> edhe poetët Visar Zhiti, Eqrem

<sup>1</sup> Ende i ruaj si kujtim, në dorëshkrim, në librin *Dialog me Alain Bosquet*-në, këto vargje të Meri Lalajt. "Edhe sikur të mbarohej nafta krejt./ Sikur asnjë vapor të mos dilte në det/ Edhe sikur të mos ishin shpikur fare:/ Vetura, trenat, avionët, binarët/ Ju duhej të vinin patjetër këtu/ Ne duhej të vinim patjetër tek ju./ Hipur mbi qilimin stutruues/ Apo mbi kalin gërmuq/ A me ndonjë mjet tjetër përrallor/ Ju kemi pritur orë për orë... / Ju duhej të vinin patjetër këtu/ Ne duhej të vinim patjetër tek ju./ Sepse jemi i njëjti mall/ Sepse jemi i njëjti zjarr...". Sipër si titull, me shkronja të mëdha, është vënë fjala: PATJETËR. Vite më vonë këto vargje, autorja M. Lalaj i botoi, pa asnjë ndryshim, por

Basha e Basri Çapriqi; shumë poetë e poetesha nga Tirana, Korça, Pogradeci dhe nga mbarë Shqipëria; disa poetë nga Maqedonia (nga Shkupi e Tetova, por edhe nga Struga ime, fqinje me Pogradecin, që i bashkon i njëjti liqen); ishin, doemos, të bijat e poetit: Kostandina (e urtë) dhe Maria (e sertë); nuk mungonte miku i poetit, doktor Mistoja dhe pogradecari tjetër simpatik, thujse vazhdimisht i pirë, shkrimtari i humorit, Niko Nikolla (me origjinë nga Belica e Epërme). Ministri i kulturës, shkrimtari Teodor Laço, mori pjesë vetëm në hapje, natën e parë dhe pastaj u kthye në Tiranë për shkak të obligimeve të veta.

Kishte edhe miq e të njohur të poetit nga Pogradeci, mësues të letërsisë nga ky qytet, intelektualë, studentë etj. Nuk di në kishim me vete kurorë apo jo, por mbaj mend se dikush mbajti një fjalë të shkurtër, e ky ishte laureati i takimit, poeti Fatos Arapi, ndërsa ne të tjerët rrinim të heshtur.

Edhe kur, me propozimin tim, shkuam për vizitë te varri i poetit, tashmë të rregulluar, unë s'bëra zë për atë që kisha përjetuar gjatë vizitës sime private më 1991. S'i thashë askujt asnjë fjalë për atë që kisha e parë me sytë e mi pesë vjet më parë! Mermeri i thyer tani ishte ngjitur, kurse kujtimi im i hidhur qe zbehur "në remin e kohës", siç do të thoshte Kuteli i Xha Brahos.

Pata filluar ta harroj këtë "përjetim", kishte filluar të më shlyhet nga kujtesa, kur, papritmas, lexoj e dëgjoj se në Shkodër është dëmtuar rëndë nga njerëz të panjohur busti i Migjenit, ndërsa në shkrime të botuara në shtyp e periodik, si ai i një dinjitar të klerit katolik, mons. Zef Simonit: "Përkrahës i një bote pa zot e i një shoqërie pa religjion", zhvlerësohet krijimtaria e poetit. Varri dëmtohet, busti prishet, poeti anatomohet. Lexoj dhe nuk u besoj syve. A është e mundur? Si mund të ngjajë kjo në një qytet me traditë si Shkodra dhe, madje, në "erën e demokracisë"?

Dy poetët tanë më të mëdhenj të shekullit XX, Lasgushi dhe Migjeni, njëri në Jug e tjetri në Veri, bëhen pre e vandalizmit në "demokraci", qoftë në formë të kritikës keqdashëse e denigruese, qoftë në formë të përdhosjes së varrezave. (Dy nga pararendësit e tyre të mëdhenj, Bogdani dhe Fishta, madje, nuk kanë varr fare, njëri për shkak të pushtuesve turq, që ia nxorren eshtrat nga varri dhe ua hodhën qenve rrugëve të Prishtinës, kurse tjetri për shkak se emisarët e "pushtetit popullor", me të ardhur në pushtet, ia ndaluan veprën dhe ia zhbënë varrin, ngaqë shihnin tek ai një kundërshtar të pakompromis të ideologjisë së tyre).

Në vitin 2005 pata rastin ta vizitoja në Paris varrezën e famshme *Père Lashaise*, ku prehen përjetësisht njerëzit e mëdhenj jo vetëm nga Franca, por edhe nga mbarë bota: Molieri, Lafonteni, Balzaku, Floberi, Koleta, Oskar Uajldi, Prusti, Aragoni, Sadek Hedajati, Xhimi Morrisoni etj. etj. Për të hyrë në të vizitori duhet të blejë në hyrje biletë, kurse për t'u orientuar si duhet, duhet të ketë skicë në xhep. Gjithçka aty i ngjan një qyteti me rrugica, mure, rrethoja, alë, buste e lule. Veçse ndryshe nga qytetet, që janë të zhurmshme, në *Père Lashaise* mbretëron një qetësi absolute. Dhe ndërsa endesh në atë botë të amshimit, ku çdo gjë është e rregullt, e pastër dhe solemne, s'ke si të mos e ndiesh veten keq kur të kujtohet mjerimi i varrezave tona. Pa le pastaj sjelljet vandale si ato që përmendëm më sipër.

Dikush ka thënë me të drejtë se shkalla e emancipimit të një shoqërie shihet, veç të tjerash, edhe nga kujdesi e respekti që tregojnë pjesëtarët e saj ndaj varreve, aq më shumë kur në ato varre flenë njerëzit e mëdhenj të kombit, që me punën dhe veprën e tyre ia kanë zgjuar ndërgjegjen, ia kanë ngritur moralin, ia kanë pasuruar shpirtin dhe ia kanë rritur lavdinë atij.(2005)

me titull tjetër: *Përgjigje poetit Agim Vinca*, në gazetën "Drita" (20 korrik 2003).

# AROMA E PENDIMIT

Përktheu në shqip Dashamir Malo

Shkëputur nga vëllimi poetik "Ylber Ndjesish" (7 poetë)

## MARAM AL-MASRI, SIRI (FRANCË)

\*\*\*

Natën rroke prej beli.  
Puthi gushën si më puthje mua  
dhe mbaj në duar lodhjen  
e ditës së saj shterpë.  
Thuaji asaj nga ana ime  
se është kaq e bukur dhe e dëshirueshme  
siç ishte ditën kur e njohe për herë të parë.  
Bëj dashuri me të  
siç bëje dashuri me mua  
deri sa zogjtë e saj të heshtur  
të fillojnë të çuqurijnë,  
me gruan që është armikja ime.

\*

Një bashkëshorte kthehet në shtëpi  
me aromën e një burri të huaj.  
Lahet hedh parfum  
veçse e athët mbetet  
aroma e pendimit.

\*

Sa budallaqe!  
Sa herë që zemra ime  
dëgjon një rrahje,  
hap flatrat e saj.

## JORGOS HRONAS (Giorgos Chronas), GREQI

### ODE PËR MARILYN MONROE-N

Vizatoni mbi trupin tim  
gjithë krateret e vullkaneve të tokës.  
Bekimin e dokerëve të Nju Jorkut.  
Vizatoni mbi trupin tim eunukët e  
Perandorit të ri.  
britmën e lejekëve të Ivikut.  
Vizatoni mbi trupin tim nënën time Ethel,  
- Ethel nuk e quanin? Të dashurin tim të fundit,  
që vdiq me motor në Çikago.  
Vizatoni mbi trupin tim pjesëtarët e xhazit,  
të *Rock and roll*-it, të hashashit dhe  
barbituratit,<sup>1</sup>  
vizatoni mbi trupin tim orgazmat e  
pavullnetshme  
të homoseksualëve të Kinsei-t,  
dhe të zuskave të Nju Jorkut.  
Stolisni mbi trupin tim,  
atë zonjë në televizor e cila thotë :  
"Kërpudhat e Tibetit preferojini  
për gjellën e së Mërkurës."  
Stolisni mbi trupin tim,  
zërin tim në diskun *78 PPM*,  
duke kënduar himnin kombëtar  
të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.  
Pastaj portreti im të qakullojë natën  
në *Pennies*<sup>2</sup>, në letra tualeti,  
në fletore shkollash  
dhe në të brendshme që kushtojnë lirë.  
Këto tha atë mëngjes Marylin Monroe,  
duke hyrë në WC-të e Nju Jorkut,  
duke mbajtur në duar qerpikët fallco  
dhe kokën e saj.

## GEMA BOCARDO CLAVIJO, SPANJË

### ARTI I LUFTËS

Unë do të të mund në të gjitha betejat,  
por në fund ti do ta fitosh luftën,  
sepse strategjia ime është e pagabueshme,  
veç ti nuk ndien dhimbje.  
Edhe pse të kam shkakuar plagë  
në gjithë trupin,  
ti ngul kamën  
në zemrën time.

### STERILE

Mbolla lule  
në dunat  
e shkretëtirës sate;  
dhe oriz  
në valët  
e oqeanit tënd.

### LETËR E NJOMUR

Përvoja ime është  
një artikull i dobët gazete,  
një skenar bajat,  
një dorëshkrim i rremë,  
një mashtrim në poker,  
një poezi plagjiaturë,  
duartrokitje në një konkurs televiziv,  
letër e njomur.


## DUSKA VRHOVAC, SERBI

### SHI MISTIK

Natën e shkuar me ty kam mbledhur  
lulegaku përgjatë lumit të turbulluar  
Bistrica.  
Nga qielli mbi ne binin petale të bardha,  
nga duart e shpitrave të cilët nuk kanë  
gjetur paqe.  
Nga bari mund të dëgjohe pëshpëritjet e  
dashnorëve antikë,  
poterja e trokëllimave të kalorësve duke  
ardhur nga rruga,  
si në poezitë e Nazim Hikmetit.

Ndërsa pikat e shiut mistik ngjyroshin  
fytirat tona,  
balsam për shpirtin xixëllimi i syve të tu  
dhe me një sinergji të mallkuar,  
fryma jote e nxehtë në buzët e mia të  
zhuritura  
u shndërrua në pika të kuqe vese.  
Çdo gjë ishte joreale përveç natës,  
përveç lotëve tanë dhe bekimeve të Zotit  
tonë.

Tani e di që je ky që je dhe ky që nuk je,  
që je agimi blu i vdekjes sime të qetë  
dhe muzgu i dhimbshëm i rinisë sime të  
mërguar;  
që je zëri i ndrydhur i një klithme të lashtë,  
ëndrra e arratisur nga streha e një engjëlli të  
përgjumur,  
i cili u lodh nga një zell i tepruar  
dhe dëshironte të pushonte mbi shpatullat  
e mia.



## JULIJANA VELICHKOVSKA, MAQEDONI E VERIUT

### POESIA BLUE

Flokët e mi kundërmojnë smog  
Oh, shpirt,  
më tha:  
Flokët e tu kundërmojnë Shkup.  
Më tha:  
Flokët e tu kundërmojnë smog Shkupi.  
Oh, shpirt,  
më vjen keq,  
i thashë.

### DASHURI VJESHTE

Do të doja që të vije  
si grabitqar  
pas shpinës sime  
të sulmoje!  
Si luan  
të kafshoje qafën time.  
Të më bëje të shijoj tokën  
barin  
shiu...  
Të ikje mandej  
pa asnjë shpjegim.

## NANSI DHANELI (NANCY DANIELI), GREQI

### TJETRI

Pikëlluese. Të ndiesh kaq vetmi  
në mes të turmës.  
Ngushëlluese. Të dish si  
të njëjtën vetmi  
të ndiejë edhe turma.  
Thua që je ti dhe të tjerët.  
Thua që je ti ai tjetri,  
që ecën i vetëm,  
që bie të flerë i vetëm,  
që shtyhet mes turmës i vetëm.

### ÇADRAT

Bie shi.  
Shiko si loti i shiut  
shpëlan  
rrembat e gjetheve  
krahët e zogjeve  
çadrat e pluhurosura.  
Bie shi.  
Do të kishim mundur ta përzienim  
në heshtjen e emocioneve.  
Nëse çadrat  
nuk ishin  
për vetmitarët.

## ZDRAVKA STOYANOVA SHEYRETOVA, BULLGARI

### UNË TË DUA TY

Këto fjalët e tua  
do t'i ruaj si të shtrenjta  
midis buzëqeshjes  
dhe vështrimit tënd të dhembshur.  
Këto fjalët e tua  
do t'i ruaj mënjatë -  
përqafuar me zell,  
besnikërisht  
të pluhurëzuar me naftalinë,  
të vendosura në sirtarin e poshtëm,  
ndërmjet ditës dhe natës,  
të sëndukut të kujtesës sime.  
Dhe kur prej librit të stinëve  
vetëm një fletë e herbariumit të jetë larguar,  
unë do t'i hap -  
këto fjalët e tua.  
Dhe atëherë hëna do të jetë ngritur lart,  
mbi fytyrën time duke rrezëlluar,  
ku shumë yje do të jenë shfaqur  
në sytë e mi të ngrysur.  
Unë rishfaq  
përsëri atë vajzën e bukur -  
të rinisë -  
falë këtyre fjalëve të tua.

1 Barbiturat - lloj droge farmaceutike.  
2 Penny - një e njëqindta e dollarit.

**DORËSHKRIM NGA DITARI  
I DELES SË LUMTUR**

- vazhdim -

1.  
Fëmijët tanë jetojnë të lumtur,  
Përdorin celularët e markave më të fundit,  
Tik-tok, Face book, instigram, podcast, drone në hapsirë,  
Kanë njohuri grafike për ditën e kurbanit, therret e  
përgjakshme,  
Por nuk kanë asnjë shënj terror-panik,  
Jetojnë të shkujdesur der' në çastin e fundit, luajnë më tehe  
thikash,  
Carpe-Diem është deviza e tyre me gjuhën e rrjepur të  
xhinsave , qëngja të pafaj, lozin muzikë heavy metal në  
livadhet me pemë plastike

Dhe prinëditit nuk lejphen të merren me edukimin e tyre,  
Sidomos pas shpalljes së Ligjit të rreptë kundër Kulturës  
Klasike  
Dhe nuk mësojnë poezi ,  
Blegrimat tona janë hegzametri i vetëm që na jep siguri.

2.  
Dhe ditën e Votimit zgjohemi herët nga muzika,  
Është koha të kujtojmë ujçërit e dikurshëm, tmerret e jetës së  
lirë,  
Pasiguritë e hapsirave, kohën kur pinim ujë në përrenj,  
Barin që rritej aq lart, sa të mbulonte trupat tanë,  
Duke i dhënë shans ujçërve  
Që të mos lënë asnjë mundësi për të parë  
krim-holokaustin, terror- hatanë.

Votimet janë të lira; na duhet të zgjedhim mes një deleje dhe  
një deleje tjetër,  
Si provë se tani nuk kemi më frikë. Provojmë superioritin  
tonë;  
Zgjedhjet ndiqen nga kamera të sofistikuar  
Për t'i festuar zgjedhjet në fund,  
Fillon ceremonia e kurbanit - therret e deleve  
Një ritual i lashtë që na bën të ndjehemi më të sigurt se kurrë!

3.  
Do ketë kohë të vështira nëse ne këmbëngulim të kemi  
kujtesë,  
Askush nuk i kujton dashurinë e largëta për Delen e Zezë,  
As unë vetë. Është e vertetë se ndonjëherë ai më shafqet në  
ëndërr,  
Po kush tha se ëndërrat janë racionalitet? Njerëzit prandaj  
janë fatkeq  
Ngase flasin për mijëvjeçarët dhe vazhdojnë të gërmojnë  
varret e të vdekurve  
Në Mesopotani, në Varret e Faraonëve, në Greqinë dhe Romën  
e Lashtë.  
Kujtesa është si ta marrësh kufomën e të vdekurit dhe ta çosh  
në shtëpi  
Dhe t'i përzesh të gjallët për hatër të tij!

Janar 2025

**NJË VIZITË NË SHTËPINË  
E FUNDIT TË PRINDËRVE**

Vij te shtëpia juaj,  
Edhe pse e dija se do qëndroja jashtë, para porten që nuk  
hapet më kurrë.  
Nuk them se rruga nuk ishte e lodhshme dhe e gjatë,

Por janë të lashtit që na e kujtojnë  
Se distanca nga jeta deri te vdekja është vetëm një hap.

Pleq të gjorë që tashmë i kanë kaluar të njëqint vitet,  
Rrënuar nga plagët e jetës, nga peshja e gurëve që mbajtët mbi  
shpinë,  
Nga terrorët me peshë sakrofaqësh, nga pabesia e frikshme e  
Jetës.

E prapë të vdekurit duan të varrosen mbi lartësitë,  
Që të kenë çfarë të shohin si nga një dritare,  
Ata që u kryqëzuan gjithë jetën e vet për të tjerët.

Tani janë veç dy pleq në një varr të harruar, me mallin për  
jetën,  
Në periferinë më të largët të qytetit. Sa shumë që kanë pritë,  
Dhe më kërkojnë të falur ngase vetë nuk arritën të bëjnë  
vizitë të gjallët.

Distanca nga vdekja der' te jeta qënka shumë më e gjatë,  
Se nga jeta te vdekja! Duhet prova e adreses, shenjat e  
identitetit,  
Llogaria bankare, plus viza që duhet marrë në konsullatë.!

S'ka mbetur asgjë për të thënë. Dy pleq që i kaluan të njëqind  
vitet,

**TIRANA, NJË GRUA**

Tirana është Grua, emër i gjinisë femërore  
Nuk është e përdalë, edhe pse make up i saj krijon  
keqkuptim,  
Ka shumë të kuq, të kuq, të kuq, në faqe, në buzë, në ballë,  
në bashktinglloret xhinga mingla – varëse në qafë të saj  
Në emërat e rrugëve, në kollaret e bashkëshortëve zyrtarë,  
në ngjyrën e gjakut të qëngjave që theren pafaj...  
Është e dashura e përhershme e të fortëve  
Të Babrrukës, të Kamzës, Kombinatit, të Lagjes Një Maj...

E shoh nga maja e Malit të Dajtit, shtrirë në shtrat si një grua  
e pafaj,  
Nuk është e përdalë, shoh ca lotë që pëpiqet t'i fsheh me  
kujdes,  
Mund të jenë dhe lotët tanë, më shumë se lotët e saj.  
Shoh fëmijët që ia kthejnë kurrizin për të ikur larg,  
Fëmijët plangprishës për të cilët ende nuk është gjetur një  
Rembrandt...

Nga maja e Malit të Dajtit e shoh, shtrirë si një grua e lodhur  
në shtrat!

Janar 2025

**VIJ I VETËM NË KËTË CEP  
TË BREGDETIT**

Vij i vetëm në këtë cep të bregdetit,  
Të shoh gjurmët e tua të shumë viteve më parë.  
E ndjej heshtjen tënde të ndrojtur at' mbrëmje në Vjeshtë,  
Eren që fshihej mes dallgëve të detit, guackat,  
Leshterikët që i nxirrte uji në breg si trupa të mbytur,  
Si ritual magjik i shpirtit të dashur.

Të kam më pranë se kurrë-edhe pse e padukshme-  
Mbështjellë me eren e pazhurshme si fantazëm.  
Dhe deti me ujën e vet të kripur më kujton ca lotë tinarë  
Që nuk duan t'ia dijnë për asnjëri.

Është si të shohësh një çast të vetëm, jetëshkurt,  
Nga një ledh i përgjakun transheve të Luftes,  
Një flash kujtese mbajtur mënd me dashni!

Janar 2025

**LAJME NGA BOTA**

Fëmijët prapë ndjekin kronikat e mbrëmjes  
Si pjesë e detyrave të shtëpisë;  
Një gjyshe u dënua me vdekje në New York  
Ngase i tregoi mbesës së vet një përrallë;  
Vëllëzërit Grimm nuk i njohu askush në Quiz,  
Dhe as Andersenin të cilin e qujtën të marrë.  
Me vendimin legal nga një Bankë  
Kolodin plak e arrestuan, e kapën në flagrancë,  
Kur desh t'i mbillte monedhat në një tokë të shkretë.  
Vetëm e vetëm që t'i blinte Pinokut një biçikletë.

Tani fëmijët rriten para kohe. Lozin me kapsula,  
Dhe mësojnë në play-station taktikat e vrasjes pas shpine,  
Ëndërojnë të pushtojnë Hënë  
Që t'i shpëtojnë normalitetit të mërztishëm të prindërve.

Në Londer Romeon e ekzekutuan katërfish,  
Me metodën efektive që përdorej në mesjetë,  
Sepse shkroi një poemë, gjithë pasion dhe zjarr,  
Tek këmbëgulte se e do Xhuljeten përsëri;  
E kush mund ta durojë këtë fyerje anakronike dhe të ligë  
Që mund të shkaktojë dëme traumatike te çdo fëmijë?

Në Romë nuk lejohet prodhimi i filmave për të vegjlit,  
Sepse të gjithë fëmijët rriten brenda një dite të vetme,  
Dhe udhëtojnë, një javë pasi lindin, në Londer a Zvicrelend,

Më duhet të hesht, që të heshtin keqkuptimet. Nuk arrita t'i  
varros në kodrinë,  
Që të shohin si gjithë të gjallët nga lartësitë .

Kthehem , pasi kaloj qindra qytete, dhjetra shtete, dhe dy dete  
në mes,

Çdo natë shoh lart në qiell, përmes mjegullnajave, një yll i  
vogël feks,  
Dhe kujtohem se sferat qiellore nuk flasin në gjuhën e të  
gjallëve  
Teksa dy pleq nga ky yll i vogël më shohin me një mall sekret.

Janar 2025

**SHTYRJE AFATI**

Ka mbi dymijë vjet që e ndjej dhëmbjen  
Ndonjëherë dhoma e ndejtjes më duket sallë në spital,  
Shoh me kujdes trupin se mos gjej plagë.

Dhe vetë dashuria që rri larg, larg  
Si një plagë e infektuar që nuk do të prek të tjerët  
Me rrezikun se do përhapet si murtajë pa shkak.

Statistikat numërojnë të vdekurit si në një festë pagane të  
lashtë.

Kryqëzimi nuk qe i lehtë. Pastaj kronikat televizive,  
Që lavdërojnë Barabajn. Gazetarë të paguar nga Bankat e  
Pons Pilatit  
Më të fajshëm nga Juda mëkatar. Gazetarë, analistë, blllogist,  
Vrasës që më buzëqeshin, shkrimtarë që mbajnë në çanta  
thikë,  
Dhe turmat që këndojnë: Hosana! Lavdi atyre që kanë frikë!

Të marrë ty në telefon, sapo hyj në shtëpi,  
Dhe të them se e shtyva Aktin e Ringjalljes

Për një kohë më premtuese që shpresoj se do vij!

**REQUIEM**

Vdekja e parë vjen pas Vrasjes së parë,  
Dhe pas vrasjes është Terrori.  
Ç'u bë me Abelin? Historia flet vetëm për Kainin,  
Abeli nuk la pasardhës. Mbet i vetëm Kaini,  
E ndjejmë vetminë e tij edhe ne, mes turmës në Shams Elizé,  
Dhe aq më shumë në Avenjunë e Pestë a në Trafalgar Square.  
E ndjejmë dhe në Kopshtin e Edenit, dhe në Rrugët tërë  
pluhur të Tiranës,  
Kur ecim mes të nxehtit që tremb dhe vetë Luciferin, buzë  
kanalit të Lanës,  
Edhe në Saharë, a brenda Mureve të Bankës së Pendimit  
Ku Juda shkon të tërheq asprat prej ari, i përpiktë  
Pa harruar të përmend shumë të vjen nga interesat e  
kursimit...

Vrasja është e para, dhe pastaj terrori  
Mungesa jote, kujtimi i dashurisë që nuk përsëritet, tradhëtitë  
e miqve,  
Sa herë vritemi para se të vdesim? Pemët janë më me fat,  
Ringjallen në stinën e duhur, kurse ne nuk na prekin stinët,  
Dhe nuk dijmë të ringjallemi, siç bëjnë lumenjt e tharë a  
bimët.

Kronikat flasin për luftërat, për të vrrarët, masakrat  
Sa herë na duhet të vritemi para se të vdesim,  
Me silenciatorët e mungesës së dashurisë, helmet e  
gëzueshme të harrimit?

Eci sot në rrugët e këtij qyteti. Askush nuk do ta përmend  
emrin e Kainit  
Që na premtoi prej shekujsh vrasjen pas shpine të Shpirtit!

Janar, 2025



Kurse në Tiranë foshnjat e sapolindura vrapojnë për t'mos lënë bosh në botë asnjë vend.

Tani fëmijët rritën para kohe. Lozin me harta dhe Globe Ku do shkosh ti pas një muaji? Në Finland a Gjermani ? Një foshnje dymuajshe së shpejti do shpallet eksplorator i shekullit,

Sepse arriti të zbulojë një Kontinent të ri !

Janar 2025

## HISTORI DASHURIE

Një herë me tre vajza njëherësh kam bërë dashuri, Me njëren isha në shtrat, tjetren e mbaja në kokë, Të tretën në zemër, në fshehtësi.,

Ajo që e kisha në shtrat ish e para që më la Duke më pëshpërit si fjalë dashurie në vesh, Ti e kupton, jeta është e shtrenjt, çmimet rriten çdo ditë, Pastaj ti as shtëpi nuk ke, fatkeqësisht Ndarja nuk është më hatá, ji realist, Sot është ditë me diell, por neser mund të ketë rrebesh, Më beso, ndarja për ne të dy është më mirë!

Vite më vonë, në Kompaninë e saj Imobiliare Mora një dhomë të vogël me qira, me kontratë 30 vjeçare!

Ajo që rrinte brënda kokës time, Më braktisi më vonë, sapo u shpall Miss i Vitit 2040, Dhe as nuk më njohu kur më pa si fotoreporter, Tek vrapoja pas makinës së saj luksoze, Për t'i bërë foto Për revisten më prestigjioze në vënd!

Ndërsa vajza të cilën e mbaja thellë në zemër, në fshehtësi Ka kohë që është martuar me armikun tim rival, Me sytë e trishtuar tani më thotë se unë e kisha fajin, Se pas martesës së saj ika larg ...

...Të paktën ajo më lë t'i përkëdhel me fjalë fëmijët e saj sadopak, Sa herë që i shoh të lozin të pafajshëm në Park.

Janar 2025

## KRIM I PAFALSHËM

Nëse kthehesh dy a tre herë në të njëjtin vend, Çdokush do të thotë se kthehesh në vëndin e krimit. Vetëm tani e kuptoj se c'krim i pafalshëm, Qënka me të dashtë prapë, Ç'krim qënka të mos i bindesh ligjeve të harrimit.

Kthehem te ajo kallamishta buzë lumit, Atëherë kur mjellmat bëhen gati të largohen pak nga pak, Duke të ndërë ty dhe atë heshitjen e papërgjegjshme Që na përshendet tash tridhjetë vite nga larg.

Era është fshehur në pemët përreth. Sa herë kam ardhur këtu, Dhe nuk kam ndërë asnjë pendim,

Të paktën nuk jam serial killer, Të desha veç ty- e prapë kthehem pa e ditur as vetë përsenë, Kam lënë pas qytetin modern kërcënues si horror, Dhe më thonë se unë quhem vrasës, Përderisa kthehem nga larg, dy a tre herë, në të njëjtin vend.

Ç'krim i pafalshëm qënka që të dashkam me gjithë mënd!

Janar 2025

## VITI NJËMIJË E NËNTËQIND E NËNTËDHJETË

Duhet të kthehesh pas në trenin e vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, Nëse papritë ndjen se të kapin ethet e nostalgjisë (duke preferuar një rrugicë të shtrembërt gjithë gropa, dhe jo rrugën e drejtë), për të shkuar në qytetin e lindjes; Fatorinoja të kërkon biletën, kurse ti menjëherë kujtohesh se je në vitin nëntëdhjetë. I jep fshehurazi gjysmën e shumës së çmimit si një kompromis që ajo e pret. Dhe ti tani mund të udhëtosh i qetë; Një studente e ndrojtur që kthehet në shtëpinë e vet, një polic që i sheh të gjithë me dyshim, si në tregimet e Çehovit që ti vetë po i lexon në tren, dhe treni që pretendon se lëviz dhe ec.

Tre zyrtarë me krevatë të kuqe, që kanë mbuluar fytyrat me gazetë, dhe flenë të qetë, një prostitutë që sheh fshehurazi nga polici, një ish i burgosur mosbesues që nuk flet, dhe sheh përreth me kujdes, një pijanec i lumtur që qesh. Jashtë dritareve të trenit, në fushat pa pemë, njerëz që digjen në diell si në Ferr, tek gërmojnë një tokë të shkretë, dhe zemra të dhemb. Dhe në stacionin më të afërt një grua që përcjellë një burrë të trishtuar, hyp dhe zbret dhe hypë prapë në tren, dhe qanë pa turp me denesë.

Dhe trishtimi i pafundt, pa shkak të dukshëm, që të ndjek, të ndjek;

Zbres në stacionin e qytetit tim; Kthej kokën nga treni që ka filluar të largohet ngadalë, dhe e shoqëroj me sy derisa zhduket larg si një re në qiej.

Secili nga ne, siç mund të merret me mend, në vitin njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, mund të ishte vetë ky tren.

Gusht, 2024

## NJË DITË, NË PICCADILY, LONDER

Dal nga shtëpia në rrugët e qytetit të madh, Dhe përzihem me turmën. Nuk e di se ku shkoj, Eci pa qëllim, nuk dua të mbërrij gjëkund Si ajo reja lart në qiell, pa një destinacion, I vendosur të jem moskokëçarës në turmë, Ndoshta dhe pak i lumtur, një ditë e bukur me diell, Të bën të kujtosh. Dhe ja ku më shfaqesh, Në ditën e fundit kur u ndamë, Në qytetin më të vogël në botë, Në qytetin më të mjerë të Ballkanit. Ah, Zot, sa e bukur! Dhe trupat e lakuriqt në dhomë, Dhe seksi që na bën të fluturojmë, Dhe lutjet e tua që të mos ik në qytetin modern... Tani më duhet të shkoj në National Gallery, (duke shmangur Sallën e Artit Post-modern me takt), Që të gjejë portretin më të bukur të gruas më të bukur, Që të them se të pashë ty. Dhe si ajo reja lart në qiell që ka filluar të shndërrohet në shi, ndjej lagështirën të vërshojë në sy, si një Lum pa shtrat; kështu ndodh kur ec pa destinacion, në Londer,në një ditë të bukur me diell duket se është e pamundur të jetë i lumtur, një ballkanas që mban mbi supe më shumë kujtesë sa ç'mumt të përtyp (Winston Çërcilli, dora vetë!) Qyteti modern që mburret se është i fuqishëm, Ndër qytetet më të mëdhenj të planetit, Sa i vogël që je para një qyteti të humbur të Ballkanit, Që ruan kujtesën e një vajze të bukur Që pa botox, pa kremëra kozmetikë, Pa okultet e operacioneve plastik, pa recensionet të rremë, Ruan më mirë se National Galleri,

Bukurinë e përjetshme të kujtesës për ty.

Janar 2025

## HERONJTË

Heronjtë nuk kanë më nevojë për statuja, Dhe as për bronx, e as për kuajt hyjnorë që hingëllijnë në një gjuhë tërë ankh, Heronjt e sotëm braktisin spitalet, Dhe dalin në rrugë me plagët që ende kullojnë Iu shmangen gazetave, stacioneve të Ti-Vi-ve Nuk durojnë të marrin më plagë lavdërimesh, tituj të rremë Dhënë nga presidentë të tredhur, kryeministra eunukë, a kritikë arti dekretuar në pazare qepësh, Iu shmangen bulevardëve, ecin në rrugicat tona të feminisë, Të dënuar nga dashnitë e vjetra e të sinqerta, Në kërkimin nostalgjik të një jete të ngjashme me jetën tonë. Veç statujat e thyera ilirike të zhvarrosur në muzgjet e vonë, U japin atyre një buzëqeshje tërë ndrojtje, Si ajo drita që japin yjet e largët Për njerëzit e verbër që e kanë vështirë ta dijnë se për ku shkojnë;

Askush nuk i tregon me gisht kur i shohim në heshtjen e tyre, Dhe as kur ndalen një çast dhe prekin plagët që ende kullojnë, Veshët i kanë mbyllur me dyllë, si Odisea pranë sirenave, Që t'mos dëgjojnë ariet joshëse të tenorëve për lavdinë; Vijnë tek ne, fëmijë të rrugicave tërë pluhur Dhe na pyesin, nëse i kujtojmë adresat e shtëpive tona të vjetra,

dhe emrat e stërgjyshërve tanë, Sikur në këtë pyetje të ishin varur fatet e gjithçkaje; Dhe vetëm kur sigurohen se kujtesa jonë është prapë e freskët si në ditën e parë, Ua kthejnë buzëqeshjen statujave të lashta, të thyera, Me një mirëkuptim mijëvjeçarë

Korrik, 2024

## SI MURGJËT E VJETËR

Si murgjët e vjetër asket, Duam të blatojmë shënjat dhe simbolet tona të shënjata, Po kujt,kujt? Altarët kanë kohë që mbajnë statuja të thyera. Ikona të djegura, dhe ndonjëra prej tyre që i ka shpëtuar flakëve, Mban veç figura të shpërfytyruara.

Kujt t'ia blatojmë shënjat dhe simbolet tona të lashta, Lënë trashigim nga etërit tanë dhe etërit e etërve tanë ?. Greminat e Harrimit janë më të thella se oqeanet, Shohim nga njëri-tjetri të hutuar,

Poshtë yjeve të përgjumur që shohin drejt nesh Si Polifemë të verbuar.

Janar 2025

## PRIMORDIALE

Më duhet të shkoj në Tendat e shkretëtirës Për të cilat flet Kënga e Këngëve. E di se të gjejë aty. Dhjetë mijë vite që pret.

O vajza të nxira nga Dielli përvëlues, Trupi i saj është më i bardhë se alabastra, Tani që kushdo për shkrirjet gobale flet.

Avionët fluturojnë përherë e më lart, Kujtesa zgjon ujnat primordiale të pranverës që shkrin Në honet e fshehura të ujdhesave;

Do kisha dashtë të jem një Odise mbi dallgë Se sa një Vullkan që tërheq këmbët zvarrë mbi flakët e ndezura.

Korrik, 2024

## NË FUNDIN E JETËS TONË

Reklamat flasin për ndërrimin stinor të rrobave, Dhe fletët e kalendarit kanë filluar të bien si gjethet në vjeshtë, ...Na duhet të jemi më të kujdesshëm për rrobat e dimrit që vjen. Palltoja të jetë më e ngrohtë,shalli më i gjërë Supet, qafa dhe vetë fytyra duhen mbuluar më me kujdes, Sidomos fytyra është më mirë të mos shihet në rrugë - një kapele me strehë të zgjatur, Bën të mos njihesh nga ato që kryqëzojnë rrugën në semafor;

Këpucët një numër më i madh, bëhët më e vështirë përkulja për t'i veshë a çveshë; Nuk ka kohë për preferenca ngjyrash, për modë, Duhet t'i dijmë mirë masat, numërat e trupit tonë, Çorapet, natyrisht, të jenë nga ato që hiqen lehtë...

Po zemra, zemra,ç'numër duhet të ketë? Sa duhet të jenë rrahjet e saj? Gjaku që pulson? Ritmi i saj duhet të jetë i përpiktë, Nuk lejohet asnjë aritmi,si stonatura që në muzikë nuk shkon; Është zemra më e fundit e përdorur nga ty, Nuk ka kohë për një zemër tjetër, Duhet të kurdiset me kujdes, që të kthehen gjithë dashuritë e jetes tënde pas, Pa harruar asnjë çast, Dashuritë e mëdha, dashuritë e mohuara, dashuritë kalimtare që i le jashtë Dashuritë që vetë i harrove pas dere, ende tek qullen në shiun rrebesh, Sytë e trishtuara të grave që desha a të deshën në fshehtësi; dashuritë që nuk i harrove asnjëherë, asnjë, A dashuritë e lëna përgjysëm për një kapriç të kotë, Sepse është zemra e fundit, më kot një tjetër pret, Të gjitha dashuritë e jetës tënde me vete duhet t'i kesh,

Aq më tepër tani,kur fletët e kalendarit vazhdojnë të bien më shpejt se gjethet në vjeshtë.

Gusht, 2024

Tetori ishte i ftohtë dhe me shi si rrallë herë. Çatitë me dërrasa ishin nxirë. Bari i pleksur në kopësht ishte shtrirë, çdo gjë lulëzonte, dhe vetëm një luledielli e vogël pranë gardhit nuk mund të lulëzonte dhe shkërmoqej. Mbi livadhe që nga lumi rrogomiseshin re të çlirëta duke duke kapur degët fluturuese. Prej tyre derdhej shiu mërzhitshëm. Nuk ishte e mundur të ecje ose t'i jepje makinës nëpër rrugë dhe barinj të filluan t'i futin tufat e tyre në livadhe.

Fyelli i bariut do të heshtte deri në pranverë.

Për Katerina Petrovnën bëhej edhe më e vështirë të ngrihej në mëngjes dhe të shihte gjithçka njëllor: dhomat ku aroma e hidhur e stufave së pandezura rrinte e amullt, pluhuri mbi "Lajme nga Europa", filxhanët e zverdhur mbi tavolinë, samovari dhe pikurat e mureve që nuk ishin pastruar prej kohësh. Në dhoma ishte errësirë kurse në sytë e Katerina Petrovnës tashmë ishte shfaqur uji i errët, ose ndoshta pikurat ishte zbardhur me kohë, por asgjë nuk mund të nxirrej prej tyre.

Katerinës i kujtohej që ishte një portret i babait të saj dhe ky, i vogël, në një kornizë floriri, dhuratë nga Kramskoi, një skicim për "Të panjohurin" e tij. Ajo e kaloi jetën e saj në një shtëpi të vjetër të ndërtuar nga i ati, një artist i famshëm. Në pleqërinë e vet, artisti u kthye nga Shën Petersburgu në fshatin e lindjes, jetonte në qetësi dhe kujdesej për kopshtin. Nuk mund të shkruante më: dora i dridhej, shikimi i ishte dobësuar dhe sytë i dhimbnin shpesh.

Shtëpia ishte, siç thoshte Katerina, një përmendore dhe ishte nën mbrojtjen e muzeut rajonal. Por çfarë do të ndodhte me këtë shtëpi kur ajo, banorja e fundit, do të vdiste? Katerina nuk e dinte. Në fshat, ai quhet Zaborie, nuk kishte asnjë njeri me të cilin mund të fliste për pikurat, për jetën në Shën Petersburg, për verën kur Katerina jetonte me të atin në Paris dhe pa funeralin e Viktor Hygoit. Ajo nuk mund të bisedonte me Maniushkën, vajzën e fqinj, një këpucar i kolkozit, një vajzë e cila vraponte çdo ditë për të shkruar e për të marrë ujë nga pusi, të lante dyshemën, të bënte gati samovarin. Katerina i dha Maniushkës për shërbimin dorashka me rrudha, pendë struci dhe një kapelë të zezë me strehë.

"Ç'i dua këto? – pyeti Maniushka me të shpejtë dhe i nuhaste. – Unë jam një vajzë démodé, apo jo?"

"Shiti, po të duash, e dashur, – pëshpëriti Katerina, kishte një vit që po dobësohej dhe nuk fliste dot me zë të lartë. – Shiti."

"Do t'i mbaj," – vendosi Maniushka, mori gjithçka iku.

Hera-herës vinte Tihoni, roja i ndërtesës për zjarrin, kockë e lëkurë e flokëkuq. Ai mbante mend ende ardhjen e babait të Katerinës nga Shën Petersburgu, kur e ndërtoi shtëpinë, kur konfiguroi një pronë. Tihoni ishte i ri atëherë, por ai ruajti për gjithë jetën nderim për artistin e moshuar. Duke parë pikurat, ai psherëtiu me të madhe: "Puna është natyrale!"

Tihoni shpesh ishte i zënë me punët e veta, por nga që i vinte keq, e ndihmonte Katerinën për punët e shtëpisë: priste pemët e thara në kopësht, i sharronte, i çante për zjarr. Dhe sa herë largohej, ndalonte te dera dhe pyeste: "Nuk të dëgjova, Katerina Petrovna, të ka shkruar Nastja, apo jo?"

Katerina heshti, e ulur në divan, u përkul, e vogël, dhe vështroi mbi ca letra në një çantë të kuqe prej lëkure. Tihoni ndillte hundët për një kohë të gjatë, i ngulur te pragu.

"E po, mirë, – thoshte ai pa prituri përgjigjen, – Them të shkoj, Katerina Petrovna."

"Shko, Tisha, – pëshpëriti Katerina. – Shko dhe Zoti qoftë me ty!"

Ai doli duke mbyllur derën me kujdes dhe Katerina filloi të qante të heshtje. Era vërshtëllente jashtë dritareve nëpër degët e zhveshura, duke rrëzuar gjethet. Drita e qiririt dridhej në tavolinë dhe dukej e vetmja krijesë në shtëpinë e braktisur dhe pa atë zjarr të dobët nuk e dinte si do të gdhijej deri në mëngjes. Tashmë netët ishin të gjata, të rënda, si pagjumësia. Agimi vonohej gjithnjë e më shumë, gjithçka ishte e vonuar dhe rrëshqiste pa dëshirë brenda dritareve të palara, ku mes kornizave ishte një top pambuku e leshi, gjethë të verdha që nga viti i kaluar që ishin kalbur e nxirë.

Nastja, e bija e Katerinës dhe e vetmja e afërt, jetonte larg në Shën Petersburg. Herën e

# KONSTANDIN PAUSTOVSKI

## Telegrami

Tregim

Përktheu nga rusishtja: KOSTA NAKE



fundit erdhi para tre vitesh. Katerina e dinte se Nastja nuk kishte kohë të merrej me atë grua të moshuar. Ata, të rinjtë, kishin punët e tyre, interesat e tyre të pakuptueshme, lumturinë e tyre. Ishte më mirë të mos i ndërhynte. Prandaj Katerina i shkruante Nastjas shumë rrallë, edhe pse mendonte për të gjithë ditën e ulur ndanë divanit të shtypur, qetësisht si një mi, e gënjer nga qetësia, dilte shpejt që prapa stufës, qëndronte te këmbët e pasme të saj, dhe, duke lëvizur hundën, nuhaste ajrin e ndenjtur për një kohë të gjatë.

Nuk kishte letra as nga Nastja, por një herë në dy-tre muaj postieri i ri i gëzuar, Vasili, i sillte Katerinës një transfertë prej dyqind rublash. Ai ia mbante Katerinës dorën me kujdes kur firmoste, kështu që ajo të mos firmoste atje nuk nuk ishte e nevojshme. Vasili largohej dhe Katerina ulej, e hutuar, me paratë në duar. Pastaj vendoste syzet dhe rilexonte pak fjalë në urdhër porosinë. Fjalët ishin gjithmonë njëllor: kishte aq gjëra për të bërë dhe nuk kishte kohë për të ardhur, madje edhe për të shkruar letrën e tanishme.

Katerina i kalonte me kujdes kartmonedhat. Nga pleqëria ajo harronte që këto para nuk ishin aspak ato që kishin qenë në duart e Nastjas, prandaj i dukej sikur paratë mbanin erën e parfumit të bijës. Një herë, në fund të tetorit, natën, dikush trokiti për një kohë të gjatë te porta në thellësi të kopshtit që ishte rrethuar vite më parë. Katerina u shqetësua, lidhi një shami të ngrohtë rreth kokës, veshi një pale çizme të vjetra dhe doli nga shtëpia për herë të parë atë vit. Eci ngadalë duke kërkuar rrugën me duar. Ajri i ftohtë i dha dhimbje koke. Yje të harruar shikonin tokën të drithëruar. Gjetet e rëna e pengonin për të ecur. Te porta Katerina pyeti qetësisht: "Kush troket?"

Por askush nuk u përgjigj prapa gardhit. "Do më kenë bërë veshët," – tha Katerina duke u kthyer në shtëpi. U mbush me frymë, ndaloi te një pemë e vjetër, vendosi duart te dega e ftohtë dhe e lagur dhe e njohu: ishte panjë. Ajo e kishte mbjellë shumë kohë më parë kur ishte ende një vajzë e gëzuar dhe tani qëndronte duke u sjellë përqark në të ftohtë dhe nuk kishte se ku të shkonte këtë natë të pastrehë dhe me erë. Katerinës i erdhi keq për panjën, e preku trungun e ashpër, u fut në shtëpi dhe i shkroi një letër Nastjas po atë natë.

"E paçmueshmja ime, – i shkroi ajo. – Nuk do t'ia hedh dot këtij dimri. Eja të paktën për një ditë. Të të shoh, të kap duart e tua. Jam plakur e dobësuar deri në atë pikë sa e kam të vështirë jo vetëm të ec, por edhe të ulem e të rri shtrirë, vdekja e ka harruar rrugën për këtu. Kopshti po thahet, punë e madhe, nuk mund ta shoh. Tani është një vjeshtë e keqe, kaq e vështirë. Tërë jetën nuk më është dukur vjeshta kaq e gjatë."

Maniushka, duke ndjellë hundët, e çoi letrën në postë, e futi në kuti dhe pa brenda. "Ç'ka atje?" Po brenda nuk kish asgjë për të parë, vetëm një zbrazëti e vogël.

Nastja punonte si sekretare në lidhjen e artistëve. Punë kishte shumë, organizimi i ekspozitave, i konkurseve, të gjitha kalonin përmes duarve të saj. Nastja e mori letrën e Katerinës të shërbimi. E futi atë në kuletën e vet pa e lexuar, vendosi ta lexonte pas pune. Letra e së ëmës i shkaktoi Nastjas një psherëtimë lehtësimi: nëse e ëma i shkruante, do të thoshte se ishte gjallë. Por në të njëjtën kohë filloi të ndiejë një shqetësim të thellë, sikur çdo letër ishte një qortim i heshtur.

Pas pune Nastja duhej të shkonte në studion e skulptorit të ri Timofejev për ta parë si jetonte që të raportonte në bordin e lidhjes. Timofejevi u ankua për të ftohtin e studios, në përgjithësi ajo ishte e shkatërruar dhe nuk lejohej ta ndryshonin. Në një nga sheshet Nastja nxori një pasqyrë, u pudros, bëri grimin dhe i pëlqeu vetja. Artistët e quanin atë Solveig për shkak të flokëve kafe dhe syve të mëdhenj e të ftohtë.

E hapi vetë Timofejevi, i vogël, i vendosur, i zemëruar. Ai kishte veshur një pallto, kishte mbështjellë një shall rreth qafës dhe Nastja vuri re që kishte çizme grash.

"Mos i hiq rrobat, – murmuriti Timofejevi, – se do të ngrish. Eja, të lutem!"

Ai e udhëhoqi Nastjan përgjatë korridorit të errët, u ngjit disa hapa dhe hapi derën e ngushtë të studios. Mbante erë shkumë. Në dyshemë pranë fuçisë me argjil të lagur digjej një qiri. Mbi mbajtëse kishte skulptura të mbuluara me rraqe të njoma. Jashtë dritares së gjerë fluturonte pjerrtazi dëbora, dhe duke rënë mbi Nevën e mbuluar me mjegull, shkrinte në ujën e errët. Era vërshtëllente në korniza dhe trazonte gazetën e vjetra në dyshemë.

"O Zot, sa ftohtë!" – tha Nastja dhe iu duk sikur ishte më ftohtë në studio nga basorelievet me mermer të bardhë që vareshin pa rregull në mure.

"Ja, uluni! – tha Timofejevi duke shtyrë një karrige me njolla argjili për Nastjan. – Nuk e di si nuk kam vdekur ende në këtë strofull. Kurse në studion e Pershinit kaloriferët lëshojnë ngrohtësi si në Saharë."

"Nuk të pëlqen Pershini?" – pyeti Nastja me kujdes.

"Ç'e pyet! – tha Timofejevi me zemërim. – Artizan! Figurat e tij nuk kanë shpatulla, por varëse palltoesh. Kolkoziania është një grua prej guri me një përparësi si mbështjellëse. Punëtori i tij duket si njeriu i Neandertalit. Ai gdhend me një daltë druri. Dhe dinak, e dashur, dinak si një kardinal!"

"Ma trego Gogolin tënd," – i tha Nastja për të ndërruar bisedë.

"Shko! – e urdhëroi skulptori i ngrysur. – Jo, jo atje. Te ajo qoshja. Ashtu!"

Ai largoi nga një prej figurave mbulesën e lagur, e kontrolloi me kujdes nga të gjitha anët, u ul në bisht afër qiririt dhe duke ngrohur duart, tha:

"Ja, ky është Nikollaj Vasilieviçi! Tani të lutem!"

Nastja u drodh. Me ngërdheshje, duke e njohur mirë atë, një njeri hundëmprehtë, i përkulur, e vështroi atë. Nastja pa një venë të hollë sklerotike që rrihte në tëmthin e tij.

"Letra në kuletë është e pahapur, – dukej sikur thoshin e sytë zhbirues të Gogolit. – Ah, ti laraskë!"

"Mirë? – pyeti Timofejevi. – Një xhaxho interesant, apo jo?"

"E mrekuullueshme, – u përgjigj Nastja me vështirësi, – është vërtet e shkëlqyer."

Timofejevi qeshi hidhur.

"E shkëlqyer, – përsëriti ai. – Të gjithë thonë "e shkëlqyer." Edhe Pershini edhe Matjashçi, edhe tërë llojet e ekspertëve nga tërë llojet e komitetëve. E pastaj? Këtu është e shkëlqyera, kurse atje ku vendoset fati im si skulptor, atje i njëjti Pershin qesëndiset në mënyrë të papërcaktuar. Qesëndiset Pershini dhe kjo do të thotë fundi. Natën nuk fle! – e ngriti i zërin Timofejevi dhe shkoi nëpër studio duke tundur këmbët. – Reumatizëm në duar nga argjila e lagur. Për tre vjet lexova çdo fjalë për

Gogolin."

Timofejevi ngriti një pìrg me libra nga tavolina, i tundi në ajër dhe i flaku prapa me forcë. Pluhuri i allçisë fluturoi nga tavolina.

"Kjo është e gjitha për Gogolin! – tha ai dhe befasi u qetësua. E çfarë? Më duket se të frikësova? Më falni, e dashur, po, për Zotin, jam gati të luftoj."

"Mirë, le të luftojmë së bashku," – tha Nastja dhe u ngrit.

Timofejevi ia shtrëngoi dorën fort dhe ajo u largua me një vendosmëri të patundur ta mbrojtë këtë njeri të talentuar nga errësira.

Nastja u rikthye në lidhjen e artistëve, shkoi te kryetari dhe bisedoi me të gjatë, argumentoi me zjarr që ishte e nevojshme të rregullohej menjëherë ekspozita e punëve të Timofejevit. Kryetari e trokiste lapsin në tavolinë, u mendua një copë herë dhe më në fund pranoi. Nastja u kthye në shtëpi, në dhomën e saj të vjetër te Mojka, me tavan të ngjitur me stuko dhe vetëm atëherë e lexoi letrën e së ëmës.

"Ku të shkoj atje tani! – tha jo dhe u ngrit. – A mund të dal që këtej, vallë!"

Mendoi për trenat me turma njerëzish, ndryshimin e shinave të ngushta, karrocën që të shkud, kopshtin e tharë, lotët e pashmangshme të nënës, këmbënguljen, mërzhinë pa drita në fshat dhe e futi letrën në sirtarin e tavolinës. Për dy javë Nastja u mor me organizimin e ekspozitës së Timofejevit. Disa here gjatë kësaj kohe ajo u grind dhe u pajtua me skulptorin që s'gjente rehat. Timofejevi i dërgoi punët e veta në ekspozitë sikur po i dorëzonte për t'i shkatërruar.

"Ti nuk do të jesh në gjendje të djallosësh gjë, e dashur, – i tha Nastjas në ekstazë, sikur ajo po e rregullonte jo për atë, po për ekspozitën e vet. – Po humbas kohën kot, për fjalë të nderit."

Në fillim Nastja u dëshpërua dhe fye, derisa e kuptoi që gjithë këto trille vinin nga krenaria e plagosur që ata ia kishin prekur dhe thellë në zemër Timofejevi ishte shumë i lumtur rreth ekspozitës së ardhshme. Ekspozita u hap në mbrëmje. Timofejevi ishte i zemëruar dhe tha se ishte e pamundur të shikoje skulpturat me dritë elektrike.

"Dritë e ngordhur! – protestoi ai. Mërzivrastare! Vajguri është më i mirë."

"Çfarë lloj drite dëshiron ti, o tip i çuditshëm!" – shpërtheu Nastja.

"Duhen qirinj! Qirinj! – bërtiti Timofejevi me vuarje. – Si mund ta vendosësh Gogolin nën një llampë elektrike? Absurde!"

Në ceremoninë e hapjes kishte skulptorë dhe piktorë. Po të ishte pa përvojë, duke dëgjuar bisedat e skulptorëve, nuk e merrje me mend i lavdëronin apo i shanin punët e Timofejevit. Por Timofejevi e kuptoi se ekspozita ishte një sukses. Një piktor flokëthinjur e me temperament të zjarrtë shkoi te Nastja dhe ia përkëdheli duart.

"Të falenderoj. Dëgjova që ishte ti që e solle Timofejevin në dritën e Zotit. E ke bërë shkëlqyer. Nga ana tjetër, ti e di, kemi shumë njerëz që flasin për vëmendjen ndaj artistit, për kujdesin dhe ndjeshmërinë, po kur vjen puna, ngec në sy të zbrazët. Edhe një herë faleminderit!"

Filloi diskutimi. Folën shumë, e lavdëruan, u emocionuan dhe ideja e hedhur nga piktori i moshuar për vëmendjen ndaj një personi, ndaj një skulptori të ri të harruar padrejtësisht, u përsërit në çdo diskutim. Timofejevi rrinte ulur i pakënaqur, duke vështruar parketin, por me bisht të syrit u hidhte vështrime folësve, pa ditur nëse mund t'u besonte apo ishte ende

shumë herët.

Te dera u shfaq një korriere nga lidhja, Dasha e mirë dhe e pajalë. Ajo i bëri ca shenja Nastjas. Nastja shkoi tek ajo dhe Dasha duke buzëqeshur i dha një telegram. Nastja u kthye në vendin e saj, e hapi e pashqetësuar telegramin, e lexoi dhe nuk kuptoi asgjë: “Katja po vdes. Tihoni.”

“Cila Kate? – mendoi Nastja e hutuar. Cili Tihoni? Do të të jetë gabim, nuk është për mua.”

E pa adresën, jo, telegram ishte për të. Vetëm atëherë vuri re shkronjat e vogla të shtypura në shiritin e letrës: Zaborie. Nastja e zhubrosi telegramin dhe u vrenjt.

Foli i pari.

“Tani, - tha ai duke u lëkundur dhe duke mbajtur syzet, - kujdesi për një njeri po bëhet një realitet i bukur që na ndihmon të rritemi dhe të punojmë. Jam i lumtur të shoh në mjedisin tonë, mes skulptorëve dhe piktorëve manifestimin e këtij kujdesi. E kam fjalën për ekspozitën me punët e shokut Timofejev. Ne i detyrohemi për këtë ekspozitë, dhe s’ka asnjë shkelje në menaxhimin tonë, një nga nëpunëset e zakonshme të lidhjes, të dashurën tonë, Anastasia Semjonovna.”

Pershini iu përkul Nastjas dhe të gjithë duartrokitën. Duartrokitën gjatë. Nastja u emocionua deri në lotë. Dikush e preku krahnun e saj nga prapa. Ishte një piktor i vjetër zemërak.

“Si është puna? – pëshpëriti ai dhe tregoi me sy telegramin e zhubrosur në dorën e saj. – Ka ndonjë gjë të pakëndshme?”

“Jo, - u përgjigj Nastja. – Ashtu. Nga një prej të njohurve të mi...”

“A-ha!” – murmuriti plaku dhe filloi të dëgjojë përsëri Pershinin.

Të gjithë shikonin Pershinin, por Nastja ndiente gjithë kohën vështrimin e dikujt, të rëndë dhe këmbëngulës dhe nguronte ta ngrinte kokën.

“Kush mund të jetë? – mendoi ajo. E gjen dot, vallë? Sa budalla. M’i cingërisi nervat përsëri.”

Bëri një përpjekje, ngriti sytë dhe menjëherë i largoi: Gogoli po e shikonte atë duke buzëqeshur. Dukej sikur një venë e hollë sklerotike po rrihte fort në tëmthin e tij. Nastjas iu duk sikur Gogoli i tha qetësisht përmes dhëmbëve të shtrënguar: “Hë-ë, ti!”

Nastja u ngrit menjëherë, doli jashtë, u vesh me nxitim duke zbritur dhe doli në rrugë.

Ra llohë. Në katedralen e Shën Isakut u shfaq mjegulla gri. Qielli i errët po fundosej poshtë e më poshtë mbi qytet, mbi Nastjan, mbi Nevën.

“E papara ime,” - u kujtua Nastja për letrën. – E papara!”

U ul në një stol në park pranë Admirialitit dhe qau me hidhërim. Dëborë tretej në fytyrën e saj e përzier me lotët. Ajo u drodh nga e ftohta dhe befasi e kuptoi se askush nuk e donte atë aq sa ajo gruaja e moshuar dhe e braktisur atje, në Zaborien e mërzitshme.

“Vonë! Nuk do ta shoh më mamin tim, - tha me vete dhe iu kujtua që para më shumë se një viti ia kishte thënë këtë fjalë të ëmbël fëminore “mami” për herë të parë. U hodh përpjetë, shkoi me nxitim përballë dëborës që ia fshikullonte fytyrën.

“Ç’është kështu, o mami? Ç’është? – mendoi ajo pa folur. – Mami! Si mund të ndodhë kështu? Aq më tepër për mua që s’kam njeri tjetër në këtë jetë. Nuk ka dhe nuk do të ketë më të dashur. Vetëm po të arrija në kohë, vetëm nëse mund të më shihnte, ajo do të më falte.”

Nastja shkoi te “Nevski Prospekt”, te stacioni hekurudhor i qytetit. Ishte vonë. Nuk kishte më bileta. Nastja qëndroi pranë sportelit, buzët i dridheshin, nuk fliste dot duke e ndier që me fjalën e parë do shpërthente në lot. Shitësja e vjetër me gjyslykë e biletave vështronte jashtë sportelit.

“Si e ke punën, qytetare?” – pyeti e pakënaqur.

“Asgjë, - u përgjigj Nastja. Nën ime...” Nastja u kthye dhe shkoi me nxitim drejt daljes.

“Ku vete? – i bërtiti sportelistja. – Duhej të ma kishte thënë menjëherë. Prit një minutë.”

Nastja u nis që atë mbrëmje. Gjithë rrugës i dukej sikur lokomotiva “Shigjeta e Kuqe” mezi zvarritej ndërsa treni vraponte me shpejtësi përmes pyjeve të natës duke lëshuar avull mbi ta dhe duke klithur me një fshkëllimë të gjatë paralajmëruese...

Tihoni erdhi te posta, i pëshpëriti postierit

Vasil, mori telegramin prej tij, e ktheu nga ana tjetër dhe për një kohë të gjatë, duke fshirë mustaqet me mëngë, shkroi diçka në formularin me shkronja të ngathëta. Pastaj e palosi me kujdes formularin, e futi në kapën e vet dhe eci me mundim drejt Katerina Petrovnës.

Katerina nuk ishte ngritur prej dhjetë ditësh. Nuk i dhimbte asgjë, por një dobësi zalisëse ia shtypte gjoksin, kokën, këmbët dhe mezi merrte frymë. Maniushka nuk u largua prej saj për gjashtë ditë. Natën, pa u zhveshur, ajo flinte në divan. Ndonjëherë Maniushkës i dukej sikur Katerina nuk merrte frymë. Atëherë ajo fillonte të qaravitej nga frika dhe i thoshte: “Gjallë je?” Katerina lëvizte dorën nën kuvertë dhe Maniushka qetësohej.

Në dhomë që herët në mëngjes nëpër qoshe qëndronte errësira e nëntorit, por ishte ngrohtë. Maniushka e ndizte stufën. Kur zjarri bubullitës ndriçonte muret e dhomës, Katerina Petrovna psherëtinte e lehtësuar, zjarri e bënte shtëpinë të rehatshme, të jetueshme, siç kishte qenë kohë më parë, në kohën e Nastjas. Katerina mbylli sytë, një lot i

vetëm u rrokullis prej tyre dhe rrëshqiti poshtë tëmthit të verdhë, i ngatërruar në flokët e thinjur.

Tihoni erdhi. U kollit, shfryu hundët dhe dukej i shqetësuar.

“Ç’është, Tisha?” – pyeti pa forcë Katerina. “Po ftohet më shumë, Katerina Petrovna! – tha Tihoni me gëzim dhe shkoi i shqetësuar kapën e vet. - Do të bjerë dëborë së shpejti. Është për mirë. Nëse rruga forcohet nga ngrica, do të jetë më mirë për të udhëtuar.”


“Për kë?” – tha Katerina, hapi sytë dhe me dorën e thatë filloi të godiste kuvertën me dëshpërim.

“Për kë tjetër përveç Anastasia Semionovnës, - u përgjigj Tihoni, buzëqeshi me humor dhe nxori telegramin nga kapa. – Nga kush tjetër veç saj?”

Katerina dhe donte të ngrihej, por nuk mundi dhe ra mbi jastëk përsëri.

“Ja!” – tha Tihoni dhe me kujdes shpalosi telegramin dhe ia zgjati Katerinës. Por ajo nuk e mori, megjithatë e pa Tihonin e emocionuar.

“Lexoja, - i tha Maniushka ashpër. – Gjyshja nuk mund të lexojë më. I janë dobësuar sytë.”



## MARLEN DIETRICH NË GJUNJË PARA K. PAUSTOVSKIT

Një nga fotot e famshme të Marlen Dietrich mban datën 13 qershor 1964. Aty, këngëtarja që vinte nga Shtetet e Bashkuara, ulet në gjunjë në mes të skenës dhe i puth duart shkrimtarit sovjetik Konstantin Paustovski. Kjo ngjarje e çuditshme ndodhi gjatë turneut të divës hollivudiane në Bashkimin Sovjetik. Po përse krenarja Marlene Dietrich u ul në gjunjë para Paustovskit, lavdia e të cilit nuk i kishte kapërcyer kufijtë e vendit?

Në aeroportin e Moskës, divën e priti një armatë gazetarësh. Përveç të tjerash, Marlenën e pyetën se çfarë do të dëshironte të shihte në kryeqytet – natyrisht, Sheshin e Kuq, Kremlinin dhe Mauzoleumin? Përgjigjja e Marlenës i la pa gojë të gjithë.

“Dikur kam lexuar tregimin ‘Telegrami’ të Paustovskit. Aq mbresë më ka lënë sa nuk e kam harruar dot, as tregimin, as emrin e shkrimtarit, të cilin s’e kisha dëgjuar kurrë. Nuk kam mundur të gjej libra të tjerë të këtij shkrimtari të mrekullueshëm. Dhe ja pyeta për Paustovskën”, - foli më në fund Marlene.

Tregimin “Telegrami” aktorja e kishte gjetur në një përmbledhje letrare. Paustovski kishte shkruar për një vajzë, e ardhur në një qytet të madh nga një fshati i humbur, e cila harroi nënën e dashur dhe nuk mundi të përhëndetej. Kjo histori prekëse e kishte mallëngjyer Marlene-n dhe që nga ajo ditë, Paustovski u bë shkrimtari i saj i dashur.

Në këtë kohë Paustovski ishte 72 vjeç. Kishte pësuar disa infarkte, vuante nga astma dhe sapo kishte dalë nga spitali. Megjithatë, Paustovski dëshironte aq shumë të shkente në koncert, ndaj erdhi në shtëpinë e shkrimtarëve moskovitë, i shoqëruar nga e shoqja dhe mjeku. Pas koncertit i kërkuan shkrimtarit të ngjitej në skenë. Reagimi i aktorese dhe këngëtarese së famshme, kur pa idhullin e saj, ishte i mahnitshëm; ylli hollivudian, veshur me një fustan madhështor, u ul në gjunjë dhe i puthi atij dorën.

“Isha kaq e tronditur me praninë e tij. Ngaqë nuk mundja të thosha një fjalë rusisht, nuk gjeta mënyrë tjetër të tregoja admirimin tim, përveçse të ulesha në gjunjë para tij”, - u shpreh Marlene.

Fustani i ngushtë u shqye tek tegelat, diamantet u shpërndanë nëpër skenë, por aktorja s’deshi t’ia dinte. Në sallë plakosi heshtja. Paustovskit iu pre goja. Më në fund shkrimtari erdhi në vete, u përkul dhe i puthi divës dorën. Ngërçi u kalua, spektatorët duartrokitën në këmbë.

Marlene kishte kaluar një fëmijëri fatkeqe. I ati kishte rënë në luftën e parë botërore, nënën e kujtonte si një grua të ftohtë, që dinte të jepte veç urdhra dhe komanda. Ishte krejt e kundërta e gruas që kishte përshkruar Paustovski, nënës që kishte ëndërruar vetë aktorja. Sepse ajo, ashtu si heroina e tregimit “Telegrami”, natyrisht e kishte përjetuar thellë. Kjo e kishte shtyrë që të bënte atë veprim dhe rezultati, ja, është kjo fotografi. Probleme edhe me të mëdha pati Marlene edhe me të bijtë e saj, Maria Riva. Ajo e urrente të ëmën dhe për këtë ka shkruar në detaje në librin e saj, ku e quan Marlenën “egoiste, e alkoolizuar dhe thjesht një përbindësh”. Marlen Dietrich vdiq në vitin 1992 nga infarkti, që pësoi, siç thonë, sapo doli në dritë libri me kujtime i të bijës.

Tihoni e shikoi me frikë, çliroi jakën, lëmoi flokët e kuq e të rrallë dhe lexoi me zë të mbytur e të pavendosur: “Prit, po vij. Mbetem gjithmonë bija jote e dashur, Nastja.”

“Nuk duhet, Tisha! – tha Katerina qetësisht. – Nuk duhet, e dashur. Zoti qoftë me ty. Faleminderit për fjalët e mira, për dhembshurinë tënde.”

Katerina u kthye nga muri me vështrësi, pastaj u duk sikur e zuri gjumi. Tihoni u ul në stol në korridorin e ftohtë, duke pirë duhan kokëulur, duke pështrë e psherëtirë, derisa Maniushka doli dhe i bëri shenjë për Katerinën brenda në dhomë. Tihoni hyri në majat e gishtave dhe fshiu fytyrën me pëllëmbë. Katerina shtrihet e zbehtë dhe e vogël sikur kishte rënë në gjumë paqesisht.

“Nuk duhet prituri, - murmuriti Tihoni. – Oh, dhimbja e saj e hidhur, vuajtja e saj e pashkruar! Shiko, ti budallaqe, - i tha me zemërim Maniushkës. - Të mirën shpërbleje me të mirë, mos u bëj gjeraninë. Ulu këtu se unë do të shkoj me vrap në këshillin e fshatit dhe do të njoftoj.”

Ai iku dhe Maniushka u ul në karrige, me gjunjët të mbledhur, duke u dridhur dhe pa parë nga Katerina.

Katerinën e varrosën të nesërmen. Ishte ngricë. Binin flokë të imët dëborë. Dita u zbardh dhe qielli ishte i thatë, i ndritshëm, por gri, si një kanavacë e larë dhe e ngrirë e shtrirë mbi kokën e tij. Shelgjet përgjatë lumit mbetën blu. Ata ruajtën aromën e athët e të gëzuar të dëborës të kapura nga ngrica e parë.

Të moshuar dhe djem u mblodhën për funeralin. Arkivoli u mbart për në varreza nga Tihoni, Vasili dhe vëllezërit Maljavin. Maniushka dhe vëllai i saj Vollojda mbanin kapakun e arkivolit dhe shikonin përpara pa e pasur mendjen. Varreza ishte prapa fshatit, mbi lumë. Shelgjet e gjatë, të zverdhur nga likenet, rriteshin në të. Gjatë rrugës takuan mësuesen. Ajo sapo kishte ardhur nga qyteti dhe nuk njihje ende njeri në Zaborie.

“Po vjen mësuesja, mësuesja!” – pëshpërisnin djemtë.

Mësuesja ishte një vajzë e re, e ndruajtur, me sy gri. Ajo e pa kortezhin dhe ndaloi e tronditur, pastaj pa e frikësuar xhenazën në arkivol. Mbi fytyrën e të vdekurës binin dhe nuk shkrinin flokët e dëborës. Atje, në qytet, mësuesja la nënën e vet, po aq të vogël, gjithnjë e shqetësuar për të bijën dhe krejt e thinjur po ashtu. Mësuesja qëndroi dhe ngadalë shkoi pas kortezhit. Plakat e shikonin atë dhe pëshpëritnin që ja, ishte aq vajzë e qetë prandaj do ta kishte të vështirë në fillim me djemtë në Zaborie që ishin shumë të pavarur dhe të djallëzuar. Mësuesja më në fund e ndau mendjen dhe pyeti një nga gratë e moshuara, gjyshen e Matrjonës.

“Kjo zonjë e moshuar duhet të ketë qenë e vetme?”

“Dhe pastaj, e dashur, - ia ktheu sakaq me këngëzim Matrjona. - Pothuaj krejt e vetme. Dhe ishte aq e sinqertë, aq zemërmirë. Gjithnjë ndodhte që ulëj e ulej e vetme në divanin e saj, pa patur me kë të këmbëj një fjalë. Sa gjynah! Ajo ka një çupë në Shën Petersburg dhe, siç duket, fluturon lart. Ajo vdiq pa njeri, pa të afërm.”

Në varreza e vendosën arkivolin pranë varrit të porsahapur. Gratë u përkulën mbi arkivol dhe prekën dheun me duart e tyre të errëta. Mësuesja shkoi te arkivoli, u përkul dhe ia puthi Katerinës dorën e thatë e të verdhë. Pastaj drejtoi trupin shpejt, u kthye dhe shkoi drejt çakëllit prej qerpiçi që ishte rrënuar. Prapa çakëllit, në dëborën e lehtë si pendë shtrihet toka e dashur dhe pak e trishtë. Mësuesja vështronte për një copë herë, dëgjoji të moshuarit që flisnin prapa saj, dheun që trokiste mbi kapakun e arkivolit dhe këndezaat që këndonin larg në oborre, duke paralajmëruar ditë të kthjellta, ngrica të lehta, dimër të heshtur.

Nastja arriti në Zaborie ditën e dytë pas funeralit. Ajo gjeti tumën e freskët në varreza, sheshin me copat e ngrira dhe dhomën e errët e të ftohtë të së ëmës, prej së cilës jeta dukej që kishte ikur kohë më parë. Në atë dhomë Nastja qau gjithë natën, derisa jashtë dritareve agimi i rëndë u kthye në blu.

Nastja iku nga Zaboria vjedhurazi, duke u përpjekur të mos e shikonte dhe mos e pyeste njeri. I dukej se askush veç së ëmës nuk mund ta lehtësonte nga faji i pariparueshëm i saj, nga barra e padurueshme e tij.

Është një gëzim i madh për mua të jem në Frankfurt, ku protagonistin Ka në "Bora", një nga romanet e mia, kalon pesëmbëdhjetë vitet e tij të fundit. Ka është turk. Ai nuk ka lidhje gjaku me Kafkën, por një lidhje farefisnore letrare. Do t'i kthehem farefisnisë letrare pas pak. Emri i vërtetë i Ka-së është Kerim Alakuşoğlu, por duke qenë se atij nuk i pëlqen emri, preferon shkurtjesën. Ai erdhi në Frankfurt për arsye politike në fillim të viteve 1980. Në thelb, ai nuk është i interesuar për politikë; madje nuk e pëlqen fare. Ajo që i intereson atij është poezia. Heroi i romanit tim është pra një poet që jeton në Frankfurt. Në Turqi, po fajn e tij, ai është bërë një viktimitë politike. Nëse premtim koha, edhe unë sot dua të them disa fjalë për politikën si një aksident. Ka shumë për të thënë. Por mos u shqetësoni: romanet e mia janë të gjata, por fjalimi im do të jetë i shkurtër.

Për të dhënë një përshkrim deri dikund të besueshëm të Frankfurtit të viteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990 në romanin tim, ku Ka-ja ka kaluar vitet e fundit të jetës së tij, unë vizitova qytetin pesë vjet më parë, në vitin 2000. Dy persona që janë me ne sot këtu më ndihmuan shumë atë kohë dhe ishin ata që më çuan në parkun e vogël afër Gutleutstrasse, pas ndërtesave të vjetra të fabrikës ku hero i romanit kaloi vitet e tij të fundit. Për të krijuar një ide sesi shkollonte Ka çdo mëngjes nga banesa e tij në bibliotekën e qytetit, ku qëndronte pastaj për disa orë, ne ecëm nga sheshi i stacionit përgjatë Kaiserstrasse, kaluam dyqanet pornografike atje, frutoret turke, standat e qebapave dhe sallonet e berberëve në Münchenerstrasse deri në Hauptwache; kaluam edhe kah kisha ku jemi ulur tani. Hymë në Kaufhof, ku Ka-ja kishte blerë pallton e tij, për të cilën ishte aq i lumtur dhe krenar dhe e përdorte për vite me radhë. Gjatë dy ditëve vizituam lagjet e vjetra, të varfra ku jetojnë turqit, xhamitë, qebapshitësit, shoqatat dhe kafenetë turke. Ky ishte romani im i shtatë, por mbaj mend që sillsha pothuajse si një fillestar i shqetësuar aë është në procesin e shkrimit të veprës së tij të parë, duke ecur me një bllok shënimesh dhe duke bërë pyetje të panevojshme të detajuara, si "a kalonte tramvaji në këtë cep në vitet 1980" ...

Të njëjtën gjë bëja në qytetin e vogël të Karsit në Turqinë verilindore, ku zhvillohet romani im - një vend për të cilin dija shumë pak. Kam bërë udhëtime të panumërta atje për t'u njohur me mjedisin; bëra miq dhe njoha qytetin rrugë më rrugë, dyqan më dyqan. Shkova në lagjet më të vetmuara dhe më të harruara të qytetit më të vetmuar dhe më të harruar të Turqisë dhe fola me të papunët që mbushnin kafenetë dhe që nuk kishin as më të voglën shpresë për të gjetur një punë, me nxënës të shkollave të mesme, me policë civilë apo me uniformë që më ndiqnin gjatë gjithë kohës dhe me redaktorët e gazetave, tirazhi i të cilëve nuk kalonte kurrë 250 kopje.

Nuk po i përmend të gjitha këto tani për t'ju treguar se si e kam shkruar romanin "Bora". E them këtë për të arritur te një çështje që ka të bëjë me artin e romanit, për të cilën po ndërgjegjësohem çdo ditë e më shumë: riformulimi i "tjetrit", "të huajit", "antagonistit" që ekziston në mendimet tona. Romanet shkruhen natyrisht për të treguar për njerëzit - për t'i imagjinuar ata në situata që, për mirë ose për keq, na kujtojnë situatat në të cilat jetojmë dhe i njohim vetë. Ajo çfarë duam nga një roman është, para së gjithash, të na tregoj për dikë të ngjashëm me ne, madje të na tregoj edhe për veten tonë. Ne tregojmë për një nënë, një baba ose një familje të ngjashme me tonën, një shtëpi me ngjashme me tonën ose diçka të ngjashme me rrugën tonë, një qytet të njohur ose vendin që njohim më mirë. Por ligjet e çuditshme dhe magjike të romanit transformojnë për një çast familjen, shtëpinë dhe qytetin tonë në diçka që mund t'i përkasë kujtdo. Shpesh është thënë se "Buddenbrooks" është një roman autobiografik i maskuar hollë. Por kur e lexova në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, e interpretova jo aq shumë si histori familjare të një autori të panjohur, por si një histori të përgjithshme familjare me të cilën mund të identifikohesh lehtësisht. Me anë të mekanizmave fantastikë të romanit, ne mund t'ia paraqesim historinë tonë mbarë njerëzimit si histori e dikujt tjetër.

# ORHAN PAMUK

## Karsi dhe Frankfurti

Përktheu: Qerim Raqi

Arti i romanit është, natyrisht, arti i të treguarit të historisë sonë sikur të ishte historia e të gjithëve. Por kjo është vetëm njëra anë e këtij arti të madh, i cili për katërqind vjet me gjithë fuqinë e tij, i mbajti lexuesit në tundim dhe i bëri autorët të trulloseshin nga kënaqësia. Ana tjetër e çështjes është ajo që më solli në rrugët e Frankfurtit dhe Karsit: Mundësia për të shkruar historinë e të tjerëve si tonën. Pra, ajo që ne përpiqemi të bëjmë është, që me ndihmën e romaneve të shkruara mirë, të zgjerojmë së pari kufijtë e të tjerëve, pastaj kufijtë tanë.

Të tjerët bëhen "ne" dhe ne "tjetri". E gjithë kjo ndodh njëkohësisht në roman; ne kemi mundësinë që në të njëjtën kohë të përshkruajmë pjesërisht jetën tonë si jetën e dikujt tjetër, pjesërisht ta portretizojmë jetën e të tjerëve si jetën tonë. Në fakt është edhe krejtësisht e panevojshme të shkosh nëpër rrugë dhe qytete të tjera, siç bëra në "Bora". Shumica e romancierëve mbështeten në imagjinatën e tyre për ta bërë veten dikë tjetër dhe për të shkruar për të tjerët sikur të ishin vetvetja. Për të shpjeguar më mirë atë çfarë dua të them, do të përdor shembullin e mëposhtëm për të zhvilluar idenë e lidhjes farefisnore letrare: "Çfarë do të ndodhte nëse do zgjohesh një mëngjes dhe të zbuloja se isha një kacabu gjigant?" Pas të gjitha romaneve të mëdha, besoj, qëndron një shkrimtar që ka dëshirën të ekspozohet në formën e dikujt tjetër, një krijim për të shtyrë kufijtë e tij. Të imagjinosh se sa të neveritur dhe të frikësuar do të ishin të tjerët në shtëpi, nëse një mëngjes do të rrotulloheshe rreth mureve dhe tavanit si një kacabu gjigant dhe sesi prindërit do të të gjuanin mollët, nuk të ndihmon të fillosh të hulumtosh insetekt, por duhet të bëhesh Kafkë dhe ..., ndoshta duhet paksa kërkim megjithatë, para se të vendosim veten në vendin e dikujt tjetër. Gjëja kryesore për të cilën duhet të mendojmë në këtë kontekst është: Kush është ky "tjetri" për të cilin duhet të krijojmë një imazh?

Ky person është ndryshe nga ne dhe apelon tek instinktet tona më primitive - reagimet reflektive si ikja, sulmi, neveria dhe frika. Ne e dimë se këto reagime mund të vënë në lëvizje imagjinatën dhe shkrimin. Me rregullat e artit që duhet të ndjekë, "romancier i" kupton se identifikimi me këtë "tjetrin" do të sjellë diçka pozitive. Ai e di se përpjekja për të menduar në kundërshtim me atë që të gjithë të tjerët besojnë dhe mendojnë do ta lirojë atë. Historia e romanit mund të shkruhet si histori e vendosjes së vetes në vendin e dikujt tjetër dhe përdorimit të imagjinatës për të transformuar dhe çliruar veten.

"Robinson Crusoe" është sa një histori për skllavin e Premte, aq edhe për vetë Robinsonin. "Don Kishoti" është po aq një roman për shërbëtorin Sanço Panço si një kalorës i humbur në botën e librave. Romanin më brilant të Tolstoit, "Anna Karenina", preferoj ta lexoj si një roman në të cilin një burrë i martuar lumturisht imagjionon një grua që rrënon martesën e pakënaqur në të cilën jeton. Tolstoi mësoi nga një tjetër shkrimtar mashkull, Floberti, i cili, megjithëse vetë nuk ishte martuar kurrë, u përpoq të krijonte një imazh të të palumturës zonjës Bovary. Klasiku i parë i madh alegorik i romanit modern, "Moby Dick" i Melvilles, është një libër që, përmes historisë së një balene të bardhë, ilustron frikën nga e pazakonta dhe e devijuara në Amerikën e asaj kohe. Ne adhuruesit e letërsisë sot nuk mund ta imagjinojmë Jugun Amerikan pa imazhin e zezakëve që dikur u dha Faulkneri. Në të njëjtën mënyrë mendojmë se diçka mungon në veprën e një romancierit gjerman, i cili ka ambicje t'i japë zë gjithë Gjermanisë, por që nuk flet, haptas apo fshehurazi, për turqit apo shqetësimet që i rrethojnë. Nga ana

ime, ndjej se diçka i mungon një romancier bashkëkohor turk, i cili nuk shtret për kurdët dhe minoritetet tjera apo elementet e errëta në historinë për të cilën nuk ju lejohet të flisni.

Politika e një romancierit nuk ka asnjë lidhje, siç besojnë disa, me mënyrën se si ai angazhohet në çështje politike ose në cilat shoqata, parti apo grupe bën pjesë. Politika e romancierit i ka rrënjët në aftësinë e tij për të fantazuar dhe për ta vënë veten në situatën e dikujt tjetër. Në sajë të kësaj aftësie, ai bëhet jo vetëm një person që zbulon rrethana njerëzore të pashprehura më parë, por edhe një zëdhënës i atyre që nuk arrijnë të dëgjohej zëri i tyre dhe zemërimin të cilëve askush nuk e vë re; ai bëhet zëdhënës i fjalës së shtypur dhe i gjërave që nuk janë folur. Romancierit nuk ka nevojë, siç më duket kur isha i ri, të ketë ndonjë dëshirë të madhe për politikë, ose mund të jetë jashtë saj për një qëllim krejtësisht tjetër ... Qëllimi i Dostojevskit me "Shpirtrat e vdekur", romani më i madh politik i të gjitha kohërave, ishte të polemizojë kundër simpaziesve rusë të perëndimëzimit dhe nihilistëve, por sot ne nuk e lexojmë kështu këtë roman; për ne ky është një libër që zbulon një sekret të madh për shpirtin e popullit sllav, për realitetin rus, një sekret që mund të zbulohet vetëm në formën e një romani. Ne nuk mund ta fitojmë këtë lloj njohurie duke lexuar gazeta dhe revista ose duke parë televizor. Këtë njohuri shumë të veçantë dhe unike, këtë njohuri shqetësuese dhe dërrmuese që na frikëson me thellësinë e saj dhe na ngatërron me gjithë thjeshtësinë e saj përmes tregimeve të historisë dhe jetës private të njerëzve dhe kombeve, e marrim duke lexuar me vëmendje e durim romanet e mëdhenj. Mund të them se, kur u ngrit tema, u ndjeva shumë pranë këtij sekretit të rrënjësor thellë në histori, këtë sekret që shpërfaqet mes poshtëritimit dhe krenarisë, mes turpit dhe zemërimit, që Shpirtat e vdekur" të Dostojevskit i pëshpëritin në vesh lexuesit. Pas kësaj ndjenje afërsie qëndron - do të doja të thoja - dashuri-urrejtja dhe tensioni mendor i një shkrimtari që ndodhet mes dy botëve dhe që pa qenë vetë perëndimor megjithatë është mahnitur nga shkëlqimi i qytetëritimit perëndimor.

Pra, tani arritëm në çështjen "Lindje dhe Perëndim".

Duke marrë parasysh se si disa organe të shtypit në Perëndim e interpretojnë sot shprehjen "Lindje dhe Perëndim", mendoj se gjëja më e mirë ndoshta do të ishte të mos them asgjë, ndërsa gazetarët të ngrënë këtë çështje shumë të pëlqyeshme për ta. Sepse në shumicën e rasteve, perceptimi është se vendet e varfëra të Lindjes nuk janë të përgatitura për t'u integruar me gjithçka që rekomandon Perëndimi dhe Amerika. Me këtë këndvështrim, bëhet një aluzion se kultura, mënyra e jetesës dhe politika e pjesës së botës nga vij unë është diçka që i mërzi njerëzit në Perëndim, madje mund të pritet që shkrimtarë si unë të propozojnë një zgjidhje për këto çështje. Këtu më duhet të shtoj menjëherë se një ton i tillë mospëfillës përfundimisht bëhet pjesë e problemit. Por sigurisht që ekziston një çështje reale mbi marrëdhëniet midis Lindjes dhe Perëndimit dhe se nuk bëhet fjalë vetëm për një qëndrim dashakeq nga ana e Perëndimit. Ka të bëjë me shumë çështje mes të varfërve dhe të pasurve, dhe paqes.

Në shekullin e XIX-të, Perandoria Osmane u përball me një sërë vështirësish në Perëndim; ndërsa perandoria u shkatërrua dhe pësoi disfatë të njëpasnjëshme nga ushtritë të Evropës, xhonturqit dhe udhëheqësit e tjerë të mundshëm, madje edhe monarkët e fundit osmanë, u impresionuan nga epërsia dërrmuese e Perëndimit dhe filluan një sërë reformash perëndimore. E njëjta logjikë

qëndron pas perëndimëzimit të Republikës moderne Turke dhe figurës së saj qëndrore Kemal Atatürk-ut. Kjo reflekton në besimin se kultura e vjetër - traditat dhe rendi fetar i kohës - është ajo që e bënë Turqinë të varfër dhe të dobët. Edhe unë, që vij nga një familje e mesme e perëndimëzuar e Stambollit, herë pas here kam rënë pre e këtij nocioni me qëllim të mirë, por tepër të thjeshtë dhe të njëanshëm. Optimisti që synon perëndimin dëshiron të transformojë dhe pasurojë kulturën e tij dhe vendin e tij duke imituar Perëndimin. Lëvizja perëndimore osmano-turke, e cila veptoi për ta bërë vendin e saj më të pasur, më të lumtur dhe më të fortë, ishte në të njëjtën kohë një lëvizje patriotike, lokaliste-kombëtare - apo quajeni si të doni. Por duke qenë se ata ishin perëndimorë të zellshëm, e shihnin të natyrshme që të kritikonin rrënjësisht disa nga tiparet vetanake kulturore dhe kombëtare, ata madje - sikurse njerëzit në perëndim - mund të gjenin defekte dhe elemente të jovlerave, megjithëse me ndjenja dhe metoda të ndryshme. Nga reagimet që kanë ardhur për romanet e mia po edhe nga kontaktet e mia me Perëndimin, gjithmonë kam ndjerë se kjo më vonë ngjall një ndjenjë tjetër, më të thellë dhe më komplekse - ndjenjë e "turpit". Çështja e marrëdhënive midis Lindjes dhe Perëndimit, ose me fjalë më apostrofuese për mua, midis traditës dhe modernitetit, ose midis vendit tim dhe Evropës, bazohet në një ndjenjë turpi që nuk mund të zhduket kurrë plotësisht. Unë gjithmonë jam përpjekur ta shoh këtë turp bashkë me ndjenjën krejtësisht të kundërt, atë të "krenarisë"; aty ku dikush tregon shumë krenari dhe epërsi, fshihet edhe turpi dhe poshtërimi i "tjetrit" - kjo është diçka që e dimë të gjithë. Ose dikush që është i fiksuar pas idesë së poshtëritimit mund të na shfaqet si një nacionalist krenar. Romanet e mia janë shkruar duke u bazuar në materialin rreth këtij lloji turpi dhe krenarie, poshtërimi dhe zemërimi. Pasi unë vij nga një vend që troket në derën e Evropës, e di se sa e lehtë është që këto ndjenja delikate të ndizen herë pas here dhe të marrin përmasa të tmerrshme. Do të doja të flisja për këtë turp me të njëjtën pëshpëritje që ndjej kur lexoj romanet e Dostojevskit, sikur të zbuloja një sekret. Diçka që më ka mësuar romani është se ne mund të bëhemi njerëz të lirë, vetëm nëse guxojmë të ndajmë me të tjerët ndjenjat e turpit që kemi dashur t'i mbajmë të fshehta.


Që në pragun e kësaj lirie, megjithatë, filloj të ndiej në thellësi të zemrës sime se sa e vështirë është të përfaqësoh dikë dhe çfarë dileme morale është të përçosh fjalën e dikujt tjetër. Ndjenja e brishtë për të cilën kam folur - pavarësisht nëse është nacionalizëm, turp apo patriotizëm i ndjeshëm lokal - çon në ankth si në pasqyrën e romancierit ashtu edhe në imagjinatën e tij. Një realitet që mban sekrete ndjenjat e turpit që na ngjall, nëpërmjet imagjinatës krijuese të romancierit, bëhet një botë tjetër që nuk mund të jetë më e fshehtë, por duhet të dalë në sipërfaqe. Kur romancierit luan me ligjet që drejtojnë botën dhe gjeometrinë e fshehtë të jetës, si një fëmijë që luan me lodrat e tij dhe me një intuitë që ai vetë nuk e kupton plotësisht, lind një ankth tek të gjithë - familjet, shoqatat dhe komunitetet, të afërmit dhe njerëz të tjerë të afërm. Megjithatë, ky është një shqetësim që na bën të lumtur. Sepse kur lexojmë një roman, kemi ndjenjën se bota në të cilën jetojmë është një konstrukt, ashtu si përrallat dhe tregimet, dhe aty ekspozohen gjërat që kanë qenë të fshehura në familje, shkolla dhe shoqëri - dhe çfarë është më e rëndësishmja - falë romanit ne mund ta imagjinojmë këtë. Të gjithë e dimë se çfarë kënaqësie është të lexosh romane: na pëlqen të dëgjojmë se si një person bën rrugën e tij mes njerëzve të tjerë dhe se si mendja e tij ndikohet dhe ndryshon nga konfrontimet me botën. Është po aq emocionuese të ndjekësh vëzhgimet dhe përshkrimet e autorit mbi gjithë këtë që ka të bëjë me marrëdhëniet e njeriut me mjedisin dhe atë çfarë ka aty. Jemi të vetëdijshëm se ajo që lexojmë është edhe produkt i imagjinatës së autorit dhe material nga bota në të cilën jetojmë. Romanet nuk janë kurrë tërësisht fantazi, por asnjëherë krejtësisht realitet. Të lexosh një roman do të thotë të ndeshesh me një realitet që është aty sa rezultat i imagjinatës krijuese të autorit aq edhe i kuriozitetit të së kaluarës,

përmes pjesëmarrjes sonë. Kur ulemi në një cep të dhomës ose shtrihemi diku me një roman në dorë, imagjinata jonë funksionon vazhdimisht dhe udhëton midis botës së romanit dhe botës sonë reale; duke lexuar romanin, kemi filluar kështu të imagjinojmë diçka "tjetër", me të cilën nuk kemi qenë në kontakt më parë dhe me të cilën nuk jemi vërtet të njohur. Ose bëjmë një udhëtim në shpirtin e dikujt që i ngjan shpirtit tonë. Unë i numëroj të gjitha këto detaje në mënyrë që tani t'ju tregoj për një imazh që shfaqet herë pas here në imagjinatën time. Ndonjëherë përpiqem që syri im i brendshëm të shohë në të njëjtën kohë secilin lexues, aty ku janë ulur me romanin e tyre në duar, mjedisin e tyre dhe struken në ndonjë kënd ose kolltuk. Në një moment të tillë më shfaqen para sysh një mijë e prapë një mijë lexues të tjerë nëpër qytete të ndryshme dhe vende të tjera të botës; ata lexojnë romanin dhe përpriqen të krijojnë një imazh të njerëzve dhe botës që autori ka krijuar. Ashtu siç ka bërë autori, lexuesi tani përdor imagjinatën e tij për të vënë veten në vendin e dikujt tjetër. Në këto momente, emocione të tilla si toleranca, përlësia, keqardhja, dhimbja dhe dashuria trazohen në shpirtin tonë; letërsia e mirë nuk ka të bëjë me prirjen tonë për të gjykuar, por me aftësinë tonë për të vënë veten në situatën e një personi tjetër.

Në ato momente kur përpriqem të përfytyroj të gjithë lexuesit e mi tek janë ulur në qytete dhe lagje të ndryshme, në rrugë dhe sheshe të ndryshme dhe e vënë në lëvizje imagjinatën e tyre, kuptoj se në thelb unë mendoj se si një komunitet, një grup, një komb - apo çfarëdo qoftë ai - mund të krijojë një imazh të vetvetes. Në ditët e sotme, besimet, grupet etnike dhe kombet e ndryshme e përdorin romanin për ta promovuar atë dhe diskutuar tezat e tyre më themelore. Prandaj ndodh që shumica prej nesh, pa e kuptuar, fillojmë të fantazojmë për shoqërinë apo grupin të cilit i përkasim vetë, edhe kur nxjerrim një roman të ri vetëm për t'u larguar nga mërzia e përditshmërisë dhe për t'u argëtuar. Kjo është ajo që e bën romanin kaq të pranueshëm ndaj zhgënjimeve, dobësive dhe komplekseve të kombeve të ndryshme, si dhe lumturisë dhe krenarisë së tyre. Romancierët bien vazhdimisht në pozicion të papëlqyer nga autoritetet për shkak të ndjenjave të tilla, dhe fatkeqësisht ka ende shembuj të intolerancës që nuk është e pritshme; romanet digjen dhe autorët ndiqen penalisht.

Jam rritur në një shtëpi ku njerëzit lexojnë romane.

Babai im kishte një bibliotekë të madhe dhe kur isha fëmijë ai më fliste për shkrimtarët e mëdhenj që sapo përmenda - Manin, Kafkën, Dostojevskin, Tolstoin, siç flasin baballarët e tjerë për pashallarët apo njerëzit e shenjtë. Të gjitha këto romane dhe autorë të mëdhenj u bënë pjesë e konceptit të Evropës për mua që kur isha fëmijë. Tani kjo nuk është vetëm sepse unë vij nga një familje e Stambollit që besonte singërisht te perëndimi dhe që me pafajësinë e tyre e shihnin dhe donin ta shihnin veten dhe vendin e tyre si më perëndimorë se sa ishin në të vërtetë... Një arsye tjetër pse ndodhi kështu është se arti i romanit është një nga llojet më të mëdha të arteve që janë shfaqur dhe zhvilluar në Evropë. Për mendimin tim, arti i romanit, krahas muzikës orkestrale dhe pikturës pas Rilindjes, është një nga gurët themeltarë që e bëjnë Evropën Evropë dhe që kanë formësuar identitetin e saj. Nuk mund ta imagjinoj Evropën pa romane. Kjo vlen për mënyrën e të menduarit dhe të kuptuarit, shkrimin kreativ dhe aftësinë për të vënë veten në vendin e dikujt tjetër. Por është edhe sepse romanet janë dëshmitarë të një kulture dhe historie të tërë. Fëmijët dhe të rinjtë në shumë vende të tjera të botës kanë pasur kontaktin e tyre të parë real me Evropën përmes romaneve; unë jam një prej tyre. Le të kujtojmë kohët kur, në kufijtë e Evropës, një kontinent i ri ose një kulturë dhe qytetërim i ri ra në kontakt me artin romak dhe nëpërmjet tij u frymëzua të krijonte shprehjen e tij letrare dhe për këtë arsye edhe t'i afrohej Evropës. Këtu mund të përmendim lindjen e romanit rus dhe romanit latinoamerikan, i cili është pjesë e kulturës evropiane... Vetëm duke lexuar romane shohim se si kufijtë e Evropës, historia evropiane dhe vetë Evropa po ndryshojnë vazhdimisht. Evropa e vjetër e përshkruar në romanet franceze, ruse dhe



gjermane në bibliotekën e babait tim, Evropa e pasluftës e fëmijërisë sime, Evropa e sotme - të gjitha janë vende dhe ide që ndryshojnë. Megjithatë, unë kam një perceptim për Evropën e pandryshueshme dhe tani do të flas për këtë.

Evropa është tani një çështje shumë e brishtë dhe e ndjeshme për një turk. Ashtu si shumica e turqve të tjerë, unë mbaj brenda vetes shpresat e një njeriu dashamirës që troket me padurim në portë dhe dëshiron të hyjë brenda, por që në të njëjtën kohë ka frikë nga refuzimi dhe ndjen zemërim të justifikuar për këtë. Kjo është një çështje shumë afër ndjenjës së turpit për të cilën fola pak më parë; ju trokitni te porta dhe në pritje e sipër merrni premtime që ju ngjallin shpresa, por më pas nuk ju lejojnë të hyni. Fatkeqësisht, ndërkohë që Turqia po afrohet më shumë me Evropën dhe anëtarësimi i plotë i Turqisë në Bashkimin Evropian ka filluar të duket si diçka e realizueshme, kundërshtimi ndaj Turqisë po bëhet gjithnjë e më i qartë mes politikanëve të caktuar në Evropë. Në zgjedhjet e fundit, disa politikanë që mbajtën një qëndrim politik kundër Turqisë dhe turqve përdorën metoda që mendoj se janë po aq të rrezikshme sa metodat e disa politikanëve turq që do të donin të shihnin një konflikt me Perëndimin dhe Evropën. Është një gjë të kritikosh shtetin turk në çështje të tilla si mungesa e demokracisë dhe - të marrim një shembull tjetër - situatën ekonomike, por krejt tjetër të shikosh me përcim të gjithë kulturën turke, ose nëse marrim situatën në Gjermani, të gjitha ata njerëz me prejardhje turke që janë shumë më të varfër se gjermanët dhe jetojnë një jetë shumë më të vështirë. Turqit e dëgjojnë këtë shpifje me ndjeshmërinë e atij që troket në portë dhe kërkon të pranohet brenda. Një nxitës i nacionalizmit anti-turk në Evropë për fat të keq kontribuon në nxitjen e një nacionalizmi anti-evropian të vijës së ashpër në Turqi. Ata që besojnë në Bashkimin Evropian duhet të kuptojnë sa më parë që çështja qëndron mes paqes dhe nacionalizmit. Të gjithë do të zgjedhim mes këtyre të dyjave - ose paqen ose nacionalizmin. Unë mendoj se ideja e paqes është arterja e Bashkimit Evropian dhe besoj se mundësia për paqe që Turqia i ofron Evropës nuk do të refuzohet. Çështja ka ardhur në një udhëkryq, ku zgjedhja është mes aftësisë së imagjinatës së një romancierit dhe nacionalizmit të atyre që djegin libra.

Vitet e fundit, unë kam folur shpesh në favor të anëtarësimin të Turqisë në Bashkimin Evropian dhe rrjedhimisht kam marrë shumë

pyetje mosbesuese dhe të dyshimta. Dua t'u përgjigjem atyre menjëherë. Dua të them se gjëja e parë që Turqia i ofron Evropës është paqja; kur një vend mysliman dëshiron t'i bashkohet Evropës dhe nëse kjo iniciativë e paqes pranohet, kjo do të thotë siguri dhe forcë për Evropën dhe Gjermaninë. Në romanin e mëdha që kam lexuar në fëmijërinë time dhe kur isha i ri, nuk ishte krishterimi, por fati njerëzor që i dha Evropës karakterin e saj të veçantë. Unë u mahnita nga këto romane, sepse aty tregohet për Evropën në kuptimin e njerëzve që përpriqen të jenë të lirë dhe krijuet dhe të jenë në gjendje të ndjekin vullnetin e tyre. Evropa mund të mburret me faktin se idetë e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë filluan të mbijnë në pjesë të tjera të botës jashtë Perëndimit. Në një Evropë paqeje të karakterizuar nga iluminizmi, barazia dhe demokracia, turqit duhet të zënë vendin e tyre. Një Evropë që anon vetëm drejt krishterimit bëhet, njësoj si një Turqi e rënduar nga feja, një vend i mbyllur, që shikon prapa dhe jo përpara dhe pa ndjenjën e realizmit. Për njerëzit si unë, të rritur në një Stamboll të perëndimëzuar, laik, nuk është e vështirë të besosh në Bashkimin Evropian. Mos harroni se Fenerbahçe, skuadra e futbollit që kam mbështetur që fëmijë, tani luan në Kupat e Europës. Ka miliona turq që, si unë, janë plotësisht të bindur për këtë, që Turqia ka një vend në Evropë. Megjithatë, më me rëndësi është se edhe një shumicë e madhe e turqve konservatorë dhe myslimanë dhe përfaqësuesit e tyre politikë sot duan ta shohin Turqinë në Bashkimin Evropian në mënyrë që të mund të ëndërrojnë dhe të formësojnë Evropën e së ardhmes së bashku me ju. Pas shekujve me grindje dhe luftëra, do të duhej të jetë e vështirë të refuzohet ky gjest paqeje. Nga ana ime, nuk mund ta imagjinoj një Turqi pa Evropën dhe as nuk mund të besoj në një Evropë pa Turqinë.

Kërkoj falje për një fjalim të tillë politik.

Bota që dua t'i përkas është padyshim bota e fantazisë. Nga moshja shtatë deri në njëzet e dy vjeçare doja të bëhesha artist dhe dilja nëpër rrugët e Stambollit për të pikturuar qytetin. Kështu që në moshën njëzet e dy vjeçare e braktisa pikturën dhe fillova të shkruaj romane; kam treguar për këtë në librin "Stambolli". Tani mendoj, se në fakt, s' ka rëndësi nëse është pikturë apo letërsi. Ajo që ka rëndësi për mua, qoftë njëra apo tjetra formë e artit, është dëshira për të ikur nga kjo botë e mërzitshme, mbytëse dhe zhgënjyese që njohim të gjithë, për t'u strehuar në një botë tjetër më të pasur, e cila


është më e thellë dhe më e shumëanshme. Për të qenë në gjendje ta imagjinoj këtë botë tjetër të mrekullueshme në detajet më të vogla, çdo ditë më duhet të ulem vetëm për një kohë të gjatë në dhomë, qoftë për ta paraqitur atë me penel dhe ngjyra, si kur isha i ri, ose ta krijoj atë me fjalë, siç kam bërë gjatë tridhjetë viteve të fundit. Këtë botë të dytë e ngushëlloese, të cilën e kam krijuar në vetminë time për tridhjetë vjet, e ndërtoj natyrshëm me materia e botës që njohim të gjithë, nga përshtypjet e marra në rrugë dhe në shtëpitë e njerëzve në Stamboll, Kars dhe Frankfurt. Në të njëjtën kohë, bota reale e cunguar gjallërohet me një magji shumë të veçantë përmes aftësisë së romancierit për të rrëfyer dhe imagjinatës sonë.

Do ta mbyll me pak fjalë për këtë gjendje shpirtërore për të cilën romancierit jep gjithë jetën për t'ia zbuluar lexuesit. Për mua jeta është diçka jashtëzakonisht e ndërlikuar, e çuditshme dhe e pakuptueshme dhe diçka që mund të na bëjë të lumtur vetëm nëse vihet në një kontekst. Ajo që na bën të ndihemi të lumtur ose të pakënaqur zakonisht nuk është jeta që jetojmë, por kuptimi që mendojmë se ka. Unë ia kam kushtuar gjithë jetën eksplorimit të këtij kuptimi të jetës; që në botën e sotme kaotike, të vështirë dhe me dinamikë të shpejtë, me zhurmën dhe ulërimën e saj, të përpriqem të gjej një fillim, një pikë qendrore dhe një fund të këtyre gjirove marramendëse të jetës - diç që mendoj se mund ta bëj vetëm duke shkruar romane. Kur mbarova romanin "Bora" dhe e botova, m'u duk sikur takoja hijen e Ka-së sa herë që dilja në rrugët e Frankfurtit - heroin e romanit, Ka-së që ecte andej dhe që më ngjante paksa. Më dukej sikur qyteti kishte marrë një kuptim të veçantë për mua dhe se kisha gjetur epiqendrën e tij. Mallarmé kishte shumë të drejtë kur thoshte: "Çdo gjë në këtë botë ekziston për t'u përfshirë në një libër". Padyshim, librat më të mirë për të kuptuar gjithçka në këtë botë janë romanet, mendoj unë. Edhe tani, pas kaq shekujsh, kjo aftësi kryesore njerëzore, arti i të rrëfyerit dhe aftësia për të kuptuar të tjerët, shprehet më së miri në romane. Çmimin e madh që më ndani tani e shoh si një shpërblim për një shërbim besnik që i kam bërë artit të madh të romanit për tridhjetë vjet dhe me këtë dua t'ju shpreh falënderimet e mia të përzemërta të gjithëve

—

\*Fjala falënderuese mbajtur me rastin e marrjes së çmimi për paqe nga rrjeti i bibliotekave gjermane, Frankfurt, 2005

Hera e parë që kam parë flokëgjatë ka qenë në Pragë. Në hollin e hotelit ku rrija hynë dy djem të huaj, me flokë të gjatë deri në supe. Kaluan përmes hollit, mbërritën në një qoshe pak të mënjanuar dhe u ulën në një tryezë. Qëndruan të ulur aty për nja një gjysmë ore, të vëzhguar prej klientëve, mes të cilëve unë; pastaj ikën. Edhe kur kaluan përmes njerëzve të mbledhur në holl, edhe kur qenë të ulur në qoshen mënjanë, nuk folën (ndoshta- por nuk e kujtoj- pëshpëritën diçka mes tyre: por, mendoj, diçka krejt praktike, të pashprehshme). Në fakt ata, në atë situatë të veçantë- që ishte krejt publike apo sociale dhe do të thosha, zyrtare- nuk kishin fare nevojë të flisnin. Heshtja e tyre ishte rreptësisht funksionale. Dhe ishte thjesht sepse fjala ishte e panevojshme. Ata të dy, në fakt, përdornin për të komunikuar me të pranishmit, me vëzhguesit- me vëllezërit e tyre të atij çasti- një gjuhë tjetër prej asaj që formohet me fjalë. Ajo që zëvendësonte gjuhën tradicionale me fjalë, duke e bërë të panevojshme- e për më tepër duke gjetur vendosjen e menjëhershme në zotërim të gjerë të "shenjave", pra të fushës së semiologjisë- ishte gjuha e flokëve të tyre. Bëhej fjalë për të vetmen shenj- pikërisht për gjatësinë e flokëve të tyre deri mbi supe- në të cilët ishin përqendruar të gjitha shenjat e mundshme të një gjuhe të artikuluar. Cili ishte kuptimi i mesazhit të tyre të heshtur dhe vetëm fizik? Ishte ky: "Ne jemi dy flokëgjatë. I përkasim një kategorie të re njerëzore që po bën të shfaqet këto ditë në botë, që e ka qendrën e vet në Amerikë dhe që, në provincë (si për shembull- madje, sidomos- këtu në Pragë) nuk njihet. Pra ne jemi për ju një Shfaqje. Ushtrijmë propagandimin e doktrinës sonë, tashmë plot me një dituri që na përmbush e na dërmon tërësisht. Nuk kemi asgjë për t'i shtuar gojarisht apo me arsye asaj që fizikisht dhe në mënyrë ontologjike thonë flokët tanë. Dituria që na mbush, edhe nëpërmjet propagandës sonë, do t'ju përkasë një ditë edhe juve. Tani për tani është një Gjë e Re, një Gjë e Re e madhe, që krijon në botë, me skandalin, një pritshmëri: e cila nuk do të tradhetohej. Borgjezët bëjnë mirë që na shikojnë me urrejtje dhe tmerr, sepse është gjatësia e flokëve tanë që i kundërshton në mënyrë absolute. Por të mos na marrin për njerëz të paedukatë e të egër: ne jemi shumë të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë. Ne nuk ju shikojmë, rrimë në punën tonë. Bëni kështu edhe ju, dhe pritni Ndodhitë." Unë isha marrës i këtij komunikimi, por qeshë edhe në gjendje ta deshifroja menjëherë: ajo gjuhë pa leksik, pa gramatikë, pa sintaksë, mund të kuptohej menjëherë, edhe sepse duke u folur në mënyrë semiologjike, nuk ishte tjetër veçse një formë e asaj "gjuhës së prezencës fizike" që gjithmonë njerëzit janë në gjendje ta përdorin. Kuptova; dhe ndjeva menjëherë një antipati për ata të dy. Pastaj m'u desh ta kapërdija antipatinë dhe t'i mbroja flokëgjatët nga sulmet e policisë e të fashistëve: qeshë, natyrisht, për shkak të parimit, në anën e Living Theatre, të Beats etj.; dhe parimi që më bënte të isha në anën e tyre ishte një parim thellësisht demokratik. Flokëgjatët u shumuan mjaft- si të krishterët e parë: por vazhdonin në mënyrë misterioze të ishin të heshtur; flokët e gjatë ishin gjuha e tyre e vetme dhe e vërtetë dhe pak u interesonte të arrinin gjë tjetër. E folura e tyre përkonte me qenien e tyre. Pashprehshmëria ishte ars retorica (oratoria) e protestës së tyre. Çfarë



thoshin, me gjuhën e pa artikuluar, të qëndrueshme në shenjën monolite të flokëve, flokëgjatët e viteve '66 - '67? Thoshin këtë: "Qytetërimi konsumist na është neveritur. Ne protestojmë në mënyrë radikale. Po krijojmë një antikorp për këtë lloj qytetërimi përmes kundërshtimit. Dukej sikur gjithçka shkonte mirë, apo jo? A duhej të ishte brezi ynë një brez i plotësuar? Përkundrazi, ja si janë gjërat në realitet. Ne i kundërvëmë marrëzinë një prapësie të "ekzekutuesve". Po krijojmë vlera të reja fetare në entropinë borgjeze, pikërisht në momentin kur po bëhet tërësisht laike dhe hedoniste. E bëjmë me një bujë dhe një dhunë revolucionare (dhunë e të pa-dhunshmëve!) sepse kritika jonë ndaj shoqërisë sonë është totale dhe e pandryshueshme." Po të pyeteshin sipas sistemit tradicional të gjuhës së folur, nuk e besoj se ata do të ishin në gjendje ta shprehnin në mënyrë kaq të artikuluar tezën e flokëve të tyre:

fakti është se në thelb këtë donin të shprehnin. Për sa më përket mua, edhe pse dyshoja deri atëherë se "sistemi i tyre i shenjave" ishte produkt i një nënkulture proteste që i kundërvihet një nënkulture të pushtetit dhe që revolucionin i tyre jo marksist ishte i dyshimtë, vazhdova për një periudhë të isha në anën e tyre, duke u mbështetur të paktën në elementin anarkist të ideologjisë sime. Gjuha e atyre flokëve, edhe pse e pashprehshme, shprehte "gjëra" të së Majtës. Madje të së Majtës së Re, të lindur brenda universitetit borgjez (në një dialektikë të krijuar ndoshta në mënyrë artificiale nga ajo Mendje që rregullon, përjashta ndërgjegjes së Pushteteve të veçanta e historike, fatin e Borgjezisë). Erdhi 1968. Flokëgjatët qenë thithur nga Lëvizja Studentore; u valëvitën me flamuj të kuq mbi barrikada. Gjuha e tyre shprehte gjithnjë e më shumë "gjëra" të së Majtës. (Çe Gevara ishte flokëgjatë etj.) Në 1969- me tragjedinë e Milanos, Mafien,

emisarët e kolonelëve grekë, bashkëpunimin në krim të Ministrave, komplotin e zi, provokatorët- flokëgjatët ishin tepër të përhapur: edhe pse nuk ishin akoma në shumicë numerike, kishin marrë një peshë të madhe ideologjike. Tani flokëgjatët nuk ishin më të heshtur: nuk ia delegonin më sistemit shënjues të flokëve të tyre të gjithë kapacitetin komunikues dhe shprehës. Përkundrazi, prania fizike e flokëve, në njëfarë mënyre, ishte katandisur në funksion dallues. Ishte kthyer në funksion përdorimi tradicional i gjuhës verbale. Dhe nuk them verbale rastësisht. Madje e nënvizoj. Kaq është folur nga '68 në '70, kaq shumë, sa për një periudhë i është nxjerrë fundi verbalizmit; dhe verbalizmi ka qenë ars retorica e re e revolucionit (goshizmi, sëmundja verbale e marksizmit!) Edhe pse flokët- të përthithur në furinë verbale nuk u flisnin më në mënyrë të pavarur marrësve të hutuar, prapëseprapë unë gjeja forcën ta mpreshja kapacitetin e deshifrimit dhe në rrapëllimë, u përpoqa t'i kushtohesha dëgjimit të diskutimit të heshtur, të pandërprerë, të atyre flokëve gjithnjë e më të gjatë. Çfarë thoshin ata, tani? Thoshin: "Po, është e vërtetë, themi gjëra të së Majtës; kuptimi ynë- edhe pse pastërtisht përkrahës i kuptimit të mesazheve verbale- është një kuptim i së Majtës... Por... Por..." Diskutimi i flokëve të gjatë ndalonte këtu: duhej ta plotësoja vetë. Me atë "por" ata donin të thoshin qartë dy gjëra: 1) "Pashprehshmëria jonë shfaqet gjithnjë e më shumë e natyrës iracionale dhe pragmatiste: epërsia që ne i veshim në heshtje veprimin është e karakterit nënkulturor dhe prandaj në thelb është e djathtë". 2) Ne kemi qenë të parapëlqyer edhe nga provokatorët fashistë, që u përzihen revolucioneve verbale (por verbalizmi mund të çojë edhe në veprim, sidomos kur e mitizon): dhe krijojmë një maskë të përsosur, jo vetëm në pikëpamjen e aspektit fizik- rrjedhja dhe valëzimi ynë i çrregullt priret t'i bëjë homologe të gjitha fytyrat- por edhe në pikëpamjen kulturore: në fakt një nënkulturë e së Djathtës mund të ngatërrohet shumë bukur me një nënkulturë të së Majtës". Shkurt kuptova se gjuha e flokëve të gjatë nuk shprehte më "gjëra" të së Majtës, por shprehte çdo keqkuptim e Majtë- e Djathtë, që bënte të mundur prezencën e provokatorëve. Para nja dhjetë viteve, mendoja, ndër ne të brezit të mëparshëm, një provokator ishte gati i pakconceptueshëm (veç nëse ishte një aktor i madh): në fakt nënkultura e tij do të dallohej, edhe fizikisht, nga kultura jonë. Do ta njihnim nga sytë, nga hunda, nga flokët! Do ta demaskonim menjëherë dhe do t'i jepnim menjëherë mësimin që meritonte. Tani kjo nuk është e mundur. Askush më në botë nuk mund të dallojë një revolucionar nga një provokator. E Djathta dhe e Majta janë shkruar fizikisht. Kemi arritur në 1972. Isha këtë shtator në qytezën Isfahan, në zemër Persisë. Vend në zhvillim, siç thuhet në mënyrë të tmerrshme, por po aq të tmerrshme thuhet, në ngritje të plotë. Mbi Isfahanin e dhjetë viteve më parë- një nga qytetet më të bukura të botës, kushedi, ndoshta më i bukuri- ka lindur një Isfahanin e ri, modern e shumë i shëmtuar. Por nëpër rrugët e tij, për punë apo për shetitje, rreth darkës shihen të rinjtë që shiheshin në Itali para dhjetë vitesh: bij dinjitozë dhe të përlulur, me qafat e bukura dhe fytyrat e bukura e të kthjellëta nën cullufet e pafajshme krenare. Dhe ja që një mbrëmje, duke filluar nga rruga kryesore, pashë mes

gjithë atyre të rinjve të hershëm, shumë të bukur e plot dinjitet të hershëm njerëzor, dy qenie të përbindshme: Nuk ishin tamam nga flokëgjatët, por flokët e tyre ishin prerë evropiançe, të gjatë mbrapa, të shkurtër mbi ballë, të rriposur nga tërheqja, me dy cullufe të ndyra, ngjitur në mënyrë artificiale përreth fytyrës sipër veshëve. Çfarë thoshin këta flokët e tyre? Thoshin: "Ne nuk i përkasim numrit të këtyre njerëzve të uritur, të këtyre mjeranëve të pazhvilluar, që kanë mbetur prapa në kohët barbare! Ne jemi punonjës banke, studentë, bij të njerëzve të pasuruar që punojnë në shoqëritë e naftës; e njohim Evropën, kemi lexuar. Ne jemi borgjezë: dhe ja, flokët tanë të gjatë, që dëshmojnë modernizmin tonë internacional prej të privilegjuarish!" Pra ata flokë të gjatë aludonin "gjëra" të së Djathtës. Rrethi është mbyllur. Nën-kultura në fuqi ka thithur nën-kulturën në opozitë. Me shkathtësinë djallëzore e ka bërë atë me durim një modë, që nëse nuk mund të thuhet tamam fashiste në kuptimin klasik të fjalës, në fakt është një "ekstrem i djathtë" real. Përfundoj me hidhërim. Maskat e neveritshme që të rinjtë vënë në fytyrë, duke u bërë të ndyrë si kurvat e vjetra të një ikonografie të pathemeltë, rikrijojnë objektivisht mbi fizionomitë e tyre atë që vetë ata e kanë dënuar gjithmonë me fjalë. Kanë dalë fytyra të vjetra priftërinjsh, gjykatësish, zyrtarësh, anarkistësh të rremë, punonjës qesharakë, avokatë ngatërrestarë (Axekagarbulë), Don Ferrante, mercenarë, batakçinj, konformistë rrugaçë. Pra dënimi radikal dhe pa dallim që ata kanë shpallur kundër baballarëve të tyre- që janë historia në evolucion dhe kultura e mëparshme- duke ngritur kundër tyre një barrierë të pakapërcyeshme, ka përfunduar me izolim, duke u penguar atyre një raport dialektik me baballarët e tyre. Tani, vetëm përmes një raporti të tillë dialektik- qoftë edhe dramatik dhe i ekstremizuar- ata do të mund të kishin ndërgjegjen reale historike të vetvetes dhe të shkonin përpara, "t'i kapërcenin" baballarët. Përkundrazi, izolimi në të cilin janë mbyllur- si në një botë mënjanë, në një geto të rezervuar për rininë- i ka mbajtur të ndaluar në realitetin e tyre të pamposhtshëm historik: dhe kjo ka përfshirë- në mënyrë fatale- një regres. Në realitet ata kanë shkuar më prapa se baballarët, duke shkaktuar në shpirtin e tyre tmerre e konformizma dhe në pamjen e tyre fizike rregulla të ngurta e mjerime që dukej se ishin kapërcyer përgjithmonë. Kështu thonë tani flokët e gjatë, në gjuhën e tyre të pa artikuluar e të xhindosur të shenjave joverbale, në ikonizmin e tyre banditesk, në "gjërat" e televizionit apo të reklamave të produkteve, ku tashmë është e pakonceptueshme të parashikosh një të ri që të mos ketë flokë të gjatë: fakt që sot do të ishte skandaloz për pushtetin. Ndjej një pakënaqësi të sinqertë e të pafund të them (madje, një dëshpërim të vërtetë): por tashmë mijëra e qindra mijëra fytyra të rinjsh italianë, i ngjasojnë gjithnjë e më shumë fytyrës së Merlini. Liria e tyre për t'i mbajtur flokët siç duan, nuk është më e mbrojtur, sepse nuk është më liri. Ka ardhur çasti t'u thuhet të rinjve se mënyra e tyre e mbajtjes së flokëve është e tmerrshme, sepse është skllavëruese dhe vulgare. Madje, ka ardhur çasti që ata vetë ta vënë re dhe të çlirohen nga ky ankthi i tyre fajtor për t'iu përmbytur rregullit degradues të hordhisë.

# MAGJIA E LIBRIT "PËRSE IRIQIN NUK E PËRKËDHEL ASKUSH?"

nga *Xhahid Bushati*

- Shënime dhe përftesa për librin "Përse iriqin nuk e përkëdhel askush?", autori: Andrey Kurkov, ilustrimet: Tania Goryushina, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 2024

## Fillimisht për jetën dhe veprimtarinë letrare të Andrey Kurkov...

Andrey Yuryevich Kurkov lindi, më 23 prill 1961. Është autor ukrainas. Shkruan në rusisht dhe në ukrainisht. Është autor i 19 romaneve, duke përfshirë linrin më të shitur: "Vdekja dhe pinguini", nëntë libra për fëmijë dhe rreth 20 skenarë dokumentarë, një pjesë më subjekt trillimesh, dhe filma televizivë. Puna e tij krijuese është përkthyer, aktualisht, në 37 gjuhë (anglisht, spanisht, japonisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, kinezisht, suedisht, hebraisht... etj., dhe është botuar në 65 vende të botës).

Babai i Kurkov-it ishte pilot dhe nëna mjeke. Kur Kurkov-i ishte afro dy vjeç,

familja e tij u zhvendos në Kiev; kjo e lidhur me profesionin e babait të tij.

Filloi të shkruante në moshën shtatë vjeçare. U diplomua në vitin 1983 në Institutin e Gjuhëve të huaja (Kiev). Gjatë kësaj periudhe Kurkov shkroi shumë tregime për fëmijë. Në vitin 2018, u zgjodh President i PEN i Ukrainës. Romani "Bletët gri" i Kurkov-it, i cili ka "elementë të fabulës të njohur dhe epicit me përmasa hapësinore", pasqyron konfliktin në vendin e tij përmes aventurave të një bletari. Realja e një realiteti tragjik mbetet optikë kryesore dhe shkrimore e autorit Kurkov." Romani u përkthye në frëngjisht dhe në anglisht. U nderua me disa çmime.

Kurkov ka në proces pune dhe vepra të tjera.

## Kodet e tregimit - përrallë "Përse iriqin nuk e përkëdhel askush?"

Nga nëntë librat për fëmijë, Onufri zgjodhi që lexuesve të vegjël dhe bibliotekës shqiptare t'i bëjë të njohur librin "Përse iriqin nuk e përkëdhel askush?" të autorit ukrainas Andrey Kurkov, me ilustrimet fine dhe plot elegancë e botë feminare të Tania Goryushina.

Është një tregim i rrëfyer sipas strukturës së përrallave popullore. Një strukturë e tillë është e njohur në përrallat tona popullore. Është një rrëfim i magjishëm, ku flet dhe rrëfen autori Krukov, por më shumë flasin ilustrimet e piktores Tania Goryushina.

Është historia e një iriqi që po shkonte rrugës së fshatit. Gjatë rrugës së tij shikon një djalë që po përkëdhelte një kone. Vazhdon rrugën, dhe pranë një stoli afër një deriçkeje shikon një vajzë që po përkëdhel një kotele. Duke vazhduar rrugën sheh një kalë, e, pranë tij një djalosh që po përkëdhelte kalin. Në të gjitha këto sekuenca mikrongjarsh, tek iriqi shtohet zilia. Iriqi mendon: "Po mua, përse nuk më përkëdhel askush?" Mendon... dhe është i vetëm në një fushë të pafund. (Një moment i gjetur, ku personazhin tonë, iriqin, e paraqet të vetmuar dhe "duke bashkëbiseduar me vetveten"). Kemi të bëjmë me marrëdhënien mes iriqit të vetmuar dhe zilisë së tij, e cila e ka pushtuar totalisht.

Takimi me miushin, për iriqin ziliqar është një rreze shprese dhe njëkohësisht për të marrë një përgjigje të vërtetë për të vërtetën që e mundonte. Është një udhëtim i bukur me miushin, ndryshe nga ato pamje që pa për konen, kotelen, kalin që i përkëdhelnin. Miushi i afron një model të vërtetë të përkëdheljes, që ndodhet në brendësinë e shpirtit të tij, dhe iriqin e bën të ndihet i jetueshëm, lumtur dhe përkëdhelës. Iriqi është një mësues i mirë, i cili me veprimet e tij ia hoqi zili dhe i shtoi përkëdhelitet.

Është e rëndësishme të themi që në fillim, se përkthyesi njeh gjer në imtësitë veçoritë dhe tipologjinë e shkrimtarit Kurkov. Përse e themi? E ka "kornizuar" tregimin - përrallë në dialogun feminar dhe me një numër të caktuar fjalësh duke rritur intensitetin e përrallës, kuriozitetin e saj dhe ç'po ndodh me rrugëtimin e zilisë së iriqit. Të gjitha këto përkthyesi i ka mishëruar dhe e ka shpirtëzuar krijimin e Krukov-it. Dhe në përfundim, kjo përrallë - tregim e ka një adresë moshore që lexohet me ëndje.

Në përfundim, të tekstit tonë, është e vlerësueshme të themi se, ardhja e tipologjisë së këtij krijimi, njohja me mjeshtërinë e Krukov-it, të konceptit dhe trajtimit të një teme siç është zilia, (dhe nuk është ë lehtë) përbën një model që duhet njohur, edhe nga fëmijët shqiptarë. Ndaj, bibliotekës së librave shqip i shtohet një libër i çmuar, i përkthyer me seriozitet dhe mjeshtëri nga Bujar Hudhri. Përkthyesi e ka bërë përrallën të dashur, sepse ka kuptuar në rrënjë mesazhin dhe misionin e saj universal.

Libri me personazh iriqin - simpatik e real të titulluar: "Përse iriqin nuk e përkëdhel askush?", e kupton, se nga faqja në faqe, ngadalë-ngadalë njeh fjalën përkëdhelje dhe e përkëdheli, që rritet para lexuesve si gur i çmuar. Një libër që duhet të jetë i mirëpritur në duart e vogëlushëve dhe i vendosur në raftet e bibliotekave, për t'u lexuar...

Shkodër, më, 25.01.2025



*Karikaturë nga Arben Mexsi*

